



# EDUKIMI PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN



(EMI)

*Module për trajnimin e mësuesve*



# EDUKIMI PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN (EMI)

*Module për trajnimin e mësuesve*



Tiranë, 2021

Përgatiti: Astrit Dautaj

Grupi i punës: Gerti Janaqi, Remzi Lani, Dorentina Hysa, Agim Doksani

Copyright: © ISHM

Botues: ISHM & ASCAP



Rr. "Gjin Bue Shpata", No.8, Tiranë, Albania  
Tel./fax: ++ 355 4 2229800  
E-mail: [info@institutemedia.org](mailto:info@institutemedia.org)  
[www.institutemedia.org](http://www.institutemedia.org)



Rruga "Naim Frashëri", Nr.37, Tirana 1049  
Tel./fax: ++ 355 4 256 441  
E-mail: [sekretaria@izha.edu.al](mailto:sekretaria@izha.edu.al)  
<https://www.ascap.edu.al/>



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Organizata e Kombeve  
të Bashkuara për Arsim,  
Shkencë dhe Kulturë

Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe UNESCO-s në kuadrin e Projektit *"Krijimi i Besimit në Media në Evropën Juglindore dhe Turqi, Faza e II-të"*. Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e Institutit Shqiptar të Medias dhe Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), si e tillë jo domosdoshmërisht reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian apo UNESCO-s.

# TABELA E PËRMBAJTJES

<b>MODULI 1: Qytetaria, liria e shprehjes dhe e informimit, sigurimi i informacionit, diskutimi demokratik dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës .....</b>	<b>1</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>2</b>
<b>Tema 1: Të kuptojmë EMI-n. Një këndvështrim .....</b>	<b>4</b>
Çështjet kryesore .....	4
Objektivat e të mësuarit .....	4
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	5
Burimi i informacionit .....	6
Veprimtari .....	7
Rëndësia e EMI-t për qytetarët .....	10
<b>Tema 2: EMI dhe pjesëmarrja qytetare .....</b>	<b>12</b>
Çështjet kryesore .....	12
Objektivat e të mësuarit .....	12
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	13
E drejta për informim .....	14
Veprimtari .....	15
Liria e shprehjes, pavarësia botuese, pluralizmi dhe diversiteti .....	16
<b>Tema 3: Ndërveprimi i medias me ofruesit e tjerë të informacionit .....</b>	<b>20</b>
Çështjet kryesore .....	20
Objektivat e të mësuarit .....	20
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	21
Gjuha në media dhe informacion .....	21
Paraqitja në media dhe informacioni .....	22

<b>Tema 4: EMI: Mësimdhënia dhe të mësuarit</b> .....	26
Çështjet kryesore .....	26
Objektivat e të mësuarit .....	26
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	26
Veprimtari .....	31
<b>MODULI 2: Lajmet, media dhe etika e informimit</b> .....	33
<b>Hyrje</b> .....	34
<b>Tema 1: Gazetaria dhe shoqëria</b> .....	35
Çështjet kryesore .....	35
Objektivat e të mësuarit .....	35
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	36
Rekomandime për vlerësimin .....	37
<b>Tema 2: Liria, etika dhe llogaridhënia</b> .....	38
Çështjet kryesore .....	38
Objektivat e të mësuarit .....	38
Qasje pedagogjike .....	39
Veprimtari .....	40
Rekomandime për vlerësimin .....	42
<b>Tema 3: Cilat janë kriteret për eksplorimin e lajmeve</b> .....	43
Çështjet kryesore .....	43
Objektivat e të mësuarit .....	43
Qasjet pedagogjike .....	43
Veprimtari .....	44
<b>Tema 4: Zhvillimi i procesit të lajmeve</b> .....	46
Çështjet kryesore .....	46
Objektivat e të mësuarit .....	46
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	47

<b>MODULI 3: Paraqitja në media dhe informacion</b> .....	51
<b>Hyrje</b> .....	52
<b>Tema 1: Raportimi i lajmeve dhe pushteti i imazhit</b> .....	60
Çështjet kryesore .....	54
Objektivat e të mësuarit .....	54
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	55
Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave .....	56
Vlerësimi .....	59
<b>Tema 2: Kodet e industrisë për diversitetin dhe paraqitjen</b> .....	60
Çështjet kryesore .....	60
Objektivat e të mësuarit .....	60
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	60
Rekomandime për vlerësimin .....	61
<b>Tema 3: TV, filmat, botimi i librave</b> .....	62
Çështjet kryesore .....	62
Objektivat e të mësuarit .....	62
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	63
Rekomandime për vlerësimin .....	65
<b>Tema 4: Paraqitja dhe videot muzikore</b> .....	66
Çështjet kryesore .....	66
Objektivat e të mësuarit .....	66
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	67
Rekomandime për vlerësimin .....	69
 <b>MODULI 4: Gjuha në media dhe informim</b> .....	 71
<b>Hyrje</b> .....	72
<b>Tema 1: Leximi i teksteve të medias dhe informacioneve</b> .....	74
Çështjet kryesore .....	74

Objektivat e të mësuarit .....	74
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	74
Rekomandime për vlerësimin .....	75
<b>Tema 2: Mjeti dhe mesazhi: lajmet e transmetuara përmes radios dhe TV dhe ato përmes materialeve të shtypura .....</b>	<b>76</b>
Çështjet kryesore .....	76
Objektivat e të mësuarit .....	76
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	77
Rekomandime për vlerësimin .....	78
<b>Tema 3: Gjinitë e filmit dhe skenari .....</b>	<b>79</b>
Çështjet kryesore .....	79
Objektivat e të mësuarit .....	79
Qasjet pedagogjike dhe veprimtaritë .....	80
Rekomandime për vlerësimin .....	81
<b>MODULI 5: Reklama .....</b>	<b>83</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>84</b>
<b>Tema 1: Reklama: të ardhurat dhe rregullimet .....</b>	<b>87</b>
Çështjet kryesore .....	87
Objektivat e të mësuarit .....	87
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	87
Rekomandime për vlerësim .....	89
<b>Tema 2: Lajmërimet për publikun .....</b>	<b>90</b>
Çështjet kryesore .....	90
Objektivat e të mësuarit .....	90
Qasjet pedagogjike dhe veprimtaritë .....	90
Rekomandime për vlerësimin .....	92

<b>Tema 3: Reklama dhe procesi krijues</b> .....	94
Çështjet kryesore .....	94
Objektivat e të mësuarit .....	94
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	95
Rekomandime për vlerësimin .....	97
<b>Tema 4: Reklammat dhe arena politike</b> .....	98
Çështjet kryesore .....	98
Objektivat e të mësuarit .....	98
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	98
Çështje të tjera për diskutim .....	100
<b>MODULI 6: Media e re dhe e vjetër</b> .....	101
<b>Hyrje</b> .....	102
<b>Tema 1: Nga media tradicionale në teknologjitë e medias së re</b> .....	103
Çështjet kryesore .....	103
Objektivat e të mësuarit .....	103
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	104
<b>Tema 2: Përdorimi i teknologjive të medias së re, komunikimi digjital dhe masmedia</b> .....	106
Çështjet kryesore .....	106
Objektivat e të mësuarit .....	106
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	107
<b>Tema 3: Përdorimi i mjeteve ndërvepruese multimediale: lojërat digjitale në klasë</b> .....	111
Çështjet kryesore .....	111
Objektivat e të mësuarit .....	111
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	112



<b>MODULI 7: Mundësitë dhe sfida e internetit</b> .....	115
<b>Hyrje</b> .....	116
<b>Tema 1: Të rinjtë në botën virtuale</b> .....	117
Çështjet kryesore .....	117
Objektivat e të mësuarit .....	117
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	118
<b>Tema 2: Sfidat dhe rreziqet në botën virtuale</b> .....	101
Çështjet kryesore .....	121
Objektivat e të mësuarit .....	121
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	122
<b>MODULI 8: Edukimi për informacionin dhe aftësimi për bibliotekat</b> .....	131
<b>Hyrje</b> .....	132
<b>Tema 1: Koncepti i edukimit për informim dhe zbatimi i tij</b> .....	134
Çështjet kryesore .....	134
Objektivat e të mësuarit .....	134
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	135
<b>Tema 2: Mjedisi i të mësuarit dhe edukimi për informacionin</b> .....	141
Çështjet kryesore .....	141
Objektivat e të mësuarit .....	141
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	142
<b>Tema 3: Edukimi për informimin digjital</b> .....	146
Çështjet kryesore .....	146

Objektivat e të mësuarit .....	146
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	147
<b>MODULI 9: Gjuha e urrejtjes dhe edukimi për qytetari demokratike .....</b>	<b>151</b>
<b>Hyrje .....</b>	<b>152</b>
<b>Tema 1: Të kuptojmë gjuhën e urrejtjes .....</b>	<b>157</b>
Çështjet kryesore .....	157
Objektivat e të mësuarit .....	157
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	157
Ide për veprime të mëtejshme .....	163
<b>Tema 2: Përplasja e lirive ose liritë në konflikt .....</b>	<b>164</b>
Objektivat e të mësuarit .....	164
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	164
Fletë pune .....	168
<b>Tema 3: Liria – e pakufizuar? .....</b>	<b>171</b>
Çështjet kryesore .....	171
Objektivat e të mësuarit .....	171
Qasje pedagogjike dhe veprimtari .....	172
<b><i>Bibliografi</i> .....</b>	<b>177</b>
<b><i>Sitografi/ Website</i> .....</b>	<b>177</b>



# MODULI 1

Qytetaria, liria e shprehjes dhe e informimit, sigurimi i informacionit, diskutimi demokratik dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës

“Nëse do të ishte e mundur të përcaktonim në përgjithësi misionin e arsimit, do të thoshim që qëllimi i tij themelor është të sigurojë që nxënësit të përfitojnë nga të mësuarit përmes rrugëve që u mundësojnë atyre të marrin pjesë plotësisht në jetën publike, komunitare dhe ekonomike.”

## Hyrje

Zhvillimi i shpejtë i medias dhe i teknologjive të informimit dhe komunikimit (TIK) dhe harmonizimi i komunikimit dhe informimit e bën të domosdoshme që edukimi për median dhe informimin (EMI) të jetë jetësor për fuqizimin e njerëzve. EMI është bërë kusht i domosdoshëm për të lidhur së bashku TIK me edukimin dhe nxitjen e sigurimit të barabartë të informacionit të informacionit dhe dijeve. Shoqëritë në të cilën jetojmë sot drejtohen nga informacioni dhe dijet. Ne nuk mund t'i shpëtojmë pranisë së kudondodhur të medias dhe të gjitha formave të teknologjive të informimit dhe komunikimit dhe rolit që ato luajnë në jetët tona personale, ekonomike, politike dhe shoqërore. Për këtë arsye, është e qartë nevoja për forma të reja të kompetencave për njerëzit (njohuri, aftësi dhe qëndrime) të cilat do t'i ndihmojnë ata të marrin pjesë me efektshmëri dhe të jenë të suksesshëm në të gjitha fazat e jetës në shoqëritë e informacionit dhe të dijes. Kjo ka bërë që EMI të bëhet gjithnjë e më i rëndësishëm për të mësuarit dhe mësime të mëtejshme.

Media dhe ofruesit e tjerë të informacionit janë shumë të rëndësishëm për demokracinë dhe mirëqeverisjen, si platformë për diskutimin demokratik dhe si ofrues të informacionit dhe të dijes. Që media të mbështesë demokracinë, qytetarët duhet të kuptojnë si ta përdorin atë në mënyrë kritike, si të interpretojnë informacionin e marrë, duke përfshirë përdorimin e metaforave, të ironisë dhe të mënyrës në të cilën historitë dhe ngjarjet modelohen për të sugjeruar disa kuptime. Si qytetarë, njerëzit kanë nevojë për kompetenca të veçanta (njohuri, aftësi dhe qëndrime) për t'u marrë me median dhe, në fund, me proceset e tyre politike dhe qeverisjen, si dhe për të përdorur me efektivitet burimet e medias, të bibliotekave, të arkivave dhe të ofruesve të tjerë. EMI ofron një grupim të nevojshëm të kompetencave për shekullin XXI.

Edukimi tradicional duhet të ripërcaktohet në shumë aspekte. Sot nuk mjafton vetëm zotërimi i aftësisë për të lexuar, për të shkruar dhe për të kryer llogaritje matematikore. Ndonëse këto

aftësi nuk duhet të nënvlerësohen, përfshirja e EMI në kurrikul do të thotë që të rinjtë duhet të kuptojnë funksionet e medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit dhe të kërkojnë, të vlerësojnë, të përdorin dhe të krijojnë informacion për të përmbushur synimet e tyre personale, shoqërore, profesionale dhe arsimore.

Ata duhet të zotërojnë aftësitë bazë për të menduarit kritik, për t'i analizuar dhe për t'i përdorur për të shprehur veten, për t'u bërë nxënës të pavarur, prodhues, qytetarë të mirinformuar, profesionistë dhe për të marrë pjesë në qeverisjen dhe proceset demokratike të shoqërive të tyre.

Ky modul është ndërtuar mbi tre shtylla: të menduarit kritik, vetëshprehja dhe pjesëmarrja.

Moduli e trajton EMI të rëndësishëm dhe të ndërthurur me një larmi lëndësh dhe fushash dhe do të përpiqet t'u japë përgjigje pyetjeve të tilla si:

- Ç'është informimi? Ç'është media? Përse duhet të mësohet për ta? Përse janë të rëndësishëm?
- Çfarë është edukimi për median?
- Çfarë është edukimi për informimin?
- Përse është i nevojshëm një edukim për median dhe informimin?

Në këtë modul, EMI trajtohet si një proces i mësimdhënies dhe i të mësuarit dhe jo thjesht si një lëndë më vete. Për këtë arsye, ai do t'i njohë mësuesit me çështjet dhe konceptet themelore të fushës, të cilat do të trajtohen më në hollësi në modulet e tjera, duke u ofruar atyre mundësinë të kuptojnë ndryshimin ndërmjet “mësimdhënies rreth” dhe “mësimdhënies përmes” edukimit për median dhe informimin.

Qëllimi është që mësuesit të arsimohen në fushën e medias dhe informimit dhe të zhvillojnë kompetencat dhe aftësitë e nevojshme për integrimin e EMI në kurrikulën e arsimit parauniversitar.

# Tema 1:

## Të kuptojmë EMI-n. Një këndvështrim

### Çështjet kryesore

- Përcaktimi i informimit dhe medias
- Eksplorimi i rëndësisë së ofruesve të medias dhe i ofruesve të tjerë të informimit
- Përshkrimi i rezultateve kryesore të të mësuarit të edukimit për median dhe informimin

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të këtij moduli mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të identifikojnë rezultatet kryesore të të mësuarit dhe elementet e edukimit për median dhe informimin.
- Të përshkruajnë edukimin për median dhe informimin dhe rëndësinë e tij për jetën e nxënësve dhe mësuesve të sotëm.
- Të eksplorojnë rolin e medias dhe të ofruesve të tjerë të informimit si bibliotekat, arkivat dhe interneti.
- Të eksplorojnë rolet e medias dhe të ofruesve të informacionit në një larmi tekstesh.

# Qasje pedagogjike dhe veprimtari

## Rolet e shumëfishta të medias

Media luan role të ndryshme në proceset e informimit dhe të komunikimit në shoqëri. Në kuadrin e qëllimeve të kurrikulës së edukimit për median dhe informimin, këto përkufizohen (pavarësisht nga natyra e teknologjive të përdorura) si burime të informacioneve aktuale dhe të besueshme, të krijuara përmes proceseve që përcaktohen nga vlerat e gazetarisë ndërkohë që përgjegjshmëria botuese lidhet me një organizatë ose person juridik.

Në rolet e saj të shumëfishta, media:

- ◆ Vepron si kanal i informimit dhe i njohurive përmes të cilave qytetarët komunikojnë me njëri-tjetrin dhe marrin vendim të mirinformuara/mirëmenduara.
- ◆ Lehtëson debatet e informuara ndërmjet aktorëve të ndryshëm social.
- ◆ Na ofron atë që ne dëshirojmë të dimë për botën, përtej përvojës sonë të drejtpërdrejtë.
- ◆ Përbën mjetin me anë të së cilës shoqëria mëson për vete dhe ndërton ndjenjën e përkatësisë në një komunitet.
- ◆ Funkcionon si vëzhgues ndaj qeverisë në të gjitha format e ekzistencës së saj, duke nxitur transparencën në jetën publike dhe analizën publike të atyre me pushtet, përmes denoncimit të korrupsionit, keqadministrimit etj.
- ◆ Është lehtësuese e proceseve demokratike dhe një ndër garantuesit e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.
- ◆ Është mjet për shprehjen dhe kohezionin kulturor brenda dhe ndërmjet kombeve.
- ◆ Funkcionon si mbrojtës dhe aktor shoqëror, ndërkohë që respekton vlerat pluraliste.



## Burimi i informacionit

Përdorimi i duhur i informacionit të ofruar nga media dhe ofruesit e tjerë të informacionit varet nga aftësitë e njerëzve për të kuptuar nevojat e tyre për informacion dhe për të gjetur, për të marrë dhe për të vlerësuar cilësinë e informacionit që ata zotërojnë. Sot ekziston larmi e jashtëzakonshme dhe përzgjedhje e larmishme e materialit informativ, e përmbajtjes dhe e burimeve ekzistuese, veçanërisht në internet, të cilat ndryshojnë në shkallën e saktësisë, të besueshmërisë dhe në vlera. Përveç kësaj, informacioni ekziston në forma të ndryshme e të larmishme (si tekst, pamje, në letër, në formë elektronike etj.) të cilat mund të sigurohen përmes portaleve të ndryshme, përmes bibliotekave reale, përmbledhjeve të dokumentarëve, arkivave etj. Megjithatë, faktori më i rëndësishëm mbetet fakti që cilësia e këtij informacioni luhetet nga “shumë i mirë” në “shumë i keq”.

Përpara se vlerësojmë burimet e informacionit, është e rëndësishme të mendojmë për qëllimin e informacionit. Kjo do të na ndihmojë të identifikojmë burimet e besueshme të informacionit dhe t’u përgjigjemi pyetjeve të tilla si:

- Cili burim ose lloj burimi do të ishte më i besueshëm për sigurimin e informacionit në lidhje me një çështje të veçantë?
- Cilat burime ka të ngjarë të jenë më të ndershme, më objektive, pa motive të fshehta dhe që dëshmojnë cilësinë e tyre?

Ne mund të mendojmë edhe për informacionin e ruajtur nga media dhe ofruesit e tjerë të tij të cilët:

- Informojnë
- Edukojnë
- Lehtësojnë proceset e të mësuarit dhe të mësimdhënies
- Sigurojnë të gjitha llojet e informacionit (shpesh herë pa pagesë, të besueshëm dhe pa kufizime)
- Shërbejnë si portë hyrje drejt informacionit

- Nxisin vlerat universale dhe të drejtat civile si liria e shprehjes dhe e informimit
- Shërbejnë si kujtesë kolektive e shoqërisë
- Mbledhin informacion
- Ruajnë trashëgiminë kulturore
- Zbavitin

## Veprimtari

- ❖ Eksploroni median për të gjetur burime ose tekste që janë shembuj të funksioneve të renditura më sipër. Identifikoni tekste që ilustrojnë këto role në nivel vendor, kombëtar ose ndërkombëtar.
- ❖ Eksploroni bibliotekat publike dhe ato institucioneve arsimore ose burime të tjera të cilat ofrojnë informacione për demokracinë, për pjesë të tjera të botës, për kultura të ndryshme, për jetën shoqërore dhe ekonomike etj. Eksploroni çështje të tilla si:
  - Kush vendos për nivelin e burimeve që duhet t'u shpërndahen bibliotekave?
  - Kush vendos për librat që duhet të jenë pjesë e bibliotekës dhe për ato që duhet të përjashtohen?
  - Cilët janë librat që vlerësohen më të rëndësishëm se të tjerët?
  - A i shërbejnë libraritë qëllimit të tyre?
- ❖ Media luan rol të rëndësishëm në zhvillimin e një vendi. Diskutoni se si kufizimet e tepruara që i imponohen medias mund të pengojnë median në përmbushjen e këtij misioni. Mendoni për përmbajtjen e medias në vendin tuaj. Sa pikëpamje të ndryshme për zhvillimin e vendit dhe për interesat kombëtare mund të gjeni dhe në cilin këndvështrim?

- ❖ Kërkoni në internet për ngjarje që lidhen me shkatërrimin e qëllimshëm të bibliotekave, muzeve, arkivave ose të disa librave të veçantë për shkak të luftërave, konflikteve etnike etj. Sigurisht, në lidhje me këtë çështje, mësuesit mund të mos jenë ndeshur më parë me aftësitë e nevojshme për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve kështu që mos shpenzoni më shumë kohë me këtë çështje, por kaloni në pyetje të tjera.
  - Si mund të ndikojë shkatërrimi i medias, i librarive, arkivave e i ofruesve të tjerë të informacionit, të burimeve dhe i shërbimeve të ofruara nga këto institucione tek njerëzit, tek historia dhe kultura e tyre?
- ❖ Çfarë është informimi publik. Kërkoni si trajtohet informimi publik nga dy institucione qeveritare në vendin tuaj. Diskutoni për përshtatshmërinë (ose mungesën) e informacionit të ofruar nga këto institucione.
  - A ekzistojnë politika kombëtare që rregullojnë mënyrën e të bërit publik të një informacioni?
  - A ekzistojnë ligje për të drejtën e informacionit në vendin tuaj? A zbatohen ato?
  - Cilat janë të drejtat e qytetarëve të përmendura në nenin 19 të DUDNJ?
- ❖ Duke u bazuar në përgjigjet e siguruar nga veprimtaria e sugjeruar më sipër, tregoni rezultatet nga edukimi për median dhe informimin (çfarë duhet të dijë dhe të jetë i aftë të bëjë personi i arsimuar në fushën e medias dhe informimit?). Cila është përmbajtja e secilit prej koncepteve?
- ❖ Bëni një listë të mediave që janë të pranishme në jetën e përditshme të nxënësve dhe të mësuesve.
  - Cili është roli dhe funksioni i secilës prej mediave.
  - Çfarë kuptoni me fjalën “i arsimuar” në fushën e medias dhe të informimit. Cilat janë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme?

- ❖ Mbani një ditar (për një ditë) në të cilin të shënoni ndërveprimin tuaj me median dhe ofruesit e tjerë të informacionit si ofruesit publik dhe privat të informacionit të internetit.
  - Cilat janë modelet e përdorimit që shfaqen në mënyrën se si ju e përdorni median dhe ofruesit e tjerë të informacionit?
  - Sa orë shpenzoni me median dhe teknologjinë si interneti, TV, radio?
  - Cili është roli që këto media dhe ofrues të tjerë të informacionit luajnë në jetën tuaj?
- ❖ Rendisni shembujt e medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit që janë të pranishëm në mjedisin ndërmjet shkollës dhe vendit ku banoni.
  - Cilët prej këtyre roleve të renditura më sipër ilustrojnë këta shembuj?
- ❖ Përfytyroni një ditë pa media, biblioteka, arkiva, internet, telefona. Po kështu, pa gazeta, revista, radio, TV. Analizoni çfarë do t'i ndodhte qytetarëve në një situatë të tillë:
  - Si do të informoheshin ata tani:
  - Si do të komunikonin ngjarjet, faktet, lajmet?
  - Çfarë do të ndodhte me vendimet e jetës së përditshme?
  - Çfarë do t'ju mungonte juve më shumë?
  - Çfarë do të humbiste shoqëria nga një situatë e tillë?
  - Shkruani një letër redaksisë me përfundimet tuaja për vlerën e medias dhe të informimit në një shoqëri demokratike.

## Rëndësia e EMI-t për qytetarët

Edukimi për median dhe informimin sjell së bashku disiplina dhe lëndë që më parë kanë qenë të ndara. EMI synon t'u japë njerëzve mundësinë të kuptojë rëndësinë e medias dhe të ofruesve të tjerë të informimit për të qenë në gjendje:

- Të marrin vendime të mirëmenduara
- Të mësojnë për botën përreth tyre
- Të ndërtojnë ndjenjën e përkatësisë në një komunitet
- Të ruajnë diskutimet publike
- Të përfshihen në të mësuarit gjatë gjithë jetës

EMI duhet të nxisë qytetarët të bëhen prodhues aktivë të informacionit dhe krijues të produkteve të medias dhe të informimit, si dhe mendimtarë kritikë. EMI duhet t'i nxisë ata të përdorin median tradicionale dhe të re për të shprehur veten, për të nxitur aftësinë krijuese dhe për pjesëmarrje më të madhe në demokracinë e vendit dhe në rrjetin ndërkombëtar të informimit.

## Veprimtari

- ❖ Merrni parasysh karakteristikat e EMI të përshkruara më sipër dhe
  - Diskutoni për secilën prej tyre
  - Shkruani çfarë nënkuptojnë ato për ju
  - A mendoni se përshkrimi në fjalë është i plotë?
  - Çfarë mendoni se duhet të plotësohet në të?
- ❖ Shqyrtoni termat e mëposhtëm në lidhje me literaturat e ndryshme që lidhen me EMI dhe që përdoren nga aktorë të ndryshëm kudo:

- Edukimi për median
  - Edukimi për bibliotekat
  - Edukimi për kompjuterin
  - Edukimi për lirinë e shprehjes
  - Edukimi për përdorimin e internetit
  - Edukimi për botën digjitale
  - Edukimi për lajmet
  - Edukimi për kinemanë
  - Edukimi për lojërat
- ❖ Kërkoni përcaktimet e ndryshme të secilit term/koncept, duke përdorur internetin ose një bibliotekë.
- Çfarë vëzhgoni në marrëdhëniet ndërmjet termave ose koncepteve të veçanta të EMI?
  - Përshkruani shkurtimisht mendimin tuaj për harmonizimin e edukimit për median dhe edukimin për informimin.



## Tema 2:

# EMI dhe pjesëmarrja qytetare



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Funksionimi i medias dhe i ofruesve të tjerë të informacionit
- Pritshmëritë e qytetarëve nga media dhe nga ofruesit e tjerë të informacionit
- EMI dhe rëndësia e tij për demokracinë dhe mirëqeverisjen
- Liria e shprehjes, pavarësia botuese e media, pluralizmi dhe larmia në media dhe ofruesit e tjerë të informacionit

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë funksionet e medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit në lidhje me të drejtën për informim dhe njohuri, për të shprehur veten dhe për të marrë pjesë në proceset demokratike.
- Të identifikojnë kushtet e nevojshme që media dhe ofruesit e tjerë të informimit të përmbushin funksionet e tyre.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Burimet e gazetarisë dhe të medias janë të rëndësishme në çdo shoqëri. Pa qytetarët dhe median e lajmeve nuk do të ekzistonin dritaret për të parë botën. Ne do të kishim pak mundësi për të mësuar atë që ndodh në bashkësinë ku jetojmë dhe në botën përtej përvojës sonë të drejtpërdrejtë. Faktorët kryesorë që duhet të respektojnë praktikën e gazetarisë dhe duhet të jenë edhe pritshmëritë e qytetarëve janë:

- ◆ **Njohuritë e organizuara** - organizimi dhe bërja të kuptueshëm e informacionit kaotik si dhe të parit përtej qëndrimit zyrtar për të zbuluar interesat e veçanta.
- ◆ **Vërtetësia** – burimet e informacionit në media duhet të bëhen të qarta, për t'u dhënë mundësi qytetarëve të gjykojnë për rëndësinë e tyre, për besueshmërinë dhe njëanshmëritë e mundshme. Pyetjet e rëndësishme pa përgjigje duhet të shoqërohen me shpresat për t'u trajtuar së shpejti, veçanërisht nëse në lidhje me to ekzistojnë edhe kundërshti.
- ◆ **Interesi publik** – në punën e tyre gazetarët mund të bëjnë shumë për të rritur interesin e publikut, duke i pajisur qytetarët me informacionin e nevojshëm për të marrë pjesë në çështjet publike.
- ◆ **Pavarësia** – duhet të bëhet e qartë që debati qytetar duhet të zhvillohet mbi dhe përtej njëanshmërisë vetjake; komentatorët duhet të shqyrtojnë të “dyja anët e medaljes” (p.sh. të diskutojnë idetë me të cilat janë pro dhe kundër); gazetarët duhet të dëshmojnë të menduarit e pavarur në punën e tyre.
- ◆ **Mjedisi për kritikën publike dhe për zgjidhjen e problemeve** – media duhet të ofrojë disa kanale për të ndërvepruar me publikun (letra, email, kontaktet telefonike ose forumet publike); qytetarët presin që media t'u sigurojë atyre hapësirën dhe kohën për të biseduar në gjuhën e tyre me të tjerët; më tej, ata presin përfaqësim më të gjerë e të dukshëm të pikëpamjeve dhe të vlerave në lajmet.



- ◆ **Përgjegjshmëria dhe llogaridhënia** – media duhet të mbikëqyrë të gjitha ata që ushtrojnë pushtet. Këtu përfshihen jo vetëm qeveritarët por edhe organizmat e rëndësishëm publikë dhe privatë; duke detyruar pushtetin të japë llogari, media ndihmon në informimin e mendimit komunitar.
- ◆ **Lajme të rëndësishme dhe proporcionale** – qytetarët kanë nevojë për njohuritë e duhura për çështje dhe prirje të rëndësishme; Lajmet nuk duhet të mbivlerësojnë ose të nënvlerësojnë natyrën e vërtetë të kërcënimeve dhe të rreziqeve.
- ◆ **Baraspesha ndërmjet të drejtës për jetë private dhe të drejtës për informacion** – qytetarët presin që profesionistët e medias të marrin parasysh e të respektojnë të drejtën e publikut për informacion dhe të drejtën e personit për jetë private.

## E drejta për informim

E drejta për informim është një e drejtë themelore, si për demokracinë ashtu edhe për zhvillimin. Qytetarët kanë të drejtë për lirinë e fjalës dhe të drejtën për informacionin publik. Ky informacion është pronë e qytetarëve. Media dhe ofruesit e tjerë të informacionit duhet të ndihmojnë për të siguruar këtë të drejtë për çdo qytetar.

Roli i medias dhe i ofruesve të tjerë të informacionit po ndryshon me shpejtësi si rrjedhojë e përhapjes së teknologjisë. TIK i ofron informacionet dhe njohuritë në çast. Media dhe i ofruesit e tjerë të informacionit janë në gjendje të sigurojnë shërbime të reja dhe po bëhen më shumë se qendra burimore ose ofrues informacioni. Këto mundësi të reja ofrojnë edhe shanse për plotësimin më cilësor dhe të efektshëm të nevojave të qytetarëve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për kërkime dhe zbatimje dhe për të lidhur komunitetet me njeri-tjetrin.

Media dhe ofruesit e informacionin kanë disa funksione kryesore. Ata:

- Ofrojnë mundësinë për të përdorur burimet e informacionit pa kufizime racore, gjinore, profesionale dhe fetare. Në mënyrë të veçantë, bibliotekat publike i ofrojnë këto shërbime falas.
- Mbrojnë privatësinë dhe fshehtësinë e lexuesit në lidhje me përmbajtjen e konsultuar në mjediset e tyre ose online.
- Sigurojnë përdorimin e burimeve të informacioneve të larmishme dhe të shumta, duke u bazuar në profesionalizëm dhe pa njëanshmëri politike, fetare ose morale.
- Mbledhin dhe ruajnë informacion për brezat e ardhshëm.

## Veprimtari

- ❖ Duke përdorur bibliotekat dhe burimet e internetit, kërkoni 5-10 histori lajmesh nga vendi ose bota të vitit të kaluar. Identifikoni se cila prej pritshmërive të renditura më sipër ndeshen në secilën histori.
  - Cilët janë elementët mbi bazën e të cilin i vlerësojmë si shembuj të efektshëm. Për ngjarjet që nuk i përmbushin pritshmëritë, sugjeroni ndryshimet e duhura.
- ❖ Shkruani një ese të shkurtër duke argumentuar detyrimet e lexuesit për të qenë të hapur ndaj lajmeve dhe jo me dëshirën paraprake për të përforcuar e justifikuar opinionet ekzistuese.
- ❖ Përzgjidhni një çështje ose ngjarje të trajtuar në median vendore dhe shqyrtojeni atë më në thellësi. Të jesh i arsimuar në fushën e medias dhe të informimit, do të thotë edhe që jesh i vetëdijshëm për kriteret që duhen përdorur për trajtimin e çështjeve të ndryshme, por edhe të kesh zotësinë për t'i zbatuar ato.

- Sa përmbushen nga shembujt e medias vendore pritshmëritë e qytetarëve?
  - Cili është ndikimi që prodhojnë këto trajtime në komunitetin vendor?
  - Cili është roli që mund të luajë edukimi për median dhe informimin në mbështetje të qytetarëve?
- ❖ A e pranoni që qytetarët e mirinformuar janë më të aftë të marrin vendime dhe të marrin pjesë në një shoqëri demokratike? Përse? Shkruani një paragraf për të argumentuar opinionin tuaj.
- ➡ **DISKUTONI:** Si shikohet dhe vlerësohet roli i informimit në shoqërinë tonë? Çfarë mendoni për marrëdhëniet ndërmjet informacionit dhe njohurive dhe për marrëdhëniet ndërmjet informacionit dhe pushtetit?

## Liria e shprehjes, pavarësia botuese, pluralizmi dhe diversiteti

Liria e informimit dhe e shprehjes qëndron në themel të edukimit për median dhe informimin. Në këtë kontekst, përdorimi i konceptit “liri e informimit” lidhet me garantimin e informimit publik. Informimi është kyçi për të kuptuar botën përreth nesh, aftësi jonë për të gjetur rolin tonë në të dhe zotësia për të përfituar nga burimet ekzistuese. Kur informacioni përqendrohet në duart e elitave, atëherë zotësia e publikut për të marrë vendime dhe për t’u njohur me vendimet cenohet pa masë. Një media etike dhe pluraliste mund të sigurojë transparencën, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe shtetin e së drejtës. Media e pavarur e merr pushtetin nga përgjegjësia që tregon ndaj komunitetit të cilit i shërben.

## Liria e shprehjes dhe shtypit

Liria e shprehjes është liria për të shprehur dhe për të shkëmbyer pikëpamjet dhe opinionet pa pasur frikë nga kërcënimet dhe veprimet ndëshkuese. Liria e shprehjes është e drejtë themelore e njeriut. E drejta për lirinë e shprehjes mbron jo vetëm lirinë e fjalës, por edhe çdo akt të kërkimit, të marrjes dhe të përhapjes së informacionit ose të ideve, pavarësisht nga mjeti i përdorur për këtë qëllim. Liria e shtypit është kusht për këtë të drejtë, pasi i jep mundësi shprehjes së lirë të bëhet publike dhe, si e tillë, bëhet bazë për ndërtimin dhe mbështetjen e komunitetit. Liria e shprehjes mund të nxisë ndjenjën e përkatësisë në shoqëri, duke u dhënë mundësi individëve të shqyrtojnë dhe të shprehin mendime dhe opinione të ndryshme. Liria e shprehjes është pjesë integrale e përgjegjësisë qytetare dhe është thelbësore për të menduarit kritik. Kufizimet e lirisë së shprehjes lejohen vetën kur këto kufizime janë të domosdoshme për të mbrojtur lirinë e të tjerëve. Kufizimet, si ligjet që parandalojnë “të folurit që përmban urrejtje”, duhet të përcaktohen mirë për të shmangur keqpërdorimin e tyre.

## Pluralizmi i medias

Një sektor i medias pluraliste, ai që shënon platformat mediatike (shtypi, lajmet, online) vendore (kombëtare, vendore dhe komunitare) dhe këndvështrimet politike, e ndihmon shoqërinë të reflektojë më mirë për veten. Kur veprimet e medias shpërndahen në shumë duar, edhe opinionet e veçanta dhe jo sunduese mund të gjejnë një mjedis për t’u shprehur. Harmonizimi i efektshëm i mjeteve të medias vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare mund t’u japë njerëzve mjetet për të marrë pjesë më proceset demokratike. Përhapja më e madhe e informacionit nga burime të larmishme dhe kundërshtarë kontribuon në mirëqenien e njerëzve. Ndërsa gazetatat dhe agjencitë e lajmeve në pronësi të ndryshme, përgjithësisht, kritikojnë përmbajtjen e njëri-tjetrit, mediat e përqendruara dhe në pronësi të përbashkët janë larg kritikizmit të ndërsjellë dhe mund të çojnë në një media që vepron në fushën e reklamave dhe të mbështetjes.

## Gazetaria e pavarur

Gazetaria e pavarur nënkupton lirinë profesionale të besuar tek botuesit për të marrë vendime pa ndërhyrjen e pronarëve të medias ose të aktorëve të tjerë shtetërorë ose jo shtetërorë. Pavarësia botuese provohet, për shembull, kur një organizatë e medias shkruan artikuj që mund të mos pëlqehen nga pronarët ose autorët e reklamave.

## Veprimtari

- ❖ Përdorni burimet e internetit ose të bibliotekave për të bërë kërkime për pronësinë dhe kontrollin e kompanive të mëdha dhe të monopoleve të medias së sotme. Renditni pronat e tyre.

- Cili është ndikimi që kjo pronësi mund të ketë në përdorimin, zgjedhjen dhe lirinë e shprehjes?

Kërkoni për ligjet që rregullojnë pronësinë dhe kontrollin e medias në vendin ose në komunitetin tuaj.

- ❖ Vlerësoni rolin e mediave alternative ose të pavarura që veprojnë në komunitetin tuaj. Zgjidhni një prej shembujve dhe përshkruani karakteristikat kryesore që e bëjnë atë të pavarur.

- Cilat janë mënyrat në të cilat ajo u mundëson njerëzve të marrin pjesë në proceset demokratike? Në ç'drejtime ndryshon ajo nga mediat e zakonshme?

- ❖ Bëni një kërkim për organizatat e punës që mbështesin dhe nxisin lirinë e shprehjes ose mbrojnë gazetarët të tilla si Neni 19, Komiteti për mbrojtjen e gazetarëve, Gazetarë pa kufij ose OJF vendore dhe kombëtare. Përqendrohuni në punën e gazetarëve që mbështeten nga këto organizata dhe identifikoni elementet kryesore të punës së tyre për të cilën ia vlen të mbështeten.

- ❖ Diskutoni, përse qeveritë duhet të respektojnë të drejtën e medias për pavarësi botuese dhe, në mënyrë të veçantë,

duhet të kufizojnë vendosjen e presioneve mbi median, në lidhje me lajmet e tyre dhe çështjet aktuale që trajtojnë. Në këtë kuadër, diskutoni për citatin e ish presidentit të Filipineve, Korason Akuino që çoi në transformimin e qeverisjes autokratike të vendit të tij në një demokraci:

*“Koncepti i lirisë së shtypit ndërthuret aq ngushtë me demokracinë saqë një udhëheqës duhet të trajtojë me shumë kujdes çdo përpjekje për të imponuar edhe kufizimet ligjore mbi të. Rreziqet janë të mëdha, jo vetëm për reputacionin e tij si udhëheqës demokratik, por për virtytet dhe përkushtimin e tij ndaj demokracisë. Sepse tundimi drejt totalitarizmit është i pakufi dhe gjithmonë gjenden servilë të gatshëm të zgjerojnë me dhunë kuptimin e demokracisë, për të përfshirë në të edhe larminë e mëkateve despotike”.*

- ❖ Shtriheni diskutimin për ndikimet e mundshme ndaj pavarësisë botuese dhe sugjeroni si mund të ndalohen këto ndikime.
- ❖ Diskutoni çfarë kuptoni me një përcaktim të ngushtë të ligjit.

## Tema 3:

# Ndërveprimi i medias me ofruesit e tjerë të informacionit



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Si e komunikon media kuptimin
- Çështja e paraqitjes: Në ç'mënyrë media dhe ofruesit e tjerë të informacionit i paraqesin njerëzit, kulturat, pamjet, vendet etj.
- Roli i përdoruesve, i qytetarëve dhe i audiencës
- Përfshirja e medias përmes prodhimit të përmbajtjes që bazohet te përdoruesi

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë konceptet kryesore që përdoren nga media dhe ofruesit e tjerë të informacionit.
- Të përshkruajnë se si zotërimi i këtyre koncepteve do të ndihmojë përdoruesit/qytetarët të ndërveprojnë në mënyrë kritike me median dhe me përdoruesit e tjerë të informacionit.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Për edukimin për median është e rëndësishme të kuptohet mënyra se si media ndërton tipologji të ndryshme të ngjarjeve, si e modelon informacionin që paraqet dhe cilat janë teknikat që përdor për të organizuar materialin që përndryshe do të ishte kaotik dhe i vështirë për t'u kuptuar. Për këtë arsye, është e rëndësishme për të kuptuar teknikat e ndryshme që përdoren nga mediat, kodet që përdorin dhe mënyrën si i interpretojnë ato. Po kështu, mund të jetë e rëndësishme të merret parasysh edhe kush e prodhon dhe e organizon materialin dhe sa aktivë ose ndërveprues janë konsumatorët e medias dhe të informacionit – nëse perceptimet e tyre ndikojnë në mënyrën e paraqitjes së informacionit.

Për të kuptuar më mirë mënyrën e veprimit të medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit, të mënyrës si ata e përçojnë informacionin, dhe si mund të përdoret, të paraqitet e të vlerësohet ai, duhet të shqyrtohen më nga afër fushat e mëposhtme, të cilat qëndrojnë në themel të moduleve të kurrikulës së EMI

## Gjuha në media dhe informacion

- ◆ Në ç'mënyrë prodhuesit e një teksti mediatik përdorin teknikat ose mënyrat e ndryshme të paraqitjes së llojeve të ndryshme të informacionit për të komunikuar?
- ◆ Si identifikohen dhe si pranohen këto përdorime nga publiku i gjerë?
- ◆ Cilat janë kodet dhe rregullat ose “përbërësit kryesorë” ose gramatika e një mjete të veçantë?
- ◆ Një komentues i medias, Marshall McLuhan, shkruan: “Mjeti është mesazhi” që do të thotë që vetë mjeti – shkrimi, transmetimi, interneti – ndikon në mënyrën si ne kuptojmë botën.
  - Si ndikon zgjedhja e medias në llojin e informacionit që ne marrim?



- Si e modelon ajo mesazhin e transmetuar përmes medias?

## **Paraqitja në media dhe informacioni**

- ◆ Shqyrtoni pamjet ose paraqitjet në media.
- ◆ Analizoni pamjen ose tekstin në media.
- ◆ Analizoni kontekstin.
- ◆ Kush përfiton nga pranimi i paraqitjeve në media dhe ku humbet?
- ◆ Si ndikojnë këto pamje mënyrën si ne shohim veten dhe të tjerët?
- ◆ Si ndikojnë ato në njohjen dhe të kuptuarit e botës përtej përvojës së drejtpërdrejtë me të?
- ◆ Si ndikojnë ato në pikëpamjen tonë për barazinë gjinore, fuqizimin e grave, jetesën e njerëzve me aftësi të kufizuara ose të pakicave etnike?
- ◆ Shqyrtoni shkallën në të cilën pasqyrohet në tekstet e medias pavarësia botuese.

## **Përmbajta që bazohet te prodhuesi/ përdoruesi**

Këtu mbahen parasysh:

- ◆ Kush i krijon testet e medias dhe të informacionit dhe përse?
- ◆ Lidhjet me të drejtën e komunikimit dhe të shprehjes për qytetarët dhe profesionistët
- ◆ Lidhjet me lirinë e shprehjes, qytetarinë aktive dhe edukimin për median dhe informimin

- ◆ Burimet (njerëzore, financiare, teknologjike etj.) dhe rregullat.

## **Audienca si qytetarë dhe përdorues/konsumatorë**

- ◆ Audiencat e synuara dhe aktive
- ◆ Qytetarët aktivë dhe përdoruesit/konsumatorët merren vesh për të kuptuarit e tyre, duke u bazuar në atë që sjellin në një tekst.
- ◆ Audiencat kanë pritshmëritë nga industritë e medias, duke u bazuar në transparencën, dhënien e llogarisë dhe ndershmërinë.
- ◆ Përdoruesit/konsumatorët kanë nevoja personale, ekonomike, sociale dhe kulturore për informacion

## **Qytetarët si përdorues/konsumatorë të shërbimeve të ofrimit të informacionit**

- ◆ Në ç'mënyrë ofruesit e informacionit i përzgjedhin burimet e informacionit dhe kriteret kryesore të përzgjedhjes?
- ◆ Në ç'mënyrë ofruesit e informacionit nënshkruajnë ose blejnë burimet e informacionit si librat, revistat, bazat e të dhënave?
- ◆ Në ç'mënyrë financohen ofruesit e informacionit duke përfshirë ofruesit publik ose privatë të informacionit në internet?
- ◆ Në ç'mënyrë ofruesit e informacionit sigurojnë të ardhura nga shërbimet informative?

## Çështje kryesore

- Cili është qëllimi i teksteve të medias/informacionit?
- Si prodhohet ai?
- Kush e krijon
- Cila është audienca që synohet? Si e kuptoni këtë?
- Cili është mesazhi kryesor?
- Kush përfiton dhe çfarë përfitohet?
- Cilat janë nevojat e mia për informacion?
- Si t'i identifikoj këto nevoja dhe si t'i përcaktoj ato?
- A ekziston informacioni, për të cilin kam nevojë, në formën që më nevojitet mua? Nëse jo, si duhet të veproj për ta pasur të tillë?
- Si ta kuptoj, ta organizoj dhe ta vlerësoj informacionin e gjetur?
- Si ta paraqes këtë informacion në një formë të përdorshme?
- Si ta ruaj, ta magazinohet dhe ta ripërdor, ta regjistroj dhe ta arkivoj?

## Veprimtari

- ❖ Zgjidhni një tekst nga media ose informacioni dhe përdorni çështjet kryesore të renditura më lart. Çfarë mund të mësoni për prodhimin dhe industrinë e medias, mesazhet e përçuar si dhe audiencën e synuar?
- ❖ Mendoni për një veprimtari personale ose ekonomike që do të dëshironit të ndërmerrenit. Hidhni këtë në letër. Përdorni çështjet e mësipërme duke filluar me përgjigjen e pyetjes “Cilat janë nevojat e mia për informacion?”
- ❖ Shkruani të gjitha veprimtaritë që kryeni gjatë një dite, që

nga çasti që zgjoheni e deri sa shkoni në shtrat. Analizojini këto në grupe të vogla: A keni nevojë për informacion për të marrë pjesë në këto veprimtari? Shkruani, përbri çdo veprimtarie, informacionin për të cilin keni nevojë. Për shembull,

- ju keni nevojë të dini sa është temperatura përjashta, për të vendosur për veshjen tuaj;
- ju keni nevojë të dini gjendjen e trafikut, përpara se të merrni autobusin;
- ju keni nevojë të dini për ekonominë, përpara se të vendosni për të marrë një kredi.

### **Diskutoni:**

- Sa i rëndësishëm është informacioni në jetën tuaj të përditshme? Sa e vështirë do të ishte të merrnit vendime pa pasur informacionin e duhur?
- ➔ Duke përdorur bibliotekat ose internetin kërkoni disa prej programeve kryesore të TV ose të radios, filmat ose reklamat nga viti i kaluar.
  - Cilat prej temave nga lista e mësipërme ishin qendrore për suksesin e tyre?
  - Përshkruani mënyrën në të cilën një ose disa prej temave të mësipërme theksohen nga ky shembull.
- ➔ Shpjegoni, përse gazetarët duhet të kenë të drejtën të mos zbulojnë burimin e informacionit të tyre, përveç atë të botuesve të tyre?
- ➔ Diskutoni pohimin “Gazetaria është disiplina e verifikimit”

## Tema 4:

# EMI: Mësimdhënia dhe të mësuarit



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Të kuptuarit e EMI dhe procesi i mësimdhënies dhe i të mësuarit
- Qasjet pedagogjike për EMI
- Mësimdhënia rreth dhe përmes EMI

### Objektivat e të mësuarit

Pas përfundimit të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të identifikojnë rrugët me të cilat EMI do të rrisë proceset e mësimdhënies dhe të mësuarit.
- Të eksplorojnë qasjet pedagogjike që lidhen me EMI.
- Të zhvillojnë veprimtari të veçanta që përdorin këto qasje pedagogjike.

### Qasje pedagogjike dhe veprimtari

#### Qasja që bazohet në kërkimin e një çështjeje

Të mësuarit në bazë të kërkimit të çështjeve është një qasje e të mësuarit me në qendër nxënësin dhe përqendrohet në çështjet që lidhen me EMI në shoqërinë e sotme. Ai përfshin shumë prej

tipareve të të mësuarit që bazohet tek kërkimi, të zgjidhjes së problemit dhe të vendimmarrjes, ku nxënësit fitojnë njohuri dhe aftësi të reja përmes fazave të kërkimit: identifikimi i çështjes; njohja dhe pranimi i qëndrimeve dhe besimeve që qëndrojnë në themel të tyre; qartësimi i fakteve dhe parimeve prapa çdo çështjeje; gjetja, organizimi dhe analiza e fakteve; interpretimi dhe zgjidhja e çështjes; ndërmarrja e veprimit dhe rishqyrtimi i pasojave dhe i rezultateve nga secila fazë.

Kjo metodë është e përshtatshme për mësimdhënie, pasi nxënësve u jepen shanset të eksplorojnë çështjet në thellësi. Në shembujt e kësaj qasjeje kërkimore në EMI përmendim: eksplorimin e portretizimeve të gjinisë dhe të racës përmes analizës së medias dhe eksplorimi i privatësisë dhe medias përmes analizës së dokumenteve parësore dhe dytësore; eksplorimi i dhunës kibernetike (cyber bullying) përmes kërkimeve etnografike.

## **Të mësuarit përmes problemit**

Të mësuarit përmes problemit është një zhvillim kurrikular dhe një sistem arsimor që njëherazi zhvillon njohuritë dhe aftësitë bazë ndërlëndore të nxënësve si dhe strategjitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve. Është një mënyrë të mësuarit në bashkëpunim që rrit njohuritë individuale dhe ato kolektive përmes përfshirjes së nxënësve në kërkimin e thellë e kritik të problemeve të jetës reale. Objektivat mësimorë, pyetjet dhe metodat kërkimore si dhe rezultatet menaxhohen nga nxënësit. Shembull i kësaj qasjeje është projektimi i një fushate marketingu shoqëror për një audiencë të caktuar.

## **Kërkimi shkencor**

Kërkimi shkencor lidhet me larminë e teknikave që përdorin shkencëtarët për të eksploruar botën natyrore dhe për të propozuar shpjegime që bazohen në faktet e gjetura. Proces i kërkimit shprehet, shpesh, si një radhë hapash të thjeshtëzuar që quhen cikli i kërkimit, i cili përfshin veprimtari të tilla si: kryerja

e vëzhgimeve, bërja e pyetjeve, gjetja e asaj që është e njohur; planifikimi i hetimit; vlerësimi i njohurive paraprake në dritën e fakteve eksperimentale; përdorimi i mjeteve për të mbledhur, për të analizuar dhe për të interpretuar të dhënat; propozimi i shpjegimeve dhe komunikimi i rezultateve. Kjo metodë mund të përfshihet në mësimdhënien e EMI. Shembuj të metodës së kërkimit shkencor në EMI mund të jenë shqyrtimi i ndikimit të dhunës në media ose i rolit të komuniteteve online.

## Studimi i rastit

Metoda e studimit të rastit përfshin shqyrtimin e thelluar të një çasti ose të ngjarjeve të vetme. Në rastin EMI, nxënësit përballesh me forma të ndryshme mesazhesh nga media, gjë që kërkon shikimin sistematik të ngjarjeve, të mbledhjes së të dhënave, të analizës së informacionit dhe të komunikimit të rezultateve, të cilat, nga ana e tyre, mbështesin të mësuarit përmes kërkimit. Nxënësit janë në gjendje të kuptojnë më thellë dhe më gjerë arsyen e ngjarjeve ose të fakteve me të cilat ndeshen. Studimi i rastit çon në gjenerimin e hipotezave dhe në nevojën për t'i provuar ato.

## Të mësuarit në bashkëpunim

Të mësuarit në bashkëpunim nënkupton qasjen mësimore që i bashkon nxënësit në kryerjen e një pune të përbashkët për të përmbushur synime të përbashkëta. Të mësuarit në bashkëpunim përfshin që nga puna në dyshe e deri në detyra më komplekse siç janë projektet, mësimdhënia e ndërsjellë etj., të cilat synojnë të sjellin përmirësimin e të mësuarit dhe zhvillimin e të kuptuarit konceptual dhe të aftësive të menduarit të nivel të lartë, aftësi më të mira ndërpersonale, qëndrime më pozitive ndaj shkollimit dhe vetes etj. Në fushën e EMI, kjo metodë kërkon shkëmbimin e ideve dhe të mësuarit nga njëri-tjetri, për shembull, duke punuar së bashku në një hapësirë Wiki.

## Analiza e teksteve

Nxënësit mësojnë të ndërmarrin analiza të teksteve përmes identifikimit të kodeve dhe organizimit të gjinive të ndryshme të medias. Me këtë lloj analize, mund të rritet të kuptuarit e koncepteve kryesore. Për shembull, nxënësit mësojnë si përdoret gjuha së kodeve dhe mënyra e organizimit të tyre për të krijuar lloje të ndryshme paraqitjesh tërheqëse për audiencë të caktuar. Nxënësve u mësohet të identifikojnë kodet teknike, simbolike dhe përshkruese të çdo teksti të medias. Atje ku është e mundur, kjo lloj analize duhet të bëhet në kontekstin e duhur dhe jo thjesht për t'u ushtruar në fushën akademike, si qëllim në vetvete.

Në kuadrin e EMI, nxënësve u kërkohet të përzgjedhin një tekst nga media që është në interesin e tyre, një artikull, një video etj. Dhe, në grupe, u kërkohet të analizojnë audiencën qëllimin, autorin, teknikën, tiparet e të shkruarit dhe kontekstin.

## Analiza e kontekstit

Nxënësve u tregohet si të ndërmarrin një analizë kontekstuale, veçanërisht për konceptet kryesore që lidhen me median dhe ofruesit e tjerë të informacionit, por edhe në lidhje me një sërë qasjesh teorike për EMI. Për shembull, nxënësit ndihmohen të mësojnë sistemet e klasifikimit për filmin, televizionin dhe videolojërat që veprojnë në vend ose në ç'mënyrë lidhet pronësia dhe përqendrimi i saj mbi median me çështjet e demokracisë dhe të lirisë së fjalës.

## Përkthimet

Me anë të kësaj qasjeje, nxënësit marrin informacionin e paraqitur në një formë të caktuar të medias dhe e shndërrojnë ose e përkthejnë atë në një lloj tjetër forme të saj. Për shembull:

- Zgjidhni një artikull gazete të shkruar për një incident në universitet dhe e ktheni në një ngjarje që do të transmetohet në radio.



- Pasi të shikoni një përzgjedhje të shkurtër të një filmi për fëmijë, punoni në grup për të ndërtuar një ngjarje që lidhet me skenat, duke përcaktuar skenat, këndvështrimet dhe hapat që janë përdorur.
- Zgjidhni një përrallë dhe shndërrojeni atë në një skenar filmi.
- Përdorni një përmbledhje materialesh pamore për jetën e një personi, si pikënisje për të planifikuar bërjen e një dokumentari të shkurtër për të.

## Simulimi

Simulimi përdoret shpesh si një strategji në njësitë e filmit dhe të një kurrikule për median.

Mësuesit e përdorimin simulimin për t'u treguar nxënësve si duket të mësuarit për median.

Simulimi mund të përdoret në mënyra të ndryshme:

- Nxënësit marrin rolin e një ekipi për prodhimin e një dokumentari për një program televiz që i kushtohet të rinjve.
- Nxënësit marrin rolin e gazetarëve që po bëjnë një kërkim për mësimdhënien në media dhe u kërkohet të intervistojnë një mësues që ushtron këtë mësimdhënie. Ata duhet të redaktojnë materialin e regjistruar nga intervista.
- Nxënësit marrin rolin e një ekipi reklamash nga shkolla dhe përgatisin një video të shkurtër me anë të së cilës paraqesin këndvështrimet e tyre për jetën në shkollë.

## Prodhimi

Kjo qasje nënkupton të mësuarit përmes të bërit, si një aspekt i rëndësishëm për fitimin e njohurive. Nxënësit duhet të nxiten të eksplorojnë të mësuarit në nivele më të thella dhe

më të qëllimshme. Prodhimi i përmbajtjes së medias dhe të informacionit ofron shanse për nxënësit që të përfshihen në procesin e të mësuarit përmes eksplorimit dhe të bërit. Përmes përgatitjes së teksteve mediatike (p.sh. audio, video etj.) nxënësit do të jenë të gjendje të eksplorojnë fushën e krijimtarisë dhe të shprehin veten përmes zërave, ideve dhe këndvështrimeve të tyre.

Kështu, nxënësit mund të përdorin programet pa pagesë si iMovie ose Movimaker etj. për të përgatitur ngjarje të shkurtra digjitale për çështje të mjedisit ose për çështje të tjera që u interesojnë.

## Veprimtari

- ❖ Kërkoni nga mësuesit të identifikojnë dhe të përshkruajnë shembuj të ndonjëres prej qasjeve për të mësuarit dhe mësimdhënien e EMI për të identifikuar përbërësit kryesorë që i bën ato të efektshme në këtë edukim.
- ❖ Duke punuar në grup, drejtoni mësuesit për të zhvilluar veprimtari që do të ilustronin këto strategji në punën e tyre



# MODULI 2

## Lajmet, media dhe etika e informimit

“Qëllimi qendror i gazetarisë është të tregojë të vërtetën, që njerëzit të kenë informacionin që u duhet për të qenë të aftë të qeverisin veten”

Jack Fuller

## Hyrje

Teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit e kanë shumëfishuar përdorimin dhe ndikimin e medias tradicionale (radio, TV dhe gazetat) dhe informacioni e lajmet janë më të pranishme se kurrë. Në këtë kohë informacioni, gazetarët, profesionistët e informimit dhe media e lajmeve (e vjetër dhe e re) luajnë rol qendror duke na siguruar informacion përtej përvojës sonë të drejtpërdrejtë dhe për të lehtësuar pjesëmarrjen qytetare në mirëqeverisje dhe në shoqëri të hapura dhe të qëndrueshme.

Ky modul do të eksplorojë rolin dhe funksionin e medias së lajmeve dhe të ofruesve të tjerë të informacionit në jetën tonë personale dhe shoqërinë demokratike, të tilla si: rritja e lirisë demokratike dhe etikës së informimit, ndërtimi i përgjegjësisë qytetare dhe të qytetarisë dhe kërkesa dhe nxitja e transparencës dhe llogaridhënies. Ai do të ofrojë një tablo të rolit në rritje të medias së lajmeve, nga roli i saj i thjeshtë si pasqyrë e shoqërisë, deri në atë të qenit një portë hyrëse e informacionit, mbikëqyrës i funksionit të ndarjes dhe harmonizimit të pushteteve, lehtësues i debatit publik dhe i pjesëmarrjes qytetare.

Moduli do t'u japë mësuesve mundësinë të eksplorojnë çështje të tilla si liria e informimit dhe liria e shprehjes si dhe rëndësia e saktësisë, llogaridhënies dhe të transparencës në raportimin e lajmeve.

Si rrjedhojë e teknologjive të reja, ne jemi dëshmitarë të rritjes së përmbajtjes që bazohet tek përdoruesi, si raportimet e qytetarëve në rolin e dëshmitarëve pamorë. Në një rën anë, kjo dukuri na paraqet larminë e zërave dhe të këndvështrimeve, në anën tjetër ajo përforcon nevojën për të vlerësuar në mënyrë kritike burimet e shumta të lajmeve dhe informacioneve të sotme. Duke u arsimuar në fushën e medias dhe të informimit, mësuesit do të jenë të aftë jo vetëm të analizojnë dhe të vlerësojnë informacionin dhe lajmet që marrin për ditë, por edhe të ushtrojnë përgjegjësitë e tyre qytetare për të kërkuar raportimin e saktë dhe të paanshëm të lajmeve, si dhe të luftojnë për një media të lirë, të pavarur dhe pluraliste.

# Tema 1:

## EMI: Gazetaria dhe shoqëria



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Evolucion i konceptit dhe i praktikës të lirisë së shprehjes dhe të lirisë së shtypit.
- Qëllimi i gazetarisë në shoqëri dhe roli i saj për demokracinë (liria, përgjegjësia qytetare, transparenca dhe llogaridhënia).
- Roli dhe përgjegjësia e gazetarëve në shekullin XXI në realitetin kombëtar dhe ndërkombëtar (pasqyrë, rojtar, mbikëqyrës, lehtësues).
- Gazetaria në interes të publikut, pavarësia botuese përkundrejt ndikimit të pronësisë
- Roli i etikës së informimit

### Objektivat e të mësuarit

Pas përfundimit të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të ndjekin zhvillimin e konceptit dhe të praktikës së “fjalës së lirë” dhe të “shtypit të lirë”.
- Të përcaktojnë qëllimin e gazetarisë dhe të rolit të saj në fuqizimin dhe ndjekjen e demokracisë, të mirëqeverisjes
- Të vlerësojnë zhvillimin e rolit dhe të përgjegjësive së gazetarisë dhe të profesionistëve të informimit, në fushën

kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në kontekstin e interesit publik.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

*Qytetërimi ka krijuar një ide më të fuqishme se të tjerat – idenë se njerëzit mund të qeverisin veten. Ai ka krijuar edhe një teori informacioni të nënkuptuar, që e mbështet këtë ide, e cila quhet gazetari. Të dy ngrihen dhe bien së bashku. (Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel, Elementet e gazetarisë).*

Liria e shprehjes, e njohur shpesh si fjala e lirë, është vlerësuar si një e drejtë themelore, thelbësore për realizimin e potencialit të plotë njerëzor, themel edhe i të drejtave dhe i lirive të tjera, që janë në themel të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Liria e shprehjes ka nevojë për platforma publike që lejojnë shkëmbimin e efektshëm të informacionit dhe të ideve dhe, për rrjedhojë, edhe për rëndësinë e medias në sigurimin e këtyre platformave. Për të përmbushur këtë funksion, media duhet të jetë e pavarur nga kontrolli i pushteteve. Kjo liri vendos detyrimin tek gazetarët për t'u sjellë në mënyrë etike, si dhe të kodeve profesionale që trajtojnë standardet e gazetarisë.

Veprimtaritë e mëposhtme shërbejnë për trajtimin e çështjeve të tilla nga trajnerët.

### Veprimtari

- ❖ Mësuesve u jepet detyra për të bërë kërkime dhe për të raportuar për zhvillimin e “fjalës së lirë” dhe të “shtypit të lirë” në vendin e tyre. Pikat kryesore të kërkimit dhe të raportimit janë:
  - Zhvillimet historike të teorisë dhe të praktikës së e “fjalës së lirë” dhe të “shtypit të lirë”.

- Gazetarët dhe agjencitë e mediave që kontribuojnë në mënyra të veçanta të lirisë së shtypit dhe të demokracisë.
  - Ngjarjet në zhvillimet demokratike ku media dhe raportimi i lajmeve luajnë rol të rëndësishëm.
- ❖ Nëse është e mundur, trajneri u jep mësuesve detyrën të intervistojnë gazetarë për pikëpamjet e tyre për rolin e gazetarisë në zhvillimin e demokracisë. Të intervistuarve u kërkohet të citojnë shembuj të veçantë kur mbulimi i medias ka luajtur rol qendror në panoramën kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe në menaxhimin e tensioneve të mundshme ndërmjet interesave të pronësisë dhe interesit të publikut. Mësuesit mund të shkruajnë reflektimet e tyre për rezultatet e intervistës, duke treguar edhe funksionet e veçanta të medias, rrugët në të cilat vepron media dhe çështjet kryesore të trajtuara.

## Rekomandime për vlerësimin

- ➔ Reflektim me shkrim për rezultatet e leximeve dhe/ose të intervistave
- ➔ Ese për çështjet që lidhen me median dhe demokracinë
- ➔ Pjesëmarrja në veprimtari të mësuarit në grup (workshope, diskutime etj.)

## Çështje për shqyrtime të mëtejshme

- ➔ Studime rasti për një shtyp të kontrolluar
- ➔ Propaganda ndaj gazetarisë



## Tema 2:

# Liria, etika dhe llogaridhënia



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Liria e shtypit, liria e shprehjes, liria e informimit dhe etika e informimit
- Kodet e etikës, kodet e praktikës dhe vlerat globale në studio lajmesh: udhëzime për gazetarët dhe profesionistët e informimit.
- Liria e shtypit dhe rregullatorët e medias.
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve: lidhja e gazetarëve me qytetarët.
- Raportimet e qytetarëve dhe përmbajtja që bazohet tek përdoruesi.

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajë parimet e përgjithshme të lirisë së shtypit, të lirisë së shprehjes dhe të lirisë së informimit dhe rëndësinë e tyre për raportimin e lajmeve.
- Të analizojë si zbatohet etika në praktikën e gazetarisë dhe profesionistët e informimit në nivel personal, profesional dhe global.
- Të vlerësojnë rolin e mbrojtësve të lirisë së shtypit dhe të rregullatorëve të medias në ndjekjen dhe mbrojtjen e lirisë dhe të përgjegjësisë së shtypit.

- Të shpjegojnë ndërlidhjen ndërmjet të drejtave dhe përgjegjësive, si pjesë e fushës së praktikës së gazetarisë dhe të profesionistëve të informimit.
- Të përshkruajnë dhe të analizojnë raportimet e qytetarëve ose të zhvillimit të rolit të qytetarëve a të gazetarëve jo profesionistë, si pjesëmarrës aktivë në krijimin e përmbajtjen e medias dhe në proceset demokratike të debatit publik

## Qasje pedagogjike

*“Në fund të fundit, gazetaria është një akt karakteri*

*(Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel, Elementet e gazetarisë).*

Nëse shteti kërkon të rregullojë median, ai do të ndërhyjë në pavarësinë e gazetarëve dhe në aftësinë e tyre për të trajtuar ngjarjet në mënyrën më të mirë të mundshme. Mediat janë aktorë socialë që mund të ushtrojnë pushtet të madh në shoqëri, të cilat për të mbrojtur lirinë e tyre nga kufizimet dhe kontrolli, besohet se kanë nevojë të rregullojnë veten përmes kodeve etike ose hartimit të udhëzuesve profesionale për mënyrën e trajtimit të ngjarjeve që mbulojnë.

## Zbatimi - kodi i etikës së gazetarisë

- Shqyrtoni kodin e etikës së gazetarëve. Identifikoni dhe vlerësoni qëllimet e synuara të çdo elementi të kodit.
  - Diskutoni përse kodi i etikës duhet të zhvillohet dhe të pranohet nga vetë anëtarët e profesionit dhe jo të imponohet nga autoritete të jashtme.
  - Diskutoni për mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e kodit të etikës.

## Zbatimi – kodi i etikës profesionale për profesionistët e informimit

- Shqyrtoni kodin e etikës së profesionistëve të informimit si punonjësit e bibliotekave, arkivistët etj., duke përfshirë parimet dhe vlerat themelore (p.sh. kodi i etikës për arkivistët ose kodet profesionale të etikës).
  - Diskutoni për çështje të etikës së informimit në lidhje me pronësinë, garantimin e informimit, praktikën profesionale dhe politikën publike.
  - Diskutoni për mënyrën si ndikon etika e informimit në vendimet personale, në praktikën profesionale dhe në politikën publike.
  - Diskutoni si ndikojnë nevojat dhe zhvillimi i formateve të reja të informimit në parimet etike dhe si zbatohen këto kode (ruajtja digjitale, privatësia dhe garantimi i informimit publik).

### Veprimtari

- ❖ Mësuesit duhet të kërkojnë treguesit e lirisë së shtypit ([www.freedomhouse.org](http://www.freedomhouse.org)) ose e një matjeje rajonale për të vlerësuar renditjen e vendit në lidhje me këtë tregues.

Mësuesi:

- Të shpjegojë nëse është dakord apo jo me këtë renditje.
- Të identifikojë dhe të shpjegojë faktorët ose ndryshoret që kanë ndikuar këtë renditje të lirisë së shtypit në vendin e tyre. Kriteret për këtë qëllim përfshijnë:
  - Shkallën e lirisë së shtypit, të transmetimit dhe të medias online (p.sh. interneti)
  - Legjislacionin për median
  - Presionin politik që ndikon në raportim

- Faktorët ekonomik që ndikojnë në sigurimin e të drejtës së informimit
  - Përqendrimin e pushtetit të medias
  - Sulmet e drejtpërdrejta ndaj gazetarëve dhe medias
  - Praninë e monopolit shtetëror në media
  - Praninë e censurës dhe vet-censurës në media
  - Vështirësitë e gazetarëve të huaj.
- ❖ Në botë ekzistojnë shumë organizata që bëjnë fushata në mbrojtje të gazetarëve. Disa prej tyre janë ndërkombëtare si, për shembull, “Mbështetja Ndërkombëtare e Medias, në Danimarkë etj. Zbuloni nëse në vendin tuaj ka organizata të tilla dhe si kanë kontribuar ato në mbrojtjen e lirisë së shtypit dhe të lirisë së shprehjes.
  - ❖ Mësuesi do të tregojë shembull raportimesh që nxjerrin në pah paragjykimet, stereotipat, mitet, pamjet e hapura, vulgare etj. Mësuesi do të drejtojë grupin përmes një diskutimi për rëndësinë e standardeve dhe të udhëzimeve të përgjithshme për gazetarët dhe do të dorëzojë një raport për çështjet e paraqitura.
  - ❖ Mësuesi interviston një përfaqësues të organizatës rregullatore të medias (ose të ngjashme) për të kërkuar për kritikizim ose ankesat e zakonshme të të ashtuquajturave shkelje etike ose profesionale të gazetarëve ose të organizatave të reja. Mësuesi vlerëson nenet e kodeve të etikës dhe shqyrton nëse çështjet e ngritura mbulohen si duhet në kodet ekzistuese. Anëtarët e një klase kërkojnë nga kanalet e media vendore nëse kanë kode sjelljeje për gazetarët e tyre. Ata mund të kërkojnë më tej për mënyrën se si zbatohen këto kode.
  - ❖ Mësuesi shënon rastet e mbulimit duke u bazuar në raportimet e qytetarëve për një ngjarje ose çështje të trajtuar nga media kryesore. Ai kërkon për gabime ose për njëanshmëri.
  - ❖ Mësuesve u kërkohet të mbajnë një ditar ku shënohen vëzhgimet e tyre të përditshme ose bëhen përmbledhje

ose sinteza për çështje të ndryshme (shkelje të lirisë së shtypit/të shprehjes ose të informimit dhe shembuj të praktikës të gazetarisë jo etike).

## **Rekomandime për vlerësimin**

- ➔ Ditari i medias.
- ➔ Detyrë kërkimore, për shembull, renditje e lirisë së shtypit, kodet e sjelljes dhe raportimet e qytetarëve.
- ➔ Reflektime për intervistat, shikimi i një filmi.
- ➔ Pjesëmarrje në veprimtari grupi, diskutime në klasë.

## Tema 3:

# Cilat janë kriteret për eksplorimin e lajmeve



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Kriteret për vlerësimin e vlerës së lajmeve dhe dobisë së tyre
- Gjykimi i lajmeve ose i modelimit të tyre

### Objektivat e të mësuarit

Pas përfundimit të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë kriteret e përdorura për vlerësimin e vlerës së lajmeve ose të dobisë së ngjarjeve, personave ose ideve.
- Të diskutojnë në mënyrë kritike për parimet bazë të gjyqimit, të bërjes së lajmeve ose të modelimit të lajmeve.

### Qasjet pedagogjike

*“Teoria e gazetarisë që kemi trashëguar ... formon bazat e gazetarisë në shekullit të ri, një gazetari e arsyeshme, e bazuar në sintezën, verifikimin dhe pavarësinë e ashpër”.*

*(Bill Kovach dhe Tom Rosenstiel, Elementet e gazetarisë).*

Gazetaria duhet të jetë e vetëdijshme për sasinë e madhe të informacionit dhe duhet të mendojë për mënyrën e organizimit të tij, për të hedhur dritë mbi çështjet më të rëndësishme dhe për t'i bërë të kuptueshme për një audiencë të larmishme nga pikëpamja e nivelit të të kuptuarit të ngjarjeve në fjalë. Gjykimet do të përfshijnë përzgjedhjen e ngjarjeve që mendohen të rëndësishme (dobia) dhe vendimmarrjen për mënyrën e paraqitjes së informacionit. Forma e paraqitjes, në mënyrë të pashmangshme, do të pasqyrojë përvojën dhe qëndrimin e vetë gazetarëve. Për audiencën, është e rëndësishme të kuptojë këto forma dhe të mendojë në mënyrë kritike për to.

## Veprimtari

### Analiza e tekstit

❖ Mësuesi analizon dobinë e secilës prej ngjarjeve në faqen e parë të një gazete të madhe (ose të botimit të saj online), duke u bazuar në kriteret për vlerësimin e vlerës së një ngjarjeje. Zakonisht, këtu përfshihen:

- Aktualiteti
- Ndikimi
- Rëndësia
- Veçantësia
- Përshtatshmëria
- Konflikti
- Nevoja

Mësuesi do të analizojë ngjarjet duke u bazuar në faktorët që ndikojnë në gjykimin e lajmeve ose në modelimin e tyre të cilat janë:

- Vërtetësia: saktësia (marrja si duhet e fakteve) dhe koherenca (vlera e fakteve)
- Përkushtimi ndaj interesit të publikut
- Informimi dhe jo manipulimi i publikut
- Plotësia/gjithëpërfshirja

- Diversiteti (përfshirja e lajmeve nga të gjitha komunitetet, dhe jo vetëm e audiencave të synuara

Vëmendje i duhet kushtuar edhe vendosjes së artikujve, rubrikave, madhësisë së germave të përdorura, fotografive dhe titujve.

## **Analiza kontekstuale**

Mësuesit vlerësojnë mbulimin që dy agjenci të mëdha të medias u bëjnë temave ose ditëve të veçanta dhe krahasojnë këndvështrimet dhe trajtimet e dy mbulimeve (informacioni që përcjellin, burimet e njohura, intervistat dhe mbështetjet pamore të ngjarjeve)

## **Analiza e lajmeve dhe vetëvlerësimi**

Nxënësve u jepen dy artikuj të ndryshme që shkruajnë për të njëjtën temë dhe u kërkohet të shpjegojnë cili prej tyre është më i fortë ose më informues dhe si mund të përmirësohet artikulli tjetër



## Tema 4:

# Zhvillimi i procesit të lajmeve



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Identifikimi i lajmeve dhe njohja e ngjarjes (procesi i zhvillimit të lajmeve)
- Disiplina e verifikimit të thelbit të gazetarisë

### Objektivat e të mësuarit

Në përfundim të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë procesin e zhvillimit të ngjarjeve të lajmeve nga ideja fillestare deri në mbledhjen e të dhënave për shkrimin e lajmit.
- Të shpjegojnë parimet themelore të disiplinës së verifikimit, në dallim me gazetarinë e deklaratave dhe si ato zbatohen në procesin e zhvillimit të lajmit.
- Të analizojnë mënyrën se si gazetarët e lajmeve zbatojnë teknikën e verifikimit për të përmbushur standardet e të vërtetës dhe të saktësisë.
- Të përshkruajnë marrëdhëniet ndërmjet gazetarëve, burimeve të lajmit, botuesit dhe pronarët e medias.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

*Lajmet e ditës që mbërrijnë në redaksinë e gazetës janë një kombinim i jashtëzakonshëm faktesh, propagandash, thashethemesh, dyshimet, idesh, shpresash dhe frikërash dhe detyra e përzgjedhjes dhe e vendosjes së tyre në rendin e duhur të lajmeve është një ndër veprat më të shenjta në një demokraci*

*Walter Lippman, në "Raportimi dhe shkrimi i lajmit"*

### Vizitë në një organizatë të medias

Një vizitë në një redaksi të medias për të dialoguar me redaktorin përgjegjës dhe për të vëzhguar vetë procesin e zhvillimit të një lajmi është diçka që ia vlen ta bësh.

Pjesëmarrësit duhet të shkruajnë reflektimet e tyre për çfarë vëzhguan dhe mësuan gjatë vizitës.

## Veprimtari

### Procesi i kërkimit (një ditë në jetën e një gazetari lajmesh)

Një ndër të trajnuarit shoqëron një gazetar lajmesh gjatë kohës që përgatit lajmin dhe shtron pyetjet e mëposhtme:

- Cilat janë elementet e lajmit që janë identifikuar dhe janë shkruar, duke i krahasuar me ato që kanë ndodhur në realitet (ose procesi i shqyrtimit të të dhënave të mbledhura).
- Si dhe përse gazetari tregon ngjarjen ( u jep kuptim të dhënave) në një mënyrë të caktuar (mënyrën e tij)

## Analiza tekstuale

- Mësuesi analizon trajtimet që një gazetë e madhe i ka bërë një çështjeje ose ngjarje dhe shqyrton informacionin që ofrohet prej tyre. Ai shpjegon vlerësimin e tij, të bazuar në faktorët dhe procesin e identifikimit të lajmeve dhe në njohjen e ngjarjes:
  - Elementet e lajmeve (Kush? Çfarë? Kur? Përse? Si?) dhe i ripërcakton ata (*kush* është personazhi, *çfarë* është thelbi, *ku* është mjedisi, *pse* është motivimi ose shkaku dhe si është trajtimi?)
  - Gazetaria është tregimi për një qëllim të caktuar: gjetja e informacionit për të cilin kanë nevojë njerëzit për jetën e tyre dhe paraqitja e tij në mënyrë e përshtatshme, të kuptimtë dhe tërheqëse.

Mësuesi do të kontrollojë verifikueshmërinë, duke u bazuar në parimet themelore të verifikimit: Mos shto! Mos mashtro audiencën! Ji sa më transparent të mundësh për metodat dhe motivet! Mbështetu në raportimin fillestar! Përdor modestinë!

Mësuesi do të përdorë, të paktën një teknikë verifikimi: redaktimin dyshues, listën e saktësisë, metodën e verifikimit, faktet e hamendësuar, rregullat e burimit anonim etj.

## Prodhimi

Trajneri ose mësuesi bashkëveprojnë me këshilltarin e një gazete shkolle (ose të një program shkollor) për të ndihmuar pjesëmarrësit në trajnim të vijtë me një plan trajtimi të një çështjeje për botimin e ardhshëm. Plani përfshin përgatitjen ose shkrimin e artikujve ose të ngjarjeve dhe bazat për përfshirjen e tyre, fushën në të cilën bën pjesë secila prej ngjarjeve dhe këndvështrimin e mundshëm të trajtimit të tyre.

## Ditari mediatik

Mësuesit duhet të mbajnë një ditar ose një libër ku të regjistrojnë përmbledhjet e vëzhgimeve të tyre të përditshme për temën (p.sh. vlerat e lajmeve, gjykimet e lajmeve, kriteret e verifikimit, raportimet e qytetarëve).

## Vlerësimi

- ➔ Ditari mediatik
- ➔ Prodhimi
- ➔ Raportimi për vizitën studimore, përfshirjen, analizën tekstuale
- ➔ Pjesëmarrja në veprimtaritë e të mësuarit në grup



# MODULI 3

## Paraqitja në media dhe informacion

‘Si na shohin të tjerët përcakton pjesërisht edhe mënyrën si na trajtojnë: mënyra si trajtojmë të tjerët bazohet në mënyrën si ne i shohim ata. Këto pamje varen nga paraqitja’

Richard Dyer, *Çështje imazhi*

## Hyrje

Paraqitja në media bëhet në forma të ndryshme. Ne jetojmë në një kulturë imazhi dhe përditë rrethohemi nga paraqitjet e medias në faqe internet, në TV, në filma, në lajme dhe në libra.

Gazetarët, autorët, grafistët, botuesit dhe prodhuesit e filmave përdorin imazhet, fjalët e shkruara dhe me zë për të përçuar informacion për një ngjarje, veprimtari ose çështje. Për të përgatitur dhe për të paraqitur ngjarjet e tyre në publik, ata, zakonisht përballen me kufizime kohore, hapësinore dhe burimore, si dhe me kufizime të tjera redaktoriale. Për këtë arsye, në varësi të ngjarjes së treguar ose të mesazhit të përçuar, shpesh herë është e nevojshme të riparaqitet ngjarja ose çështja duke pasur si pikë referimi karakteristika të tilla si: raca, gjinia, orientimi seksual, moshë ose klasa. Në mënyrë të pashmangshme, ata që punojnë në media, duhet të përzgjedhin përmbajtjen që duhet t'i paraqitet publikut. Kjo përzgjedhje nuk e shmang subjektivizmin dhe ndonjëherë çon në paraqitje të thjeshtëzuara ose stereotipa, të cilat mund të përdoren për të etiketuar individët dhe për të justifikuar besimet ose qëndrimet e ngushta. Ndoshta, kjo paraqitje mund të ketë qenë ose jo synimi i autorit ose gazetarit. Ndonjëherë kjo është rrjedhojë e interpretimit të marrësit të informacionit (vëzhguesit, lexuesit ose dëgjuesit). Kur media dhe ofruesit e tjerë të informacionit bëhen instrumente të njëanshmërisë së qëllimshme, të konfliktit ose të diskriminimit, atëherë media duhet të japë llogari për veprimet e kryera në këtë cilësi, sikurse çdo aktor tjetër social. Megjithatë, si një platformë për debatin publik, është e rëndësishme që media të lejohet të paraqesë diskutime dhe informacion pa u kontrolluar nga asnjë parti ose qeveri.

Po kështu, duhet të kuptojmë që media dhe ofruesit e tjerë të informacionit punojnë në një kontekst social, duke qenë edhe vetë aktorë socialë, brenda një konteksti social. Media ndikohet nga shoqëria, sikurse ajo e ndikon shoqërinë. Për këtë arsye, është e nevojshme të eksplorojmë në thellësi kontekstin e veçantë kombëtar në të cilin vepron media e veçantë.

Në përpjekjen tonë për t'u arsimuar në fushën e medias dhe të informimit, ne duhet të shqyrtojmë pamjet ose paraqitjet e medias dhe të analizojmë jo vetëm imazhet ose vetë tekstet e medias, por edhe kontekstin që e rrethon këtë imazh, të cilin ndonjëherë nuk arrijmë ta shohim. Është e rëndësishme të pranojmë që ndërsa media ka shumë pushtet për të drejtuar dhe sfiduar shoqërinë, ajo është edhe pasqyrë e saj, pasi ofron ato lloj ngjarjesh dhe paraqitjesh që ne kërkojmë dhe pranojmë. Shumë industri të medias kanë zhvilluar kode vullnetare diversiteti, për të siguruar që industrinë e medias të demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj përmbajtjeve dhe nismave që janë të ndryshme dhe gjithëpërfshirëse. Shumë industri të medias ndjekin edhe kode etike që ndalojnë përdorimin e materialeve abuzive dhe diskriminuese mbi bazën e racës, të përkatësisë etnike, të moshës, gjinisë, aftësisë fizike dhe statusit martesor.

Çështje kryesore të këtij moduli janë:

- ➔ Kush përfiton nga pranimi i paraqitjeve të papërshtashme të medias dhe kur humbet?
- ➔ Si ndikojnë këto imazhe në mënyrën si ne shohim veten dhe të tjerët?
- ➔ Si ndikojnë ato në njohuritë dhe mënyrën e të kuptuarit të botës, përtej përvojës sonë të drejtpërdrejtë?



# Tema 1:

## Raportimi i lajmeve dhe pushteti i imazhit



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështet kryesore

- Studimi i rastit: raportimi i lajmeve
- Pushteti i pamjeve
- Paraqitja e katastrofave
- Paraqitja e gjinisë

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit do të jenë të aftë:

- Të analizojnë paraqitjet në trajtimin mediatik të një ngjarjeje të veçantë.
- Të shqyrtojnë raportimin e lajmeve që ofrojnë paraqitje të ndryshme nga ato të mediave sunduese.
- Të vlerësojnë ndikimin e paraqitjeve në një audiencë të caktuar dhe për personin e portretizuar.
- Të analizojnë paraqitjet e gjinisë në media dhe në sistemet e informimit.

## Qasjet pedagogjike dhe veprimtaritë

Duke pasur parasysh varësinë tonë nga media pamore, shumë kritikë të medias kanë shprehur shqetësimin e tyre për mënyrën si paraqiten në media disa ngjarje, në mënyrë të veçantë, katastrofat.

- ◆ Shqyrtoni disa nga trajtimet që media u bën disa ngjarjeve dhe çështjeve të sotme dhe vlerësoni në çfarë shkalle i gjykoni ato të vleshme. Diskutoni për disa nga kundërpërgjigjet e disa njerëzve të prekur nga tragjeditë ose katastrofat. Kërkoni dhe reflektoni për strategjitë e përdorura nga gazetarët që punojnë në mediat sunduese dhe ato alternative për të identifikuar ndikimin emocional të ngjarjeve, krahas ruajtjes së privatësisë dhe të dinjitetit të njerëzve.
- ◆ Kërkoni dhe analizoni trajtimin që media i bën një ngjarjeje të madhe si për shembull, një tërmeti në vende të ndryshme të botës. Ky studim rasti duhet të përqendrohet në pamjet nga gazetatat dhe paraqitjet e njerëzve dhe të çështjeve që lidhen me to. Mësuesit mund të kërkojnë burimin e pamjeve që shfaqen në trajtimin e këtyre ngjarjeve në mediat sunduese. Për të analizuar, më në hollësi, trajtimin dhe pamjet e përdorura mund të përdoren pyetjet e mëposhtme:
- ◆ Përshkruani çfarë është paraqitur në TV dhe në trajtimet e gazetave. Identifikoni pamjet më të përdorura. Shqyrtoni si janë ndërtuar këto paraqitje, duke marrë parasysh edhe këndet e kamerave, kompozimin e fotografive, llojet e fotografimit, kush ose çfarë është tregohet në pamje ose në videoklipe dhe kush ose çfarë mendoni se është lënë jashtë ose është përjashtuar.
  - o Cili është mesazhi që përçohet përmes këtyre pamjeve? Cila është ngjarja që tregojnë pamjet? Vlerësoni mundësinë që këto pamje të bëhen simbolike. Cili është ndikimi që këto pamje kanë tek audiencat? Shqyrtoni ndikimin e pamjeve në mënyrën si shikuesi kupton ngjarjen në marrëdhëniet e tij me të.

- o Diskutoni nëse mund të mbahet mend ose jo informacioni për një ngjarje që nuk shoqërohet edhe me pamje. Eksploroni pushtetin e pamjeve për të “fshirë” informacionet e tjera që nuk përmbahen në format pamore. Cili është ndikimi i kësaj “fshirjeje” për qytetarinë e informuar?

## Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave

- Çështjet gjinore po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për zhvillimin e programeve të agjencive të zhvillimit ndërkombëtar (p.sh. Kombet e Bashkura), sistemet kombëtare dhe rajonale të qeverisjes si dhe organizatat e shoqërisë civile. Të gjithë sot po bashkojnë forcat për të luftuar stereotipat ndaj grave dhe pabarazinë që ato përjetojnë në fushën e të drejtës për të përdorur dhe për të marrë pjesë në të gjitha sistemet e komunikimit dhe të medias në mënyrë të veçantë.
- Sot është e qartë nevoja për të theksuar rolin e medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit për të arritur objektivat në këtë drejtim. Në diskutimet në klasë, mësuesi mund të bëjë pyetje të tilla si:
  - o Si mund të vlerësojnë media dhe ofruesit e tjerë të informacionit ndjeshmërinë e tyre ndaj gjinisë dhe si mundet shoqëria civile të vlerësojë këtë ndjeshmëri?
  - o A shërben media vetëm si transmetues i thjeshtë i informacionit në lidhje me barazinë gjinore apo ajo është partnere në zbatimin e politikave të KB, në mënyrë që të bëhet i mundur krijimi i njohurive dhe shumëfishimi i arritjeve të tyre?
  - o Nëse media është një partnere në këtë proces, si mund të jetë ajo më e efektshme në të?
- Për shumë vjet, të interesuarit në fushën globale janë përqendruar në zhvillimin e medias për të trajtuar çështjet që lidhen me barazinë gjinore dhe fuqizimin e

grave. EMI është i nevojshëm për përdoruesit e medias dhe të sistemeve të informimit dhe mund të nxisë tek media ndjeshmërinë ndaj çështjeve gjinore. Përmes EMI, audiencat pajisen me kompetencat e nevojshme (njohuri, aftësi dhe qëndrime) për vlerësimin e ndjeshmërinë gjinore të medias dhe të sistemeve të informimit dhe të marrin pjesë në to.

- Kërkojuni mësuesve të kryejnë një anketim të vogël për t'u përgjigjur disa prej pyetjeve të mëposhme:
  - A po e mbështesin EMI organizatat e mediave në vendin tuaj?
  - Si po e bëjnë një gjë të tillë?
  - Cilat janë faktet që e dëshmojnë këtë?

Nëse është e mundur, identifikoni disa shembuj të veçantë:

- Në ç'mënyrë mund të ndihmojë EMI në trajtimin e çështjeve të barazisë gjinore?
- Cilat janë disa nga programet e zhvillimit në lidhje me çështjet gjinore që ekzistojnë në vendin tuaj dhe në bashkësitë?
- Cilat janë disa nga sfidat që ndeshen në zbatimin e këtyre programeve?
- Në çfarë shkalle janë të përfshirë media dhe ofruesit e tjerë të informacionit në këto projekte?
- Cilat mund të jenë disa nga mënyrat krijuese në të cilat mund të përdoret EMI për t'i bërë çështjet gjinore si çështje aktuale në media dhe informim dhe për të rritur përfaqësimin e grave në to?

Përmes këtyre dhe pyetjeve të tjera, kërkonit përvoja dhe praktika të mira dhe bëni rekomandime në fushën e barazisë gjinore dhe të EMI.

- Cilat janë disa prej pikëpamjeve tuaja personale për barazinë gjinore?

- Si mund të ndikojnë pikëpamjet dhe përvojat tuaja në interpretimin e paraqitjes gjinore në media dhe në burime e tjera të informacionit?
- Në lidhje me gratë, median dhe ofruesit e tjerë të informacionit ekzistojnë dy këndvështrime. Njëri lidhet me statusin e grave që punojnë në media dhe në ofruesit e tjerë të informacionit, ndërsa tjetri ka të bëjë me trajtimin e imazhit të grave në media dhe në ofruesit e tjerë të informacionit.
  - o Studjoni disa prej gjetjeve të projekteve të monitorimit të medias globale në lidhje me statusin e grave ose nga kërkime të tjera në lidhje me gratë, median dhe ofruesit e tjerë të informacionit.
  - o Diskutoni në lidhje me pyetjet e mëposhtme:
    - Cilat janë disa nga ndikimet individuale dhe kolektive të këtyre gjetjeve?
    - Cilat prej pamjeve për gratë sundojnë në median e sotme?
    - Cilët janë faktorët social, ekonomik, kulturor dhe politik që mund të motivojnë këto pamje?
    - A duhet të përbëjnë ato një shkak për t'u shqetësuar?
    - A duhet që qeveria të ndër marrë veprime për të trajtuar pamjet negative? Nëse po, përshkruani disa prej tyre.
    - Cilat janë veprimet që duhet të ndërmerren nga shoqëria civile për të trajtuar këto çështje?
    - A mendoni që për median do të ishte më mirë të ndërmerrete veprime përmes vet-rregullimit sesa përmes imponimit nga qeveria ose organizmave të tjerë jashtë saj? Shpjegoni!
    - A do të ishte ndryshe për median që financohet në mënyrë publike nga ajo private?

- A mendoni që media që vepron me financa publike do të kishte detyrimin të siguronte barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave?
  - A ju ka fuqizuar ju EMI për të ndërmarrë veprime? Si?
  - Cilat janë pikëpamjet tuaja personale për barazinë gjinore?
  - Si mund të ndikojnë pikëpamjet dhe përvojat tuaja personale në interpretimin që ju i bëni paraqitjes gjinore në media dhe në ofruesit e tjerë të informacionit?
  - A mendoni që pamjet e grave në media e, për rrjedhojë edhe ato të burrave, do të ndryshonin nëse numri i grave që do të punonin në media dhe në ofruesit e tjerë të informacionit do të ishte më i madh? Përse mendoni kështu? Çfarë thonë kërkimet për këtë?
- Trajneri duhet të zhvillojë veprimtari të ngjashme, që lidhen me gjininë edhe për grupet e pafavorizuara si personat me aftësi fizike të kufizuara , pakicat etnike, të varfërit në komunitete e periferi etj. Këto veprimtari duhet të synojnë eksplorimin e paraqitjes së këtyre grupe në media për të kuptuar si krijohen dhe për kë krijohen këto paraqitje dhe të përgjigjes së pyetjes se kush përfiton në rastet kur pranohen këto paraqitje dhe kush humbet prej tyre.

## Vlerësimi

- ➔ Analiza dhe vlerësimi i pamjeve në gazeta, duke përfshirë edhe përbërësit e tyre teknikë.
- ➔ Identifikimi dhe vlerësimi i procedurave të raportimit që ndihmojnë më mirë në zhvillimin e qytetarëve të informuar.
- ➔ Vlerësimi i ndikimit të pamjeve tek audienca.

## Tema 2:

# Kodet e industrisë për diversitetin dhe paraqitjen



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Kodet dhe etika e medias
- Zbatimi i kodeve ndaj mediave të ndryshme

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit do të jenë të aftë:

- Të shqyrtojnë diversitetin dhe kodet e etikës në industritë e mediave të ndryshme.
- Të zbatojnë kodet dhe etikën e medias ndaj larmisë së pamjeve dhe teksteve të medias.
- Të vlerësojnë tekstet e medias të bazuar tek kodet dhe etikën e medias.
- Të vlerësojnë qëllimin dhe efektivitetin e kodeve të tilla.
- Të rekomandojnë sugjerime/ndryshime për kodet dhe etikën e medias.

### Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Nevoja për të shmangur rregullimet shtetërore të medias ka bërë që industritë e medias në rajone të ndryshme të zhvillojnë kode vullnetare diversiteti, për të sigurur që këto industri të

demonstrojnë përkushtimin e tyre ndaj përmbajtjes dhe nismave që janë gjithëpërfshirëse dhe të larmishme. Shumë industri ndjekin një kod etike që i ndalon të përdorin materiale abuzive dhe diskriminuese mbi bazën e racës, përkatësisë etnike, gjinisë, aftësisë fizike ose statusit martesor.

- ◆ Studioni kodet e udhëzimeve praktike/etike që ekzistojnë në rajonin tuaj. Identifikoni kush është përgjegjës për krijimin e këtyre kodeve të praktikës. Bëni një përmbledhje të fushave kryesore që përfshihen dhe shpjegoni qëllimin e tyre. Si e mbështetnin ato interesat e qytetarëve dhe konsumatorëve? Cili është ndikimi i këtyre rregullave në industri?
- ◆ Zbatoni kodin e praktikës së paraqitjes në lajme nga përvojat e mëparshme. Vlerësoni në çfarë shkalle ndiqen rregullat. Sigurohuni që gjatë vlerësimit tuaj merrni parasysh tekstet dhe kontekstin. Jepni shembuj nga lajmet për të mbështetur përgjigjen tuaj. Cilat janë mjetet në shërbim të individëve, në rastet kur raportohen shkelje të rregullave?
- ◆ Shqyrtoni fushat e tjera të medias që mbulohen nga këto kode (p.sh. portretizimi i gjinisë në reklama). Vlerësoni shkallën e zbatimit të këtyre rregullave. Skiconi vlerësimin që do të jepni për organizmat rregullatorë dhe prodhuesit e teksteve të medias.

## Rekomandime për vlerësime

- ➔ Përmbliidhni fushat kryesore të kodeve/etikës së diversitetit
- ➔ Zbatimi i këtyre kodeve në tekste të ndryshme të medias
- ➔ Rekomanime për ndryshime/shtesave të kodeve/etikës



## Tema 3:

# TV, filmat, botimi i librave



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Filmat për sukses
- Paraqitja në film
- Paraqitja në libra
- Hollivud, histori komuniteti dhe filmash

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit do të jenë të aftë:

- Të shqyrtojnë suksesin e programeve aktuale të TV dhe të filmave.
- Të vlerësojnë paraqitjen në film, TV dhe median e shkruar (duke përfshirë librat).
- Të trajtojnë një film.
- Të shqyrtojnë vendosjen e programeve teevizive në një planifikim rrjeti.
- Të analizojnë paraqitjen e gjinisë në një reklamë.
- Të analizojnë strategjitë teknike në paraqitjet.
- Të shqyrtojnë alternativat, ngjarjet në television dhe film.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Filmi është një ndër format më të fuqishme të medias në njëqind vjetët e fundit, me audienca masive në të gjithë botën. Në vitet e fundit, TV dhe interneti kanë mbërritur në një publik shumë të gjerë në shumë pjesë të botës. Në të njëjtën kohë, librat ende vazhdojnë të mbeten një burim i rëndësishëm idesh dhe informacioni. Të katër format e medias dhe ofruesit e informacionit mund të luajnë rol të madh në modelimin e mënyrës si shoqëria e kupton veten, përmes trajtimit të ngjarjeve kombëtare dhe nxitjes së versioneve të veçanta të historive kombëtare. Pjesë e rëndësishme e EMI është të kuptuarit e mënyrës se si këto media modelojnë kuptimin tonë për botën në të cilën jetojmë

- ◆ Përdorni internetin për të kërkuar suksesin e filmave të fundit. Bëni një listë me pesë filma të sukseshëm në plan ndërkombëtar. Mundësisht, shikoni reklamën e tyre online ose përzgjidhni një film për ta parë të plotë. Tregoni përse kjo paraqitje është tërheqëse për njerëzit.
- ◆ Kërkoni nga mësuesit të identifikojnë versione të ndryshme të paraqitjes së ngjarjeve historike. Gjeni disa nga botimet e periudhës kur ka ndodhur ngjarja, filma të gjinive të ndryshme, vepra arti, piktura, foto ose video muzikore. Përgatitni një ese, duke u bazuar në informacionin që përmbajnë materialet e grumbulluara.
- ◆ Përzgjidhni një libër ose artikull të shkruar për vendin tuaj, që mund të jetë për kulturën e bashkësisë ose për një ngjarje të veçantë. Identifikoni si paraqiten aspektet e ndryshme të çështjes në fjalë. A jeni dakord me këto paraqitje. Përse po apo përse jo? Diskutoni.
- ◆ Grumbulloni disa reklama nga interneti, TV në vendin tuaj ose nga gazetatat vendore. Sigurohuni që në këto reklama të paraqiten burrat dhe gratë. Në grupe të vogla diskutoni si paraqiten gratë në krahasim me burrat në reklamat e përzgjedhura. Shkruani rezultatet e vëzhgimeve tuaja dhe diskutoni për ndikimet e mundshme të disa prej këtyre paraqitjeve. A ka paraqitje që shihen ndryshe nga anëtarët

e grupit? Cila është arsyeja e këtij ndryshimi sipas mendimit tuaj?

- ◆ Skenari i një filmi ka në qendër një mit tipik të një “udhëtimit heroik”. Mitet përfaqësojnë sisteme besimi të nënkuptuar që shprehin frikën, dëshirat dhe pritshmëritë e një kulture. Në këto histori, heroi, i pavetëdijshëm për fatin e tij, thirret për të ndërmarrë një mision të rëndësishëm. Zakonisht, heroi kalon nëpër disa faza, si pjesë të një misioni, në të cilat përfshihen: lindja ose fillimi i tij, bërja i vetëdijshëm për misionin ose fatin e tij, përjetimi i romancës, ndeshja me armikun, marrja e këshillave nga një i moshuar i ditur dhe, në fund, kthimi në shtëpi.
  - Bëni një listë me filma që trajtojnë këtë temë. Shpjegoni përse janë tërheqës. Përshkruani heroin, shpjegoni në çfarë shkalle heroi përfaqëson dëshirat dhe vlerat e individit në shoqëri.
  - Përshkruani punën e kamerës si dhe të përdorimit të tingullit dhe të muzikës. Vlerësoni si këto elemente teknike përforcojnë paraqitjen themelore të ngjarjes (p.sh. përshtypjen e krijuar nga personazhi negativ ose heroi romantik). Shpjegoni mënyrën se si kuptimi i një skene të veçantë në film do të ndryshonte nëse do të ndryshonte muzika e tij.
- ◆ Qëllimi është të dallojmë larminë e këndvështrimeve që paraqiten në film dhe TV. Rritja e numrit të shikuesve nuk merr asgjë prej askujt. Në fakt, kjo të çon në programim dhe vizion më të mirë.
  - Vizitoni faqen e medias sunduese ose median e komunitetit që përfaqëson alternativat ndaj arritjeve të Hollivudit. Eksploroni përzgjedhjen e historive të treguara përmes këtyre organizatave ose kompanive. Krahasoni këto histori. Vlerësoni vlerën e organizatave të pavarura të cilat u japin zë këndvështrimeve alternative.

- Diskutoni përgjegjësinë e industrive të filmit dhe të televizionit ndaj shikuesve. Përse duhet që të gjithë shikuesit të jenë të aftë të shohin veten dhe historitë e tyre në ekran? Diskutoni ndikimin që kanë këndvështrimet sunduese për audiencat e ndryshme. Ekploroni se si kanalet e veçantë dhe teknologjitë e reja ndikojnë në artin e të treguarit dhe ofrojnë paraqitjet alternative tek audiencat.

## Rekomandime për vlerësimin

- ➔ Analizë e shembujve aktualë të programeve të televizionit dhe filmave.
- ➔ Vlerësim i ndikimit të strategjive teknike dhe i formave në përmbajtjen dhe paraqitjen.
- ➔ Shqyrtim dhe vlerësim i organizatave kombëtare të filmit dhe kompanive të pavarura të prodhimit për sigurimin e historive alternative.

## Tema 4:

# Paraqitja dhe videot muzikore



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Analiza e videove muzikore
- Paraqitja
- Ndryshimi social dhe i muzikës
- Përdorimi i skicave

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie, mësuesit do të jenë të aftë:

- Të zhvillojnë një histori të paraqitur me skica të njëpasnjëshme
- Të analizojnë një video muzikore që e vë theksin në paraqitjen e gjinisë, të racës dhe të orientimit seksual.
- Të shqyrtojnë paraqitjen e muzikës alternative.
- Të krahasojnë paraqitjen në median alternative me ato në median sunduese.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Muzika luan rol jetësor në të gjithë shoqërinë njerëzore. Në përgjithësi, ajo shihet si zbavitje, por edhe si faktor i rëndësishëm në shumë praktika fetare e kulturore dhe që përdoret shpesh edhe në luftrat politike. Të kuptuarit e mënyrës se si muzika ndikon në audienca është pjesë e EMI.

- ◆ Duke përdorur internetin, shqyrtoni video të artistëve më në zë të kohës së sotme. Analizoni mesazhet dhe vlerat e një video muzikore (duke u bazuar edhe në tekstin e këngës). Analiza duhe të përfshijë:
  - Shqyrtimin e përmbajtjes së tekstit, si dhe përshkrimin e mënyrës në të cilën pamjet vizive lidhen me tekstin, me melodinë e këngës dhe me interpretimin që mësuesi i bën tekstit.
  - Shqyrtimin e elementeve teknikë të videos, duke marrë parasysh përdorimin e ngjyrave, të dritës, të ritmit etj., efektet speciale dhe lidhjen ndërmjet audios dhe elementeve të videos.
  - Shqyrtimin e çështjeve sociale që trajtohen në video, të mënyrës se si këto mesazhe mund të ndryshojnë nëse njerëzit i përkasin klasave të ndryshme sociale ose racave të ndryshme ose nëse personazhet mashkullore dhe femërore ndryshojnë rolet e tyre.
- ◆ Interpretoni mesazhet dhe vlerat ideologjike që prezantohen në një video, duke u bazuar në pyetjet e mëposhtme:
  - A paraqet video besimet e ndonjë grupi të veçantë?
  - Përshkruani paraqitjen e burrave dhe të grave në video. A janë përdorur stereotipa? Nëse po, cili është ndikimi?
  - Kush është në pozitën e pushtetit? Kush nuk është? Kur përfiton nga kjo situatë?

- A përjashton video ndonjë grup njerëzish ose besimet e tyre?
- Cili është përkufizimi i lumturisë, i suksesit ose i moralit të nënkuptuar?
- ◆ Përcaktoni audiencën e synuar. Vlerësoni në çfarë shkalle kjo video do të ishte tërheqëse përtej audiencës së synuar.
- ◆ Vlerësoni pushtetin e kulturës dhe të muzikës popullore si mjet për ndryshime transformuese. Deri në çfarë shkalle mund të luajnë rol muzikantët dhe muzika për të ofruar komente politike dhe sociale dhe për të nxitur drejtësinë sociale? Shikoni punën e organizatës Freemuse, me qendër në Danimarkë, e cila mbështet muzikantët që janë të përfshirë në kauzat sociale dhe politike.
  - Cilat janë çështjet dhe ngjarjet që paraqiten në muzikën e tyre?
  - Cili është ndikimi i saj?
- ◆ Përzgjidhni tekste këngësh dhe përgatisni një varg skenash për një video muzikore që do të përçojë mesazhin e vargjeve të këngës. Shqyrtoni me kujdes pamjet që do të paraqesin vargjet. Identifikoni dhe përzgjidhni elementet teknike që do të pasurojnë këtë paraqitje.
  - Nëse ekziston një video për këtë këngë, krahasoni skenat me videon e prodhuar, duke vënë në dukje ndryshimet dhe ngjashmëritë në pamje dhe teknika
- ◆ Vizitoni faqet e internetit të një organizate të tillë si MediaWatch ([www.mediawatch.org](http://www.mediawatch.org)), që është e përfshirë në sfidën kundër racizmit, seksizmit dhe dhunës në media përmes edukimit dhe veprimit. Identifikoni qëllimet dhe fushatat e kësaj organizate dhe e organizatave që kanë qëllime të ngjashme me të.

## Rekomandime për vlerësimin

- ➔ Analizë dhe vlerësim i shembujve aktualë të videove muzikore që bazohen në paraqitjen, elementet teknikë, mesazhet dhe vlerat ideologjike.
- ➔ Zhvillimi i skenarit me anë të skicave për tekstet e këngëve të zgjedhura nga ju.





# MODULI 4

## Gjuha në media dhe informim

'Gjuha është burim i keqkuptimeve.'

*Antoine de Saint-Exupéry (1900 – 44)*

## Hyrje

**‘Mjeti është mesazhi’.** Kjo shprehje është shkruar nga Marshall McLuhan në vitin 1964. Mjeti mund të ndikojë në mënyrën si merret mesazhi, ndërsa prejardhja dhe përvoja e vetë përdoruesit/audiencës mund të ndikojë në interpretimin e tij. Arritja e parë e të genit i arsimuar në fushën e edukimit për median dhe informimit është aftësia për të kuptuar si komunikohet informacioni, idetë dhe kuptimi përmes mediave të ndryshme dhe nga ofruesit e tjerë të informacionit. Çdo mjet ka gjuhën ose gramatikën e tij e cila shërben për të përçuar kuptimin në mënyrën e tij të veçantë. Në këtë kuptim, gjuha nënkupton përbërësit simbolikë ose kodet dhe rregullat që media dhe profesionistët e informimit mund të përzgjedhin për të përdorur në përpjekjet e tyre për të komunikuar idetë, informacionet dhe njohuritë.

Kodet teknike përfshijnë tingujt, këndet e kamerës, llojet e fotografimit dhe ndriçimin. Ato mund të përfshijnë për shembull, muzikën paralajmëruese në një film për të komunikuar një rrezik ose një kënd fotografimi për të krijuar ndjenjën e pushtetit në një fotografi. Kodet simbolike përfshijnë gjuhën, veshjet, veprimet e personazheve ose simbolet kryesore që janë lehtësisht të kuptueshme. Për shembull, një trëndafil rozë mund të përdoret në mënyrë simbolike për të përcjellë një romancë, sikurse një grusht i mbledhur mund të komunikojë zemërim. Gjuhët e medias mund të përfshijnë edhe përdorimin e përsëritur të fjalëve, të frazave dhe pamjeve, që njihen ndryshe edhe si gjuha verbale ose pamore. Kur studiojmë gjuhët e medias përpiqemi t’u përgjigjemi tre pyetje kryesore:

- Si kuptohen gjuhët e medias nga audienat?
- Cilat janë disa prej kodeve dhe rregullave kryesore që përdorin njerëzit që punojnë në fushën e medias dhe të informimit?

- A mundet që persona të ndryshëm të nxjerrin kuptime të ndryshme nga i njëjti tekst ose pjesë informacioni?

Ky modul synon që mësuesit të fitojnë njohuri për gjuhët e ndryshme të mediave, për t'i aftësuar ata të kuptojnë rrugët e përçimit të mesazheve dhe të informacioneve dhe mundësinë e lidhjes së interpretimit që ata i bëjnë informacionit ose ideve të medias me llojin e gjuhës së përdorur për këtë qëllim.

# Tema 1:

## Leximi i teksteve të medias dhe informacioneve



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Shqyrtimi i kodeve dhe i rregullatorëve në tekstet e informacionit
- Analiza e kuptimit – gjuha e simboleve dhe ajo pamore
- Eksplorimi i gjuhëve të medias – kolazhe fotosh dhe videosh

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore mësuesit do të jenë të aftë:

- Të identifikojnë kodet dhe praktikën e rregullimit të tyre, të cilat përdoren për të përçuar kuptimin në mediat e larmishme dhe tekstet informative
- Të identifikojnë shenjat dhe simbolet e përdorura për qëllime të ndryshme në komunitetet vendore dhe globale

### Qasje pedagogjike dhe veprimtari

- ◆ Rendisni disa kode teknike dhe simbolike si dhe rregullimet e tyre që përdoren në mediat dhe tekstet e mëposhtme informative: serialet, broshurat turistike, filmat dokumentarë, komeditë familjare dhe reklamat politike.
- ◆ Identifikoni shenjat dhe simbolet që përdoren për qëllime të larmishme të përçimit të informacionit në komunitetin tuaj (për drejtime lëvizjeje, vendndodhje të vendeve

tërheqëse etj.). Përshkruani gjuhën verbale dhe pamore të përdorura në këto shenja dhe simbole që të mund të kuptohen lehtësisht nga njerëzit në komunitetin tuaj Merrni parasysh përdorimin e madhësisë së shkronjës, të pamjeve, të dizajnit etj.

- ◆ Shqyrtoni larminë e kartolinave nga vendi ose bashkësia juaj. Identifikoni simbolet dhe kodet teknike kryesore që përdoren në secilën prej tyre.
  - o Cili është informacioni për vendin tuaj që komunikohet përmes këtyre kodeve.
  - o Cili është informacioni që mendoni se fshihet në to?
- ◆ Krijoni një kartolinë për një vend ose për një organizatë.
  - o Cilat janë kodet kryesore teknike dhe simbolike që do të përdorni për të përçuar informacion të rëndësishëm dhe për të krijuar përshtypjen e dëshiruar.
- ◆ Përmes pamjeve të videove të lëvizshme ose të palëvizshme, krijoni një kolazh për të përçuar rëndësinë e shkollës suaj tek një audiencë e veçantë. Merrni parasysh përdorimin e duhur të shenjave, simboleve, gjuhës verbale dhe pamore, muzikën, ngjyrat, pamjet dhe këndet e fotografive etj., për t'iu drejtuar kësaj audience. Audiencat për këtë kolazh mund të jenë një mundësi për nxënësit, të cilët mund të regjistrohet në shkollë, për prindërit e tyre, bordet e shkollave, për një politikan etj.

## Rekomandime për vlerësimin

- ➔ Analiza e kodeve dhe e modelit të përdorimit të tyre në tekste të ndryshëm.
- ➔ Analiza e shenjave dhe e simboleve në një komunitet.
- ➔ Analiza dhe vlerësimi i kodeve të përdorura në kartolinat vendore ose kombëtare.
- ➔ Krijimi i kolazheve.

## Tema 2:

# Mjeti dhe mesazhi: lajmet e transmetuara përmes radios dhe TV dhe ato përmes materialeve të shtypura



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Analiza e kodeve dhe e rregullatorëve të përdorimit të tyre.
- Zbatimi i kodeve dhe i rregullatorëve të përdorimit të tyre.
- Gjuhët e medias dhe të kuptuarit: vlerësimi dhe analiza e lajmeve dhe informacionit.

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të analizojnë kodet dhe rregullatorët e përdorimit të tyre të përdorura në TV, radio dhe në gazeta për trajtimin e një ngjarjeje.
- Të zbatojnë këto kode dhe rregullatorë në trajtimin e një ngjarjeje
- Të vlerësojnë rrugët në të cilat një media dhe kode dhe modelet e saj të veçanta mund të modelojnë mesazhet që përcjellin.
- Të vlerësojnë informacionin që mund të përçohet përmes përdorimit të një mjeti të caktuar mediatic.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

- ◆ Një qeveri po planifikon të ndryshojë legjislacionin që do të ndikojë në mbrojtjen e mjedisit. Në zyrat e shtetit ka bërë një deklaratë për të mbështetur qëndrimin e qeverisë. Një grup i gjerë të rinjsh janë të pranishëm në një protestë dhe, si rrjedhojë, nis një përlëshje ndërmjet protestuesve dhe policisë.
  - o Parashikoni si do të trajtohet kjo ngjarje nga një gazetë, një radio dhe një stacion televiziv.
    - Cili do të jetë, sipas mendimit tuaj, ndryshimi në mënyrën e trajtimit të ngjarjes?
    - Sa do të varet ky ndryshim nga karakteristikat e veçanta të çdo lloji medie/mjeti.
- ◆ Përzgjidhni një ngjarje ose çështje nga aktualiteti, si për shembull, politika shkollore, një ngjarje politike, kulturore ose shëndetësore. Duke punuar në grupe, shkruani një lajm për këtë ngjarje që do të bëhet publike në radio, në gazetë, në një program televiziv lajmesh. Në radio, për ngjarjen nuk mund të flitet më shumë se 20 sekonda, në gazetë nuk duhet të shkruhen më shumë se 210 fjalë, në TV ngjarja do të paraqitet në një kohë prej 1-2 minuta. Pas përfundimit të ngjarjes, diskutoni rezultatet duke përdorur pyetjet e mëposhtme:
  - Si ndikojnë mediat e ndryshme në mënyrën e trajtimit të ngjarjes dhe të informacionit që mund të jepet?
  - Cilat janë kodet dhe rregullatorët e përdorimit të tyre në zhvillimin e një ngjarjeje?
  - A shërben ky ushtrim si një shembull i frazës “Mjeti është mesazhi”?
  - Krijoni një kolazh me pamje ose simbole që mund të përdoren për përrurimin e një shkolle ose të një institucioni, duke marrë parasysh audiencën e synuar dhe informacionin që përçohet.



## Rekomandime për vlerësimin

- Përshkrim dhe vlerësim i llojeve të ndryshme të trajtimit të lajmeve në media të ndryshme.
- Zhvillimi dhe analiza e një lajmi për radion, për TV dhe për gazetën.

# Tema 3:

## Gjinitë e filmit dhe skenari



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Gjinitë e filmit
- Kodet teknike dhe simbolike në film
- Skenari i një skene filmi

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit do të jenë të aftë:

- Të identifikojnë gjinitë e larmishme të filmit dhe të kodeve e rregullatorëve që i shoqërojnë ato (përdorimi i teknikave të filmit, subjekti i filmit, tema, personazhet, elementet, situatat dhe mjediset).
- Të identifikojnë kodet e veçanta teknike dhe simbolike të përdorura për të përçuar qëllimin e filmit.
- Të zhvillojnë serinë e skicave për një sekuencë filmi që përfshin kodet dhe modelin/strukturën e një gjinie të veçantë.
- Të identifikojnë kodet dhe rregullatorët e përdorur në një gjini filmi që është mjaft e njohur në një vend tjetër.

## Qasjet pedagogjike dhe veprimtaritë

- ◆ Hartoni një listë me gjinitë e filmave që ju pëlqejnë. Identifikoni elementet kryesorë të secilës gjini. Shikoni një skenë nga njëri prej këtyre filmave. Vini re skenarin, mjediset, tipat e personazheve, muzikën, ndriçimin, efektet speciale, redaktimin dhe punën e kamerës.
  - Cilat janë mesazhet dhe vlerat që përçohen përmes përdorimit të këtyre elementeve në film?
- ◆ Shpjegoni mënyrën se si qëllimi i një skene mund të ndryshojë duke ndryshuar elemente të ndryshëm (p.sh. mjedisin, muzika etj.)
- ◆ Në grupe, krijoni një ngjarje duke përdorur skicat/ilustrimet për një skenë të një gjinie të caktuar filmi. Shpjegoni mënyrën në të cilën kapet “gjuha” e gjinisë në çdo skenë.
- ◆ Tregojuni mësuesve një videoklip nga një film i njohur nga një vend i huaj. Identifikoni ndryshimet dhe ngjashmëritë në gjuhët e filmit të përdorura me ato të një filmit të prodhuar në vendin tuaj. Diskutoni ndikimin e teknikave të ndryshme që janë përdorur në të.
  - Çfarë komunikohet përmes këtyre teknikave?
  - Cili është, sipas mendimit tuaj, audienca e synuar e çdo filmi?
- ◆ Duke përdorur internetin ose bibliotekën vendore, gjeni dy postera të të njëjtit film që do të tregohen në vende të ndryshme dhe shqyrtoni pyetjet e mëposhtme:
  - Cila është përshtypja për filmin që transmetohet përmes posterave?
  - Cilat janë kodet teknike dhe simbolike që janë përdorur. Për çfarë qëllimi?
  - A mund të identifikoni audiencën e synuar për secilin film, duke u bazuar tek posterat?

- Cili është informacioni që përçohet përmes posterave në lidhje me filmin?

## Rekomandime për vlerësimin

- ➔ Analiza e një skene filmi.
- ➔ Krijimi i një serie ilustrimesh për një skenë filmi.
- ➔ Analiza e posterit të filmit.
- ➔ Krahasimi i filmave.



# MODULI 5

Reklama

## Hyrje

Reklama përfshin përdorimin e paguar të medias (të shtypur dhe elektronike), për kohën ose hapësirën e përdorur, për të përçuar një mesazh për një shërbim ose produkt. Në përgjithësi, ekzistojnë dy lloje reklamash: reklamat tregtare dhe lajmërimet në shërbim të publikut, të cilat ndonjëherë quhen edhe marketingu shoqëror. Reklamat tregtare, në përgjithësi, përfshijnë reklamimin e një personi, të një malli, të një shërbimi ose të një kompanie për të rritur shitjet (p.sh. reklamat për kompanitë e veshjeve, për pijet jo alkoolike, filmat etj.) ndërsa lajmërimet në shërbim të publikut kanë të bëjnë me mesazhet dhe shërbimet nga të cilat përfiton publiku (p.sh. mesazhet për shëndetin dhe sigurinë, për letërsinë etj.). Të dyja format e reklamave përbëjnë burimin e parë të të ardhurave për median e re dhe tradicionale. Të ardhurat që media dhe ofruesit e tjerë të informacionit marrin nga reklamat përdoret për të paguar shpenzimet e përditshme dhe për zhvillimin e përmbajtjes (p.sh. programet televizive, materialet e faqes së internetit, artikujt e revistave, programet e radios etj.). Pa këtë të ardhur, shumë prej kompanive të mediave private, që përbëjnë një pjesë të mekanizmit qendror të mbrojtjes së demokracisë dhe të lirive që ne gëzojmë, nuk do të ekzistonin.

Për median është e rëndësishme të tërheqë të ardhura nga reklamat, duke ofruar mundësi ose mjete që do të tërhiqnin reklamuesit dhe sponsorët. Për këtë arsye, shpesh herë, media zhvillon përmbajtje që është në kërkesën e publikut ose që do të tërheqë grupime të mëdha e të larmishme qytetarësh. Këto grupe mund të ndahen sipas moshës, racës, seksit, të ardhurave, bindjeve personale e kështu me radhë.

Reklama, në një formë ose tjetër arrin pothuajse çdo qoshe të globit. Kompanitë, organizatat, qytetarët dhe qeveritë përdorin reklamat për të bërë të njohur produktet dhe shërbimet e tyre dhe për të përçuar informacione, besime dhe vlera. Informacioni

ose mesazhi i përcjellë përmes reklamës është thelbësor për vendimmarrjen e publikut. Duke pasur parasysh rolin e madh të reklamave në shoqërinë e sotme, mësuesit duhet të kuptojnë procesin e krijimit të reklamave të efektshme dhe të jenë të aftë të vlerësojnë reklamat si burime të informacionit. Më tej, mësuesit është e rëndësishme të mësojnë për mekanizmat që u japin qytetarëve mundësinë të bëjnë të njohur mendimin e tyre për reklamat tek industrinë dhe zyrtarët e shtetit.

Reklamat mund të kenë edhe ndikim negativ në media. Presioni nga reklamuesit mund të bëjë që gazetarët të mos shkruajnë për çështje ose tema kundërshtuese. Ato mund t'i shmangin përmbajtjet në interes të publikut në favor të zbavitjeve që tërheqin një audiencë të caktuar. Nëse nuk ka një mur të qartë ndërmjet anës informative dhe asaj të biznesit tek media, atëherë interesi i biznesit të kompanive të medias mund të ketë ndikim të madh në përmbajtjen dhe mënyrën e trajtimit të lajmeve, ndonëse një gjë e tillë nuk është qartësisht e dukshme.

Me shpërthimin e medias dhe të teknologjisë janë zgjeruar edhe mundësitë për reklama. Ndërkohë, industria vazhdon të rregullohet nga kode të veçanta që synojnë të ruajnë besimin e publikut. Në përgjithësi, këto kode veprojnë në nivel kombëtar dhe janë krijuar nga industria e reklamave. Kodet janë hartuar për të siguruar që reklamat të jenë të besueshme, të ndershme dhe të sakta. Në shumë vende, këshilli i reklamave dhe grupet e çështjeve konsumatorë mund të kontaktohen nga konsumatorët nëse kanë pyetje ose shqetësime në lidhje me praktikën e industrisë.

Sot, reklamat e kanë kapërcyer rolin e tyre tradicional. Ato nuk janë të lidhura vetëm me reklamat televizive, të revistave etj. Sot, reklamat për më shumë produkte, informacione, mesazhe dhe ide mund të paraqiten edhe përmes faqeve të internetit, celularëve dhe pajisjeve të tjera, në filma dhe programe televizive dhe në marrëveshje sponsorizimi, ndërkohë që kompanitë vazhdojnë të kërkojnë rrugë të reja për të sjellë informacionin e



tyre tek publiku. Qeveritë, politikanët, OJF-të përdorin strategjitë e reklamave në përpjekjet e tyre për të fituar mbështetje për politikën ose programet e tyre dhe, në disa raste, edhe për të përmirësuar imazhin e tyre.

Në shumë vende, baza për reklamat private në nivel vendor nuk është e mjaftueshme për të mbështetur të gjitha njësitë që ekzistojnë. Për këtë arsye, herë pas herë, kompanitë e medias duhet të varen edhe nga reklamat e kompanive të huaja si dhe nga qeveria. Përveç kësaj, kompanitë dhe organizatat ndërkombëtare që dëshirojnë të arrijnë audiencat vendore blejnë hapësirën e reklamës nga media vendore. Gjatë viteve të fundit, kemi parë të dalin markat e mëdha: produktet ose kompanitë, reklamat dhe emrat e të cilave janë bërë globale.

# Tema 1:

## Reklama: të ardhurat dhe rregullimet



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Analiza e rregullimeve të reklamave
- Zbatimi i rregullimeve në reklamat e sotme
- Reklama si model i të ardhurave

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të hetojnë reklamat si një burim i rëndësishëm i të ardhurave për televizionin.
- Të shqyrtojnë dhe të vlerësojnë qëllimin dhe efektshmërinë e rregullimeve ligjore në industrinë e reklamave.
- Të zbatojnë rregullimet ekzistuese në disa reklama të sotme.
- Të vlerësojnë ndikimin e reklamave në përmbajtjen e programeve dhe të medias.

### Qasje pedagogjike dhe veprimtari

- ◆ Duke përdorur internetin ose një bibliotekë, bëni një studim për rregullat që ekzistojnë në vendin tuaj për industrinë e reklamave. Identifikoni vendin ku qytetarët mund t'i gjejnë këto rregulla nëse kanë nevojë për informacion për

to. Identifikoni përse individët ose grupet i kanë krijuar këto rregulla. Bëni një përmbledhje të fushave kryesore që mbulojnë këto rregulla dhe shpjegoni qëllimin e tyre. Shpjegoni si i ndihmojnë ato interesat e qytetarëve dhe të konsumatorëve. Shpjegoni ndikimin e mundshëm të këtyre rregullave në industrinë e reklamave.

- ◆ Zbatoni rregullat në një larmi reklamash që gjenden në median vendore. Vlerësoni shkallën në të cilën ndiqen ose zbatohen këto rregulla. Jepni shembuj nga çdo reklamë për të mbështetur përgjigjen tuaj. Zbuloni burimet që janë në dispozicion të konsumatorëve në rastet kur një reklamë i shkel këto rregulla.
- ◆ Zbuloni nëse nevojat e reklamuesve kanë ndikuar tipin, cilësinë e programimit ose të trajtimit nga media. Analizoni reklamën si një model i të ardhurave për një media të caktuar. Për shembull, shqyrtoni kohën kur televizioni ka shikueshmërinë më të lartë ose radio ka dëgjueshmërinë më të lartë. Vini re programet që jepen në orën 20:00 dhe në orën 23:00
- ◆ Zgjidhni një stacion dhe shikoni ose dëgjoni një ose dy orë të këtij programi, rendisni reklamat që jepen gjatë kësaj kohë. Shpjegoni arsyen përse reklamat vendosen pikërisht gjatë kësaj periudhe. Dalloni çdo reklamë ose produkt që shfaqet gjatë transmetimit të vetë këtyre programeve. Vlerësoni efektshmërinë e strategjive të reklamave për të arritur audiencën e synuar, që janë të përdorur gjatë kësaj periudhe kohore.
- ◆ Zbuloni vlerësimet për 10 programet televizive më të shikuara në vendin tuaj. Zgjidhni një rrjet televiziv dhe përcaktoni produktet ose shërbimet që mund të zgjidhni për t'i reklamuar gjatë kësaj periudhe kohore. Shpjegoni zgjedhjet tuaja, duke identifikuar edhe audiencën e synuar që mund të arrihet gjatë kësaj kohe. Bëni një kërkim për të përcaktuar të ardhurat e siguruara nga një reklamë prej 30 sekondash të dhënë gjatë kësaj kohe.

- o Supozoni që reklama është burim i parë i të ardhurave për median.
  - A duhet të sakrifkohet liria e shprehjes, liria e shtypit ose liria e sigurimit të informacionit për t'i bërë qejfin interesave të reklamuesve, kompanive të mëdha ose qeverisë?
  - Cilat do të ishin pasojat?
  - A duhet të bëhen publike financimet që qeveria u bën mediave dhe ofruesve të tjerë të informacionit?
  - A duhet që media e financuar në mënyrë publike ose private t'i japë llogari qeverisë për të ardhurat që merr nga reklamat?
- o Qëllimi i parë i medias dhe i ofruesve të tjerë të informacionit është të sigurojë fitime. Diskutoni këtë pohim. Jepni argumente pro ose kundër.
  - A mundet që media dhe ofruesit e tjerë të informacionit të veprojnë pa reklama?
  - Cilat janë masat që duhet të merren nga qytetarët nëse media dhe ofruesit e tjerë të informacionit sakrifikojnë të mirën e përbashkët për të ardhurat që merren nga reklamat?
  - Përse duhet të merren masa të tilla?

Këto ushtrime mund të kryhen edhe nëse në vend të TV përdoren gazetat, revistat etj.

## Rekomandime për vlerësim

- ➔ Analizë dhe vlerësim i bazuar në rregullat
- ➔ Zbulimi dhe vlerësimi i programeve televizive, reklamave dhe të ardhurave.

## Tema 2:

# Lajmërimet për publikun



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Analiza e lajmërimeve për publikun
- Procesi krijues dhe planifikimi i lajmërimeve për publikun

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit do të jenë të aftë:

- Të analizojnë në numër lajmërimesh si shërbim për publikun si mjet i komunikimit të informacionit për çështje të ndryshme.
- Të zhvillojnë një plan origjinal të lajmërimit si shërbim për publikun, duke përfshirë edhe qëllimin, mesazhin, audiencën e synuar dhe strategjitë taktike dhe krijuese.
- Të prodhojnë një lajmërim si shërbim për publikun
- Të vlerësojnë efektshmërinë e strategjive të komunikimit dhe të lajmërimeve si shërbim për publikun në përçimin e informacionit dhe të mesazhit të synuar, si dhe në arritjen e një audience të synuar.

### Qasjet pedagogjike dhe veprimtaritë

Qeveritë, në mënyrë periodike, dëshirojnë të komunikojnë me qytetarët e tyre përmes medias për të arritur një synim të veçantë të politikës publike. Shembull në këtë drejtim mund të jetë një

fushatë për shëndetin publik, me qëllim që të pengohet përhapja e infektimi me virusin HIV dhe AIDS ose të nxitet përdorimi i rrjetave kundër mushkonjave për të penguar përhapjen e malaries. Këto njihen si lajmërimet për shërbime publike.

- ◆ Duke u bazuar në shembuj, shqyrtoni dhe diskutoni thelbin dhe qëllimet e lajmërimeve si shërbim për publikun. Shpjegoni si këto lajmërimet, si shërbim për publikun, ndryshojnë nga reklamat tregtare. Rendisni një listë çështjesh që trajtohen në lajmërimet që keni parë. Identifikoni përdorimet e ndryshme të këtyre lajmërimeve në vendin tuaj.
- ◆ Vizitoni një ndërfaqet e internetit që merret me shërbime për publikun. (Këto të përfshihen vetëm si burime për të ilustruar veprimtarinë e përshkruar më poshtë. Në vend të burimit të mësipërm, mund të përdoren burime të tjera, të përshtatshme për zona të ndryshme).

- <http://www.un.org.za/public-service-announcement-on-the-effects-of-drugs>
- <http://www.unodc.org/unodc/en/human-trafficking/human-trafficking-public-service-announcements.html>
- <http://saloproductions.com/public-service-announcements/psa-samples.php>

Shqyrtoni një numër lajmërimesh si shërbim për publikun, të shtypura ose video dhe diskutoni për tiparet kryesore të secilës prej tyre. Identifikoni informacionin dhe mesazhin kryesor që përçohet dhe analizoni si janë paraqitur ato. Shqyrtoni edhe strategjitë teknike dhe krijuese.

- ◆ Analizoni përdorimin e tërheqjes emocionale në lajmërimet si shërbim për publikun. Identifikoni çdo pretendim të bërë nga këto lajmërimet dhe nëse mbështeten ato në fakte apo jo. Analizoni se si elementet teknike të lajmërimeve për publikun përforcojnë qëllimin ose mesazhin. Shpjegoni efektet e krijuara përmes përdorimit të pamjeve dhe këndeve të ndryshme të kamerës. Shpjegoni si mund të përdoret tingulli për të përçuar qëllimin.

- ◆ Mësuesit mund të zbërthejnë më hollësisht një lajmërim për publikun, duke krijuar një varg skicash që bazohen në atë çfarë shohin. Ata duhet të shohin lajmërimin më shumë se një herë dhe trajneri duhet të ndalojë shfaqjen pas çdo pamjeje për t'u dhënë mundësi mësuesve të dokumentojnë çfarë shohin në mënyrë grafike. Shembuj të paraqitjes grafike mund të gjenden në [www.storyboardsinc.com](http://www.storyboardsinc.com)
- ◆ Zhvilloni një plan origjinal për një lajmërim për publikun për një çështje të rëndësishme social ose kulturore. Mendoni për një listë të mundshme çështjesh si bazë për lajmërimin tuaj. Diskutoni për qëllimin dhe audiencën. Ky diskutim do të ndihmojë në modelimin e mesazhit që duhet të përçohet. Merrni parasysh informacionin dhe mesazhin kryesor që keni nevojë të përçoni.
  - Përcaktoni kë dëshironi të arrini dhe në ç'mënyrë. Informacioni dhe mesazhi duhet t'i drejtohet një audience të veçantë të synuar.
  - Në një letër, përshkruani konceptin dhe zhvilloni një listë strategjish që mund të përdoren për të krijuar lajmërimin tuaj për publikun.
  - Kjo mund të përfshijë strategjitë krijuese (idetë e përmbajtjes së lajmërimit) dhe strategjitë teknike (përbërësit e prodhimit).
  - Përfundoni një skicë-ide për lajmërimin për publikun, duke përfshirë edhe një deklaratë që përshkruan konceptin, strategjitë teknike dhe krijuese si dhe audiencën.

## Rekomandime për vlerësimin

- ➔ Koncepti dhe planet për një lajmërim për një shërbim publik.
- ➔ Produkti final: Lajmërimi për shërbime për publikun si një tekst i medias – paraqitja dhe diskutimi.

## UDHËZIME PËR NJË LAJMËRIM NË SHËRBIM TË PUBLIKUT

Përshtatur nga *Letërsia për të mënduar*

[www.edu.gov.on.ca/eng/.../thinkliteracy/library.html](http://www.edu.gov.on.ca/eng/.../thinkliteracy/library.html)

**Koncepti:** Projektuar nga ju për të përmbushur objektivat e organizatat ose klientët dhe për të shpjeguar qëllimin ose funksionin e fushatës.

**Strategjitë:** Krijuese (një shpjegim të ideve tuaja, duke përfshirë një përshkrim të mënyrës si mund të përmbushen objektivat) dhe teknike (cila është media që mund të përdoret, në ç'mënyrë mund të përdoret media dhe si mund të plotësohen edhe objektivat e klientit).

**Audienca:** Cila është audienca juaj? Kë dëshironi të arrini? Përshkruani hollësisht audiencën tuaj (p.sh. mosha, gjinia, raca, klasa, kombësia, njohja me këtë formë të medias etj.)

**Teksti:** Mesazhi i përgjithshëm i fushatës, që mund të lidhet me objektivat dhe strategjinë krijuese (informacioni kryesor i përfshirë në të, pikëpamjet, linjën historike, imazhet e burrave dhe grave, gjuhën zakonet dhe sjelljen e personazheve). Shqyrtoni përdorimin e pretendimeve të veçanta dhe tërheqja emocionale.

**Prodhimi:** Një skicë ide për atë që duhet të prodhohet. Kjo mund të lidhet me strategjinë teknike. Merrni parasysh vendndodhjen, punën e kamerës, tingulli, zëri, efektet speciale, grafika, animimi etj. Vendosni për teknologjitë që do të përçojnë qëllimin që dëshironi dhe plotësoni mesazhin tuaj.

**Përbërësit e industrisë/biznesit:** Shpjegoni dhe mbroni zgjedhjet në lidhje me vendin dhe kohën që ju dëshironi të shpallni lajmërimin tuaj. Po kështu, një televizion, radio ose internet duhet të përfshijë elemente të reklamave të paraqitura në këtë media si sloganet, kërkesat e veçanta, një skenar që përfshin mjedisin e duhur, detajet dhe kostumet, një skenar grafikësh që përfshijnë videot e duhura dhe udhëzimet audio.



## Tema 3:

# Reklama dhe procesi krijues



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Reklama dhe financimi – vendndodhja, mesazhet dhe audienca
- Vlerësimi i pretendimeve dhe tërheqja në reklama
- Shqyrtimi i dizajnit dhe prodhimi i reklamës
- Vendosja e produktit në programe

### Objektivat e të mësuarit

Pas përfundimit të kësaj njësie mësimore, mësuesit do të jenë të aftë:

- Të analizojnë procesin e reklamave si mjet i komunikimit të informacionit.
- Të eksplorojnë konceptin e zhvillimit në fushën e reklamave, duke përfshirë edhe strategjitë teknike dhe krijuese.
- Të zbërthejnë përbërësit kryesorë që barten në një reklamë dhe kërkesat e saj emocionale.
- Të vlerësojnë ndikimin e mesazheve të reklamave në audienat e veçanta që synohen prej tyre.
- Të shpjegojnë mënyrën si zbatohet koncepti i audiencës “aktive” në fushën e reklamave ose, në mënyrë të veçantë, si audienat negociojnë qëllimin e tyre (p.sh. si shpjegojnë suksesin e disa prej reklamave dhe jo të disa të tjerave).

- Të identifikojnë prirjet e fundit në fushën e reklamave.
- Të identifikojnë vendosjen e produkteve në programet si reklama të tërthorta (përzierja e përmbajtjes së programit me atë tregtare).

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

- ◆ Ndërmerrni një udhëtim imagjinar në shkollën ose në lagjen tuaj. Identifikoni llojet e reklamave, lajmërimet si shërbim ndaj publikut, përrurimet ose financimet që ekzistojnë atje. Hartoni një përshkrim të shkurtër të secilës prej reklamave, të lajmërimeve për publikun, financimet që ekzistojnë atje. Përshkruani mesazhet dhe pamjet e krijuara përmes shembujve të përzgjedhur dhe vlerësoni efektshmërinë e tyre në transmetimin e informacionit të nevojshëm. Identifikoni burimet e secilit shembull (p.sh. kush e krijoi, kush përfiton prej tij etj.)
  - Shpjegoni përse biznesi dhe institucionet mund të zgjedhin të kenë emrat, produktet ose logot e tyre. Shpjegoni në ç'mënyrë këto përrurime/financime ndryshojnë nga reklamata tradicionale.
- ◆ Komunitetet, shpesh herë, vendosin nëse duhet të shesin ose jo të drejtat e vendosjes së emrit për zonat, vendet ose ndërtesat. Diskutoi përfitimet dhe detyrimet e strategjive të tilla të reklamave për reklamuesit, komunitetin dhe individin.
- ◆ Bëni një kërkim në një koleksion revistash, shikoni reklamata në TV dhe vizitoni faqet e kompanive të mëdha. Përshkruani strategjitë e reklamave të përdorura në shembujt e zgjedhur. Përzgjidhni një numër reklamash për t'i shqyrtuar më nga afër. Përshkruani "personalitetin" e produktit të paraqitur në secilën reklamë dhe identifikoni emocionet që përpiqet të prodhojë reklamuesi. Cilat janë premtimet ose zgjidhjet që ofron një reklamë ose një lajmërim publik?

- o Identifikoni informacionin, mesazhet dhe vlerat që përçohen në secilën reklamë. Diskutoni nevojën për një dallim të qartë ndërmjet përmbajtjes informuese dhe asaj tregtare.
  - A ka ndonjë pretendim të veçantë të pranishëm në këto reklama?
  - Cilat janë faktet që paraqiten për t'i mbështetur pretendimet?
  - A ekziston ndonjë informacion i paqartë ose keq informues?
  - Duke u bazuar në analizën tuaj, cilat janë rekomandimet që do t'i jepni audiencës për këtë reklamë?
  - Me fjalë të tjera, a do ta pranoni informacionin e paraqitur në këtë reklamë? Përse po ose përse jo?
  - A do të sugjeronit ndryshime për ta bërë informacionin ose mesazhin më të plotë? Shpjegoni sugjerimet tuaja përmes shembujve.
- ◆ Zgjidhni një reklamë në shtyp për ta shqyrtuar më afër. Ky ushtrim kërkon nga ju të identifikoni elementet e përdorur në reklamë, informacionin dhe mesazhin e përçuar dhe audiencën e synuar. Në ç'mënyrë elementet e identifikuar (organizimi, këndi, ngjyra, zgjedhja e fjalëve etj.) mbështesin mesazhin dhe informacionin që përçon? Me fjalë të tjera, në ç'mënyrë forma përforcon përmbajtjen?
- ◆ Vendosja e produktit nënkupton vendosjen e një produkti tregtar dukshëm në një program të veçantë në radio ose televizion ose në një libër dhe, gjë që po ndodh gjithnjë e më tepër, në internet, pa e identifikuar atë si një reklamë, për të kënaqur prodhuesin e produktit që ka financuar programin (ka paguar tërësisht për të ose ka mbuluar kosto që lidhen të). Disa mbikëqyrës lejojnë vendosjen e produktit me kusht që shikuesit të informohen qartësisht për vendosjen e këtij produkti në fillim dhe në fund të programit. Përzgjidhni shembuj të vendosjes së produkteve:

- o A identifikohen ata si të tillë?
- o Nëse ekzistojnë rregulla për vendosjen e produktit në vendin tuaj, cilat janë disa nga veprimet që mund të ndërmarrin qytetarët?
- o Cili është mesazhi që përçohet për produktin për shkak të kontekstit?
- o Cili është mesazhi që përçohet përmes vetë produktit si dhe të kontekstit për të?
- o A do të ndryshonte imazhi për produktin dhe mesazhi që ai përcjell në një kontekst ose vendosje tjetër?
  - Bëni një listë të aktorëve të përfshirë në një industri reklamash (individë, institucione, organizata). Përshkruani rolet e tyre përkatëse. Shqyrtoni një reklamë audiovizive. A mendoni që roli i secilit prej aktorëve shprehet qartë në këtë reklamë? A mendoni që njohuritë tuaja për rolin e aktorëve të përfshirë në krijimin dhe përhapjen e kësaj reklame ju ndihmojnë të ndërveproni më mirë me to se të vlerësoni dobinë e informacionit për të cilin keni nevojë?

## Rekomandime për vlerësimin

- ➔ Analizë e reklamës – duke përfshirë kërkesën emocionale, përbërësit teknikë dhe audiencën e synuar.
- ➔ Ditari i medias – përgjigje ndaj analizës së reklamës dhe shikueshmërisë.

## Tema 4:

# Reklammat dhe arena politike



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Analiza e reklamave për politikën dhe për zgjedhjet
- Vlerësimi i udhëzimeve për reklammat politike
- Vlerësimi i institucioneve rregullatore për reklammat për zgjedhjet
- Rregullimet për medias që zbatohen gjatë zgjedhjeve kombëtare

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të vlerësojnë reklammat për politikën dhe për zgjedhjet.
- Të vlerësojnë udhëzimet që ekzistojnë për reklammat politike.
- Të analizojnë kërkesat emocionale në reklammat politike dhe ato për zgjedhjet.
- Të rekomandojnë strategji për të mbajtur një qytetari të informuar, në kushtet e pranisë së kërkesave emocionale në reklammat politike.
- Të shpjegojnë procedurat në dorë të qytetarëve që dëshirojnë të krijojnë një organizëm rregullator gjatë zgjedhjeve.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

- ◆ Mblidhni shembuj të reklamave politike nga vendi ose qyteti juaj. Nëse është e nevojshme, bëni një kërkim në bibliotekën e qytetit. Analizoni reklamat duke përdorur udhëzimet nga Tema 2. Shqyrtoni arsyet përse një qytetar do të ishte i interesuar në reklamat politike. Vlerësoni efektshmërinë e secilës prej reklamave, mbi bazën e qëllimit, të informacionit, të mesazhit të përçuar dhe të audiencës së synuar. Shpjegoni si është përdorur forma e reklamës për të përforcuar përmbajtjen e saj.
- ◆ Shqyrtoni disa prej reklamave të së njëjtës fushatë politike. Vlerësoni efektshmërinë e fushatës në tërësi në lidhje me përdorimin e grafikëve, imazheve, parullave dhe mesazheve të unifikuar.
- ◆ Duke përdorur internetin ose burime nga bibliotekat bëni një kërkim për organizmat rregullatorë që ekzistojnë për të mbikëqyrur reklamat politike. Shqyrtoni udhëzimet që janë hartuar për të mbikëqyrur reklamat e përdorura nga kandidatët politikës gjatë zgjedhjeve. Vlerësoni në çfarë shkalle reklamat e zgjedhura janë në zbatim të këtyre udhëzimeve.
- ◆ Hetoni për mënyrën në të cilën këto organizma rregullatorë përfaqësojnë interesat e qytetarëve. Shqyrtoni rolin që mund të luajnë qytetarët për të siguruar që reklamat politike të jenë të besueshme, të ndershme dhe të sakta. Parashtroni sugjerimet që do t'u bënit organizmave rregullatorë në lidhje me reklamat politike.
- ◆ Rendisni rregullimet e medias (të vendosura nga komisioni kombëtar i zgjedhjeve. Shikoni nëse ekzistojnë udhëzime për raportimin e anketave të opinionëve, duke u dhënë kohë transmetimi nga rrjetet kombëtare partive të ndryshme politike, përhapjes së rezultateve të zgjedhjeve etj.
- ◆ Këshilltari politik Frank Luntz u thotë klientëve të tij politikanë që 80% e jetës sonë është emocion dhe vetëm

20% është intelekt. Unë interesohem më shumë për mënyrën si ndihem se sa për mënyrën si mendoj.

- Shqyrtoni reklamat politike në dritën e këtij komenti.
  - Shpjegoni gjuhën e përdorur për të "shitur" kandidatin dhe idetë ose politikat e tij.
  - Vlerësoni nëse gjuha e përdorur është e saktë ose jo, ose ajo është keq informuese.
- ◆ Duke pasur parasysh kërkesat emocionale në reklamat politike, rekomandoni strategji për të pasur gjithmonë qytetarë të informuar.

## Çështje të tjera për diskutim

- Financim privat dhe komunitar (duke përfshirë edhe financimet dhe reklamat në shkolla).
- Mbështetja e personazheve të shquar në reklama.
- Kapitalizmi i kujdesshëm – i lidhur me mbështetjen e njerëzve të shquar, megjithëse fokusi është në nxitjen e publicitetit dhe të altruizmit strategjik të korporatave të ndryshme.

# MODULI 6

Media e re dhe e vjetër



## Hyrje

Ky modul i njeh mësuesit me rolin që teknologjitë e reja dhe ato të integruara po luajnë në zgjerimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në ndryshimet shoqërore, ekonomike dhe politike. Ai shpjegon mënyrën si janë zhvilluar format e reja të medias digjitale dhe elektronike (lajmet online etj. Wikipedia, Youtube, zbatimet e rrjeteve sociale etj.) nga media tradicionale dhe si ato po zgjerojnë mundësitë e përdorimit të informacionit dhe të njohurive, të lirisë së shprehjes, të mirëqeverisjes dhe të pjesëmarrjes në proceset demokratike.

Bashkekzistenca e medias së shtypur, medias transmetuese (radio dhe TV), e internetit, e telefonave celularë etj. po mundëson që përmbajtja e medias të rrjedhë në platformat e ndryshme, duke e zgjeruar mundësinë e gjetjes së informacionit dhe duke krijuar kulturën e pjesëmarrjes, ku qytetarët jo vetëm konsumojnë informacion, por marrin pjesë aktive në prodhimin dhe përhapjen e tij. TIK kanë krijuar mundësi të reja për pjesëmarrjen në shkëmbimin e informacionit dhe të njohurive të një audience më të madhe dhe po nxisin njerëzit të përfshihen në proceset demokratike, duke shkaktuar hapjen më të madhe të shoqërisë.

Në fakt, media e re dhe teknologjitë e integruara po krijojnë hapësira të reja për vetëshprehje dhe pjesëmarrje në dialogun publik në një numër të madh çështjesh sociale, ekonomike dhe politike. Platformat e medias së re, po i lejojnë qytetarët të përfshihen në mënyrë të vetëdijshme në proceset demokratike në shoqëritë e tyre dhe të ndihmojnë të sjellin lajmet dhe çështjet globale më pranë shoqërisë së tyre.

# Tema 1:

## Nga media tradicionale në teknologjitë e medias së re



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Ndryshimet dhe vazhdimësia – një histori e shkurtër e medias
- Çfarë është shkrirja e medias?
- Media digjitale si media e re
- Ndryshimet thelbësore ndërmjet medias së re dhe asaj tradicionale

### Objektivat e të mësuarit

Në përfundim të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të shpjegojnë një histori të shkurtër të medias.
- Të përshkruajnë mënyrën si teknologjitë e reja kanë çuar në shkrirjen e medias tradicionale me median e re.
- Të përshkruajnë ndryshimin ndërmjet medias së re dhe tradicionale dhe se si media e re ka rritur pjesëmarrjen në demokraci.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Zhvillim i rëndësishëm me rritjen e medias digjitale ka qenë zhvendosja nga modeli i komunikimit tradicional të “një tek shumë të tjerë”, që është karakteristikë e shtypit dhe medias transmetuese, në modelin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet të barabartëve (*peer to peer*), gjë që lehtëson krijimin në bashkëpunim dhe ndarjen e përmbajtjes. Meqë përmbajtja është e digjitalizuar, ajo bëhet e arritshme nga shumë pajisje, duke përfshirë radion, TV, kompjuterin personal dhe ndoshta më e rëndësishmi, telefoni celular, i cili po shfaqet si platforma sunduese për përhapjen e përmbajtjeve të ndryshme. Digjitalizimi i zërit, i imazhit, i tingullit dhe i të dhënave që njihen si shkrirje, po krijon shanse të reja për ndërveprim.

Të trajnuarve, në grup, u jepet detyra të studiojnë evolucionin e medias deri në daljen e internetit, duke hedhur dritë në mënyrën si u përdor interneti në fillimet e tij dhe si u bë më i përdorshmi në shoqëri. Ata duhet të vlerësojnë zbatimet dhe përfitimet e edukimit, të shoqërisë civile dhe të qeverisjes. Rezultati i punës së tyre paraqitet përpara klasës për diskutim.

Të trajnuarit kërkojnë për shkallën në të cilën media digjitale ofron mundësitë për lirinë e shprehjes në shoqërinë e tyre. Në kërkimin e tyre, ata duhet t’i kushtojnë vëmendje mënyrës si njerëzit përdorin median e re për t’u vetëshprehur. Ata duhet të vënë re si media tradicionale (gazetat, radio dhe TV) po shkrihen me median e re në shoqërinë e tyre. Të trajnuarit duhet të paraqesin gjetjet e tyre përpara klasës duke përdorur PPT ose forma të tjera paraqitjeje.

Të trajnuarit kërkojnë shkallën në të cilën media sfidon median tradicionale të lajmeve, llojet e ndryshme të mediave që njerëzit në vendet e tyre përdorin për të shprehur pikëpamjet e tyre për tema lajmesh dhe përdoruesit e platformave të ndryshme të media, së bashku me çështjet/temat që ata diskutojnë. Rezultatet e kërkimit paraqiten për diskutim dhe debat në klasë.

## Veprimtari

- ❖ Shkruani një ese të shkurtër për ndryshimet kryesore ndërmjet medias së re dhe asaj tradicionale, duke diskutuar shkallën në të cilën këto ndryshime janë reale ose artificiale. Në ese, vlerësoni ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet medias tradicionale dhe medias elektronike ose digjitale. Po kështu, nëse duhet, të theksohen edhe çështjet e përgjegjësisë gazetareske, verifikimi dhe parimet e tjera të gazetarisë.
- ❖ Një nga karakteristikat e medias tradicionale është që përmbajtja e saj kalon përmes një procesi të organizuar redaktimi, i cili synon të verifikojë vërtetësinë e ngjarjeve të lajmit dhe t'i lidhë ato me një organizatë mediatike lajmesh dhe jo me një individ. Gazetaria e qytetarëve online nuk punon në këtë mënyrë.  
  
Në këtë kontekst, diskutoni për ndryshimet ndërmjet lajmeve që mbështeten në opinione të një gazetari individual dhe lajmeve që raportohen në versionin online të një gazete.
- ❖ Bëni një kërkim dhe shkruani një raport për shkallën në të cilën njohuritë dhe informacioni kanë ndryshuar apo kanë mbetur të njëjtë edhe në kushtet e zhvillimit të medias dhe të teknologjive të reja të saj.

Përgatisni një ese për mënyrën se si shfaqja e medias së re ka ndikuar mënyrën e ndërveprimit të njerëzve dhe të përfitimit që ata kanë prej saj. Po kështu, pyesni se si media e re po ndikon në jetën sociale dhe akademike të mësuesve dhe cilat janë sfidat dhe mundësitë që ekzistojnë për të përmirësuar përdorimin e medias digjitale.

## Tema 2:

# Përdorimi i teknologjive të medias së re, komunikimi digjital dhe masmedia



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Media e re dhe ndërveprimi social – rrjetet sociale
- Teknologjia dhe zhvillimi i komunikimit
- Ndërveprimet ndërmjet ndryshimeve në komunikimin masiv si rrjedhojë e teknologjive të reja dhe e ndryshimeve në institucioneve demokratike

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të analizojnë efektshmërinë e komunikimit digjital në jetën sociale dhe politike të një shoqërie.
- Të përshkruajnë përdorimin e një ose dy formave të medias së re për të ndarë njohuritë dhe informacionin për një çështje aktuale.
- Të vlerësojnë mënyrën se si media e re përdoret në komunikimin masiv dhe ndikimin e saj në institucionet demokratike dhe proceset sociale.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

**Kërkim dhe diskutim në klasë:** Pjesëmarrësit në trajnim ndërmarrin një kërkim për të vlerësuar ndikimin e teknologjive të komunikimit digjital në proceset e zhvillimit. Kjo duhet të përfshijë të mësuarit për platformat e përdorura në vend dhe për mënyrën në të cilën media e paraqet vendin në botën e jashtme. Të trajnuarit duhet të vizitojnë një faqe interneti të vendit të tyre dhe të diskutojnë në grupe për mënyrën se si projektohet vendi ynë dhe si krahasohet me vendet fqinjë. Ata duhet të renditin një listë tiparesh që do të donin t'i përfshinin në imazhin e vendit të tyre në botën e jashtme. Diskutoni për gjetjet.

**Anketim dhe prezantim në grup.** Pjesëmarrësit në trajnim organizojnë një anketim për të hetuar ndikimin e komunikimit masiv tradicional dhe të medias së re (p.sh. radio e komunitetit, gazetatat private, rajonale dhe kombëtare, interneti) te pjesëmarrja e audiencës në jetën sociale, ekonomike ose në debatin politik. Si tema të anketimit mund të zgjidhen, për shembull, edukimi për HIV/AIDS ose drejtësia shoqërore për pakicat. Në mënyrë të veçantë, mund të jetë me interes të përqendrohen në rolin e telefonisë celulare dhe zbatimet e rrjeteve sociale (Facebook, Twitter) si mjete për të mobilizuar grupet. Trajneri, në mënyrë më të përgjithshme, mund të diskutojë:

- ◆ Cilët janë pronarët e medias?
- ◆ Kush i krijon mesazhet dhe cili është mesazhi kryesor që transmetohet?
- ◆ Cila është audienca që synohet dhe për ç'qëllim?
- ◆ Cilët janë financuesit dhe investitorët dhe çfarë duhet të bëjnë ndryshe?
- ◆ Ku ndryshon media tradicionale nga media online në këtë drejtim?

**Diskutim në klasë.** Drejtuesi duhet ta drejtojë klasën në një diskutim për median e re që përdoret më shumë në mjedisin e pjesëmarrësve në diskutim: Interneti, teknologjia e lëvizshme

(celularët dhe aplikacionet e tyre, TV digjital, radio digjitale, lojërat kompjuterike dhe lojërat online etj.

Diskutimi duhet të eksplorojë përparësitë dhe kufizimet e këtyre formave të medis së re. Përpara kësaj veprimtarie, pjesëmarrësit duhet të kenë kryer intervistat në lidhje me përdorimin e celularëve, si në zonën urbane ashtu edhe në atë rurale. Duke u bazuar në përgjigjet e intervistave, ata duhet të paraqesin në auditor mendimin e tyre në lidhje me ndikimin e telefonave në jetën sociale, politike dhe ekonomike të përdoruesve.

## Veprimtari

- ❖ Kryeni një anketim për mënyrën si media e re dhe teknologjitë e saj po ndryshojnë mënyrën e komunikimit të njerëzve në shoqërinë tonë dhe si kjo po ndryshon edhe mënyrën e ndërveprimit, të shkëmbimit të informacionit dhe njohurive dhe të marrjes së vendimit.
- ❖ Kryeni një kërkim në lidhje me mënyrën se si masmedia dhe teknologjitë e reja po përdoren për komunikimin masiv dhe si ato po ndikojnë jetën e përditshme, vlerat dhe opinionin e publikut. Për shembull, si kanë ndihmuar celularët për të mbushur hendekun e komunikimit ndërmjet të pasurve dhe të varfërve në shoqëri? Eksploroni se si komunikimi digjital po ndryshon mënyrën e ndërveprimit të njerëzve në shoqëri, për shkëmbimin e njohurive dhe të informacionit.
- ❖ Zhvilloni një strategji për përdorimin e një rrjeti social për të promovuar ndërveprimin për një çështje të veçantë që dëshironi i ta trajtoni me nxënësit tuaj. Cilat janë rreziqet dhe sfidat me të cilat mund të përballen mësuesit në përdorimin e rrjeteve sociale për qëllime edukative? Identifikoni rreziqet dhe sugjeroni rrugët për zvogëlimin e ndikimit të tyre.
- ❖ Qeverisja elektronike përfshin format e reja në zhvillim të qeverisjes, në të cilën roli i TIK është qendror. Përdorimi i TIK ndikon në qeverisje në disa mënyra:

- **E-demokracia** që lehtëson pjesëmarrjen përmes rrugëve në rritje të arritjes dhe të përdorimit të informacionit dhe të njohurive që përbëjnë bazën për procesin e vendimmarrjes.
- **E-shërbimet** që kanë automatizuar detyrat e mërzitshme si është plotësimi i formularëve, verifikimi i gjendjes së aplikimeve etj.
- **E-administrimi** përmirëson proceset e qeverisjes dhe të punës së brendshme të sektorit publik me anë të teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit - proceseve e ekzekutimit të informacionit.

Siç shihet, TIK mund të jenë një mënyrë shumë e dobishme për të përmirësuar proceset e qeverisjes. *E-qeverisja* dhe *E qeveria*, me gjithë ndryshimet e vogla që kanë, janë koncepte që lidhen ndërmjet tyre. *E-qeveria* nënkupton sistemet me anë të cilave automatizohen proceset e qeverisjes, ndërsa *E-qeverisja* lidhet me proceset që janë bërë të hapura dhe gjithëpërfshirëse.

- o Kërkoni nga mësuesit të përdorin internetin për të mësuar ekzistencën e E- qeverisjes në vendin tuaj. Ata duhet të zgjedhin dy shembuj si fakte që dëshmojnë këtë prani. Ata duhet të tregojnë shkallën e përfshirjes ose të këshillimit të tyre në këtë proces.
  - Ku konsultohen qytetarët në përgjithësi?
  - Diskutoni për efektivitetin e këtyre projekteve.
  - Cilat janë përfitimet dhe mangësitë?
- o Kërkoni për projekte të ngjashme në vendin tuaj ose në botë në lidhje me qeverisjen vendore.
  - Çfarë projektesh të E-qeverisjes do t'i sugjeronit qeverisë suaj?
  - Përse mendoni që përdorimi i TIK ose i teknologjive të reja është i rëndësishëm për fuqizimin e burrave, grave, të njerëzve me aftësi të kufizuara dhe të



grupeve të përjashtuara, si dhe ato që jetojnë në zona të largëta?

- o Duke përdorur burimet lokale ose ndërkombëtare, bëni një kërkim në lidhje me garantimin e përdorimit të TIK ose të teknologjive të reja nga gratë, njerëzit me aftësi të kufizuara dhe ata që jetojnë në komunitete të largëta.
  - A kanë gratë mundësi të njëjta si dhe burrat në këtë drejtim?
  - Sa u garantohet kjo mundësi njerëzve me aftësi të kufizuara ose atyre që banojnë në zona të largëta?
  - Cilat janë pasojat?
  - Çfarë duhet bërë nëse disa prej grupeve përjashtohen nga sigurimi i përdorimit të teknologjive të reja?
  - Nëse mungojnë të dhëna të tilla për vendin ose rajonin tuaj përpikuni të gjeni arsyen përse jo?
  - Cila janë organizatat që duhet të shqetësohen për mungesën e këtyre të dhënave?
  - Çfarë mund të bëhet për këtë qëllim?

## Tema 3:

# Përdorimi i mjeteve ndërvepruese multimediale, duke përfshirë lojërat digjitale në klasë



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Mjetet ndërvepruese multimediale, burimet e hapura arsimore dhe tipat e programeve për përmirësimin e edukimit.
- Mjetet ndërvepruese multimediale/lojërat digjitale për krijimin e mjediseve miqësore për nxënësit.
- Lojërat e medias si mjet për rritjen e vetëdijes për çështjes globale.
- Lojërat arsimore ndaj lojës për zbavitje

### Objektivat e të mësuarit

Në përfundim të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të identifikojnë vlerat e mjeteve ndërvepruese multimediale, duke përfshirë faqet ndërvepruese në internet, paraqitjet, diskutimet online, e-librat, lojërat për mësimdhënie dhe për të mësuar etj.
- Të zhvillojnë aftësitë sociale, intelektuale dhe ato të kohës dhe hapësirës, përmes përdorimit të mjeteve ndërvepruese multimediale dhe lojërat në veçanti.

- Të zbatojnë mjetet ndërvepruese multimediale në procesin e të mësuarit dhe të mësimdhënies.
- Të përdorin mjetet ndërvepruese multimediale të teknologjisë së ulët ose të lartë për të bërë të njohur konceptet nga lëndët akademike (matematika, shkencat, shkencat sociale etj.).
- Të analizojnë mjetet ndërvepruese multimediale të ndryshme që janë zhvilluar duke përdorur programe nga burime të hapura dhe pa pagesë ose të firmave të ndryshme dhe të vlerësojnë ndikimin e tyre në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit.
- Të vlerësojnë ndikimin dhe shanset që ofrohen nga burimet e hapura edukative në proceset e mësimdhënies dhe të mësuarit.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

**Mjetet ndërvepruese multimediale:** Mendoni për fushën lëndore në të cilën jepni mësim. Bëni një kërkim për të identifikuar dhe për të renditur një listë me mjete ndërvepruese multimediale, duke përfshirë edhe lojërat digjitale, të cilat mund të përdoren për një mësim të caktuar për një grup mësuesish. Ju duhet të identifikoni një numër mjetesh të tilla. Përzgjidhni më të rëndësishmet nga pikëpamja e dobishmërisë për nevojat tuaja të veçanta.

- ◆ Cilat janë kriteret që përdorët?

Bëni një kërkim për kriteret që përdorin ekspertët për përdorimin e mjeteve ndërvepruese të multimedias. Krahasoni kriteret tuaja me ato të ekspertëve.

- ◆ Cili është rezultati?
- ◆ A jeni dakord me kriteret e ekspertëve?

Në listën e mjeteve ndërvepruese të multimedias, a mund të identifikoni mjete që mund të ndryshojnë dhe të lehtësojnë

bashkëveprimin dhe diskutoni për procesin e të mësuarit dhe mësimdhënies? Përse i zgjedhët këto mjete? Sipas mendimit tuaj, si do të ndihmojnë teknologjitë multimediale nxënësit dhe mësuesit për të ndërvepruar me informacionin në mënyra të reja, të ndryshojnë përmbajtjen, të krijojnë njohuritë e tyre?

**Lojërat online.** Luaj ndonjë lojë humanitare si Paqebërësi, Forca e ushqimit etj. Si mundet që një lojë kompjuterike të ndihmojë të menduarit në mënyrë krijuese për çështjet globale? Cilat janë objektivat e të mësuarit nga këto lojëra? Nëse mundësia e përdorimit të internetit në institucionet arsimore është e kufizuar ose mungon fare, mësuesit duhet të nxiten të përdorin materiale nga burime të tjerë të internetit publik. Në vendet ku interneti është mjaft i kufizuar, mësuesi mund të përpiqet të sigurojë disa lojëra në formate të ndryshme CD-ROOM ose DVD ose të përdorë lojërat që ekzistojnë në programet e kompjuterit. Pjesëmarrësit në trajnim duhet të nxiten:

- ❖ Të ndërtojnë studime rasti të lojërave elektronike në lëndë të ndryshme dhe të pilotojnë përdorimin e një ose të dy lojërave në një kontekst të veçantë të mësuarit. Shkruani një raport për mënyrën e përdorimit të lojës dhe të ndihmës së saj për arritjen e objektivave të mësimit.
- ❖ Zhvilloni një situatë mësimore duke përdorur një lojë elektronike si pjesë e procesit të të mësuarit dhe të mësimdhënies për të rritur vetëdijen për çështje globale si: uria, konflikti, paqja etj. Zhvilloni këtë mësim dhe shkruani një raport të shkurtër për përgjigjet e mësuesve ndaj çështjeve në fjalë, duke vënë në dukje edhe pyetjet që ata shtrojnë dhe për mënyrën si lojërat ndihmuan në trajtimin e tyre.

**Burimet e hapura arsimore.** Këto janë materiale dhe mjete mësimore që përfshijnë kurse të plota, tekste, video, teste, programe kompjuterike dhe materiale të tjera (ndërvepruese ose jo ndërvepruese) ose teknika, të përdorura për të mbështetur

kontaktin me njohuritë, në një dokument të hapur, me licence të hapur, që u lejojnë përdoruesve përdorimin e tyre pa pagesë, ripërdorimin dhe përshtatjen e tyre ndaj nevojave të veçanta të grupeve të përdoruesve (nxënësit, trajnerët, lehtësuesit etj.) Të trajnuarit duhet të nxiten:

- ❖ Të identifikojnë disa faqe që sigurojnë hyrjen në burimet e hapura arsimore.
- ❖ Të identifikojnë kërkesat/kriteret për burimet arsimore që duhet të përdoren si burime të hapura.
- ❖ Të analizojnë si krijohen burimet e hapura arsimore, si shpërndahen dhe përshtaten ndaj nevojave të veçanta të mësimdhënies dhe të mjedisit të të mësuarit.
- ❖ Të analizojnë si mund të bëhen lojërat digjitale në kuadrin e burimeve të hapura dhe të kuptojnë çfarë duhet të bëhet për t'i përshtatur me kërkesat e tyre, duke përfshirë këtu edhe ligjet për të drejtat e autorit.

**Diskutimet në klasë:** Pjesëmarrësit duhet të identifikojnë, të analizojnë me sy kritik larminë e teknikave të përdorura në lojërat elektronike që ata njohin. Gjeni ndryshimet dhe ngjashmëritë me lojërat tradicionale ose kulturore për vlerat dhe kufizimet në fushën e edukimit. Të trajnuarit duhet të paraqesin përfundimet përmes prezantimeve PPP ose të përdorin një tabelë për këtë qëllim.

Pjesëmarrësit duhet të përgatisin një orë mësimore dhe të përzgjedhin veprimtaritë e mësimdhënies, duke përfshirë edhe mjete të thjeshta të ndërvepruese multimediale ose lojëra digjitale në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit. Ata duhet të shqyrtojnë përfitimet dhe kufizimet e integritit të lojërave digjitale në praktikat e mësimdhënies. Një grup duhet të paraqesë përfitimet, ndërsa grupi tjetër mangësitë dhe sfidat në përdorimin e lojërave digjitale në procesin e të mësuarit.

# MODULI 7

Mundësitë dhe sfida e internetit

## Hyrje

Pjesëmarrja në shoqërinë e informacionit është thelbësore për qytetarët e të gjitha grupmoshave. Interneti ofron mundësi të mëdha për të përmirësuar jetën e të gjithë përdoruesve. Ai ka ndikim pozitiv në arsim, në botën e punës dhe për rritjen ekonomike. Me digjitalizimin e kollajtë dhe ruajtjen e informacionit dhe me lehtësinë e sigurimit të tij përmes pajisjeve të larmishme, interneti ka rritur pamasë edhe burimet e informimit që janë vënë në shërbim të njerëzve. Fëmijët dhe të rinjtë, në përgjithësi, i njohin mirë zbatimet e tij dhe mund të përfitojnë shumë nga përdorimi i tij, por në të njëjtën kohë ata janë shumë të prekshëm nga rreziqet. Rreziqet dhe kërcënimet e shoqërojnë këtë zhvillim dhe shpesh herë paralelizojnë edhe rreziqet që janë të pranishme në botën fizike.

Marrja e masave për të mbrojtur fëmijët mund të ndihmojë në përbalimin e këtij problemi. Por sado ndihmëse mund të jenë këto masa, mbështetja plotësisht në strategjitë mbrojtëse nuk ka qenë e efektshme në aftësimin e të rinjve për të përdorur internetin në mënyrë të përgjegjshme. Mënyra më e mirë për t'i ndihmuar ata të qëndrojnë jashtë rrugëve të dëmshme është *t'i edukojmë dhe t'i aftësojmë ata të shmangin ose të menaxhojnë rreziqet që shoqërojnë përdorimin e internetit*. Teknologjitë mund të luajnë rol të dobishëm dhe mbështetës në këtë fushë, veçanërisht atje ku janë edhe interesat e fëmijëve dhe të rinjve.

# Tema 1:

## Të rinjtë në botën virtuale



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Ueb 2.0 dhe bota virtuale
- Përdorimi i internetit dhe zakonet online të fëmijëve dhe të rinjve
- Konventat ndërkombëtare dhe instrumentet e tjerë që lidhen me të drejta e fëmijës

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të identifikojnë dhe të përshkruajnë modelet dhe interesat e përdorimit të internetit nga njerëzit .
- Të përshkruajnë konceptet dhe kushtet, kodet e sjelljes dhe rregullat e privatësisë që lidhen me përdorimin e internetit.
- Të përdorin metodat dhe mjetet bazë mësimore për të ndihmuar të rinjtë të përdorin internetin në mënyrë të përgjegjshme dhe t'i bëjnë ata të vetëdijshëm për mundësitë, sfidat dhe rreziqet.



## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Ueb 2 është shkurtim që përdoret për aspektet e internetit që lehtësojnë ndërveprimin dhe përmbajtjen e gjeneruar nga përdoruesi (si p.sh. aplikacionet në telefonin celular).

Kjo njësi kërkon përdorimin e burimeve që mund të gjenden online si videot pa të drejta autori për internetin dhe zgjerimin e tipareve dhe të ndikimit të tij në shoqëri. Ose, ju mund të përgatisni një prezantim të shkurtër në PPP për Ueb 2. Ai duhet të përfshijë sa më shumë elemente kyç të botës virtuale. Organizoni diskutime në grupe të vogla për këto elemente kyç. Kërkojini çdo grupi të përgatisë dhe të ndajë një prezantim të shkurtër për përfitimet nga Ueb 2.

- ◆ Pyetni mësuesit nëse janë pjesë e ndonjë rrjeti social dhe/ose përdorin ueb dhe nëse po, sa shpesh e përdorin atë. Kërkojuni atyre të kërkojnë në ueb, të kërkojnë profilet e të tjerëve, të ngarkojnë ose të shkarkojnë përmbajtje nga platformat e internetit (p.sh. Wikipedia) dhe të marrin pjesë në dhomën e bisedave (chat room), bashkëpunime online, në blogje personale dhe twitter. Pas kësaj veprimtarie, diskutoni me pjesëmarrësit për përfitimet edukative dhe përgjegjësinë e përdorimit të ueb dhe të sfidave dhe rreziqeve që e shoqërojnë atë. Shkruani dhe diskutoni për disa prej shqetësimeve tuaja vetjake që lindin gjatë kohës që jeni online.
- ◆ Pjesëmarrësit, në grupe ideojnë dhe përdorin një faqe ueb të dhënash për të shkëmbyer informacion në lidhje me një aspekt të praktikës ose të politikës arsimore. Kjo detyrë kërkon kohë. Trajneri dhe pjesëmarrësit duhet të zhvillojnë kritere për vlerësimin e efektshmërisë së faqes së të dhënave (Wiki), vlerën e saj dhe ndikimin tek të trajnuarit.
- ◆ Kërkoni nga mësuesit të organizohen në grupe të vogla. Çdo grup duhet të diskutojë dhe të rendisë të paktën pesë veprimtari kryesore në të cilat, sipas tyre, përfshihen fëmijët në internet. Kërkojuni atyre të rendisin këto veprimtari për nga rëndësia e tyre duke përdorur një shkallë

vlerësimi nga 1-5. Çdo grup duhet të paraqesë rezultatet e diskutimeve të tyre, të shpjegojnë si u organizuan dhe ku u bazua vendimi i tyre. Trajneri duhet të paraqesë statistikat aktuale (të përgatitura përpara kësaj veprimtarie dhe të bazuar në burimet ekzistuese - nëse këto dhëna ekzistojnë) në lidhje me përdorimin e internetit nga fëmijët. Krahasoni rezultatet e punës në grup me ato që thonë statistikat. Diskutoni;

- ◆ A janë këto rezultate të papritura për ju?
- ◆ A ekzistojnë të dhëna për përdorimin e internetit, që janë të veçanta për vendin tuaj?
- ◆ Nëse jo, cilat janë disa nga pasojat. Diskutoni për çfarë mund të bëhet në kushtet e mungesës së informacionit ose të statistikave në këtë fushë.
- ◆ Diskutoni sa të rinjtë përdorin uebet për qëllime mësimore, për lajmet, për pjesëmarrjen e tyre në proceset politike të vendit, për të mësuar më shumë për ndërveprimin me njerëzit e tjerë nga kultura të ndryshme.
  - A janë këto shenja të nivelit të lartë të përdorimit të ueb?
  - Çfarë mund të bëhet për të motivuar të rinjtë për të përdorur ueb në mënyrë pozitive.?

Kërkoni nga mësuesit të përgatitin, në grupe të vogla ose individualisht, një mësim të shkurtër që lidhet me lëndën e tyre, duke integruar përdorimin e internetit në mësim. Mësimi duhet të tregojë jo vetëm si mund të realizohen objektivat përmes përdorimit të internetit, por edhe se si mësuesi mund të motivojë nxënësit në këtë mënyrë.

- ◆ Diskutoni me mësuesit termat dhe kushtet, kodet e sjelljes dhe rregullat e privatësisë në aplikacionet e ndryshme në internet. Nxitini ata të zhvillojnë një model kodi të sjelljes, duke u përqendruar në përdorimin e internetit nga fëmijët dhe të rinjtë.

- ◆ Analizoni sjelljen e fëmijëve online dhe profilet e tyre. Pjesëmarrësit në trajnim, duke punuar në grupe, të hetojnë përdorimin e internetit nga fëmijët e moshës 6-17 vjeç. Raportimet e grupeve duhet të hedhin dritë mbi shkallën dhe qëllimin e përdorimit të internetit nga fëmijët dhe krahasojeni atë me njohuritë e prindërve dhe përdorimin e internetit prej tyre. Cilat janë mundësitë dhe sfidat që paraqet interneti për fëmijët dhe prindërit?
- ◆ Organizoni një diskutim në lidhje me një nen të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, në Konventën për të Drejtat e Fëmijës ose në instrumente të tjerë ligjorë në vendin tuaj që lidhet me përdorimin e internetit dhe të rinjtë – të drejtën për informim, për lirinë e shprehjes, të mbrojtjes së pakicave dhe për rolin e prindërve, të qeverisë dhe të shoqërisë civile. Reflektoni për këto çështje individualisht dhe më pas shqyrtoni si lidhen ndërmjet tyre.
  - A është liria e shprehjes dhe e drejta për informim në konflikt me mbrojtjen?
  - A janë ato njëlluj të nevojshme?
  - A duhet të sakrifkohet liria e shprehjes dhe e drejta për informim në emër të mbrojtjes? Pse po? Pse jo?
  - A duhet vajzat dhe të djemtë të kenë të drejta të barabartë për informim, internet dhe teknologji? Çfarë ndodh në vendin tuaj në lidhje me këto çështje?
  - Si mund të trajtohen këto?

Kërkoni nga mësuesit të përgatisin një poemë të shkurtër për disa liri dhe të drejta dhe për nevojën e mbrojtjes së fëmijëve.

## Tema 2:

# Sfidat dhe rreziqet në botën virtuale



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Kuptimi i sfidave dhe i rreziqeve të përdorimit të internetit
- Fuqizimi dhe përdorimi i përgjegjshëm i internetit
- Privatësia dhe siguria

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të renditin dhe të përshkruajnë sfidat/rreziqet e përdorimit të internetit dhe ku mund të ndeshen ato.
- Të shpjegojnë rreziqet dhe kërcënimet që mund të shoqërojnë aplikacionet e reja të internetit.
- Të shpjegojnë ndërvarësinë ndërmjet sjelljes së përdoruesve dhe mundësisë së tyre për të qenë viktime ose shkelës.
- Të zbatojnë njohuritë për t'u bërë mësuesit përdorues më të përgjegjshëm të internetit.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

### A. Sfidat dhe rreziqet që lidhen me përmbajtjen online

**Përmbajtja e papërshtatshme për moshën:** Interneti siguron një përmbajtje të pasur për të gjitha grupet e përdoruesve, pra që plotësojnë si interesat më të përgjithshme ashtu edhe ato të grupeve të veçanta. Megjithatë, jo e gjithë përmbajtja duhet të jetë lehtësisht e arritshme nga fëmijët dhe të rinjtë. Kjo kërkon vendimmarrje të kujdesshme në lidhje me përcaktimin e përmbajtjes së përshtatshme për çdo grup moshë. Vëmendje të veçantë i duhet kushtuar përmbajtjes që është e ligjshme në përgjithësi por që, në mënyrë të veçantë, mund të dëmtojë përdoruesit më të rinj.

Përmbajtja e papërshtatshme për moshën, si ajo e pornografisë për të rritur, mund të dëmtojë fëmijët që ndeshen me të në mënyrë të paqëllimshme. Rreziku i përballjes me përmbajtje të papërshtatshme për moshën, mund të jetë edhe rezultat i sjelljes së vetë përdoruesit, i cili e kërkon vetë atë ose kur ndeshet me të rastësisht. Përmbajtja e papërshtatshme për të gjithë grup moshat mund të ofrohet për arsye reklamash, por mund të krijohet edhe nga ato vetë. Sigurimi i të parës mund të kufizohet vetëm për grupe të veçanta përdoruesish, ndërkohë që përmbajtja që ka pikënisje vetë përdoruesin është lehtësisht e gjindshme dhe për këtë arsye ka nevojë për vëmendje të veçantë. Sot, shumë fëmijë e të rinj kanë telefona celularë me funksione të larmishme në shumë formate të medias sikurse edhe përdorim të pakufizuar të internetit. Për këtë arsye, ata lehtësisht mund të kërkojnë dhe të gjejnë përmbajtje të papërshtatshme për moshën, pa qenë nën mbikëqyrjen ose kujdesin e një të rrituri pranë tyre. Celularët i aftësojnë fëmijët të prodhojnë edhe përmbajtje origjinale vetë për çdo situatë jete, duke rritur në këtë mënyrë edhe përmbajtjen që ka pikënisje përdoruesin.

**Përmbajtja e paligjshme (racizmi dhe pornografia për të mitur):** Përmbajtja që klasifikohet e paligjshme varet kryesisht nga ligjet kombëtare, megjithëse disa lloje përmbajtjesh gjykojnë të paligjshme në pjesën më të madhe të vendeve. Megjithatë, përmbajtja e paligjshme është e pranishme dhe mund të

gjendet në mënyrë të paqëllimshme ose të vullnetshme nga të rinjtë dhe fëmijët. Vëmendje i duhet kushtuar fëmijëve dhe të rinjve si viktimë të mundshme të përmbajtjes së paligjshme, për shembull, përmes bërjes dhe publikimit të fotove ose të videove që përbëjnë abuzim me fëmijët.

**Mungesa e verifikimit të përmbajtjes.** Duke u nisur nga fakti që përmbajtja që gjendet në internet shpesh herë është e pa kontrolluar dhe e pa verifikuar nga një burim i pavarur është e rëndësishme që të rinjtë të mësojnë të lexojnë përmbajtjen me sy kritik dhe jo të marrin si të mirëqenë çdo gjë që thuhet. Përmbajtja e krijuar nga përdoruesi, karakteristikë e Ueb 2, shpesh herë mund të jetë e njëanshme ose e pasaktë. Përdoruesit e rinj duhet të jenë të vetëdijshëm për rreziqet që sjell besimi i menjëhershëm i gjithçkaje që lexojnë online.

**Nxitja i dëmit:** Në ueb ekzistojnë shumë faqe që nxisin përdoruesit të dëmtojnë veten (faqe që nxisin vetëvrasjen, anoreksinë ose sektarizmin). Me Ueb 2 dhe me rritjen e mundësive për të publikuar përmbajtje nga vetë përdoruesi, është në rritje edhe rreziku i ndeshjes me përmbajtje që nxisin dëmtime. Në mënyrë të veçantë, fëmijët dhe të rinjtë, në shumë raste, nuk janë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë realiste rrezikun që shoqëron ndjekjen e udhëzimeve të dhëna nga këto faqe interneti.

**Shkelja e të drejtave të njeriut/shpifja:** Në kushtet e anonimitetit në ueb, propaganda kundër disa grupeve të popullsisë ose individëve të caktuar mund të përhapet me lehtësi. Dikush mund të hamendësojë që njerëzit veprojnë në mënyra të ndryshme online, kur ata nuk duhet të përballen me dikë tjetër ose me viktimat në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe, për këtë arsye, ata nuk përballen menjëherë e drejtpërdrejtë edhe me pasojat e sjelljes së tyre. Kështu, rreziku i shkeljes së të drejtave të njeriut dhe i të qenit viktimë e shpifjes është më i madh online se në realitet. Po kështu, përmbajtja shpifëse është e dëmshme për fëmijët dhe të rinjtë, sepse opinioni i tyre mund të ndikohet nga informacione keqinformuese.

**Reklamat e papërshtatshme dhe marketingu të fëmijët:** Reklama e papërshtatshme nënkupton rrezikun e marrjes së reklamave ose të ekspozimit ndaj reklamave për produkte ose

shërbime që janë të papërshtatshme për fëmijët, si për shembull, kirurgjia kozmetike. Sa më shumë informacion që përdoruesit japin për veten (emër, moshë ose gjini) aq më e madhe është mundësia për të marrë reklama dhe kërkesa për të marrë pjesë në lotari. Meqë, në shumë raste, fëmijët nuk janë të vetëdijshëm për pasojat që shoqërojnë çastin kur shtypin emrin e tyre në format ose kutitë e ueb-it, ata janë thellësisht të rrezikuar. Duke marrë parasysh, shkallën e lartë të përdorimit të celularëve nga fëmijët dhe të rinjtë, i duhet kushtuar vëmendje kanaleve shtesë për përhapjen e reklamave.

**Privatësia:** Pasi publikohet në ueb, përmbajtja mund të përhapet me shpejtësi nëpër botë dhe të qëndrojë aty pafundësisht. Përdoruesit, veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë, nuk janë të vetëdijshëm për pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të publikimit të teksteve dhe fotove për të cilat më vonë do të pendohen. Të dhënat e ruajtura në një server ose platformë mund të gjenden lehtë nga të tjerë dhe nga njerëzit mund të mos e dinë sa të pambrojtura janë të dhënat e tyre vetjake. Për këtë arsye, është e rëndësishme të mbahet parasysh, që kur të përdorin internetin, njerëzit të kuptojnë plotësisht mjedisin në të cilin po punojnë

**Shkelja e të drejtës së autorit:** Shkelja e kësaj të drejte është një prej rreziqeve që lidhet kryesisht me sjelljen e vetë përdoruesve. Pavarësisht nëse e drejta e autorit është shkelur me dashje ose aksidentalisht, shkelja shihet si mashtrim nga mbajtësi i saj dhe kjo e vë shkelësin përballë përgjegjësisë ligjore.

## B. Rreziqet që lidhen me kontaktet online

**Këshillat e dëmshme:** Forumet, blogjet dhe fushat e tjera që lidhen me kontaktet e internetit ofrojnë një platformë për shkëmbimin e informacionit dhe të këshillave ndërmjet përdoruesve. Kjo mund të jetë ndihmë e vlefshme, por në të njëjtën kohë mund të lehtësojë kontaktet me këshilltarë të papërshtatshëm, madje edhe të dëmshëm. Rreziku i marrjes së këshillave të dëmshme, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë, është më i madh në platformat sociale të komunitetit ose në aplikacionet e Ueb 2 sesa në faqet e tjera.

**Vjedhja e identitetit:** Marrja dhe përdorimi i identitetit elektronik të njerëzve të tjerë (emri përdoruesit dhe passwordi) për qëllime të kryerjes së mashtrimeve tregtare ose i mashtrimeve të tjera për qëllime përfitimi quhet vjedhje identiteti. Vjedhja e identitetit është një rrezik në rritje, si rrjedhojë e rritjes së numrit të identiteteve virtuale që shoqëron numrin në rritje të njerëzve online dhe, veçanërisht, të atyre që përdorin shërbime të personalizuar.

**Vjedhja e parave/të dhënave bankare:** Vjedhja e të dhënave bankare është procesi i mbledhjes së detajeve bankare, veçanërisht të Numrave Personale të Identifikimit (PIN) dhe i Numrave të Verifikimit të Transaksioneve (TAN) me qëllim që të zbrazin llogaritë bankare të njerëzve.

**Mashtrimi tregtar:** Mashtrimi tregtar ndodh kur shitësi pretendon të shesë mallra dhe shërbime, të cilat pas pagesës, ose nuk tregojnë cilësitë e premtuara ose nuk shkojnë fare të blerësi. Ky mund të jetë edhe rezultat i vjedhjes së identitetit ose i të dhënave bankare. Një burim tjetër i mashtrimit tregtar mund të jetë shitja e të shërbimeve digjitale (p.sh. e një melodie për celularin) me çmime të paarsyeshme dhe të pandershme, që lidhet, shpesh, me një nënshkrim në një shërbim për të cilin blerësi nuk ka pasur asnjë qëllim. Në më të shumtën e rasteve përdoruesit (veçanërisht fëmijët dhe të rinjtë) nuk janë të vetëdijshëm për pasojat e kontratave të tilla online.

**Grooming (strategjitë e joshjes):** Kjo fjalë ka shumë sinonime. Megjithatë, këtu ajo lidhet me pedofilët që përdorin internetin si mjet për të kontaktuar fëmijët dhe të rinjtë duke fshehur identitetin e tyre si të rritur. Shpesh here ata ndërtojnë strategji për t'i bërë fëmijët të kërkojnë miqësi ose familjaritet. Të gjitha fushat e internetit që ofrojnë platforma për kontakte dhe shkëmbime personale ka mundësi të ofrojnë edhe bazat për sulmet për të joshur fëmijët (grooming). Siç e kemi përmendur më parë, telefonat celularë (si pajisje shtesë për të kontaktuar të tjerët dhe për të përdorur rrjetet sociale) duhet të merren shumë seriozisht, sidomos në kushtet kur fëmijët i shohin ato si pjesë të veçantë të jetës së tyre private dhe që, për këtë arsye, në pjesën më të madhe, përdoren prej tyre në kushte privatësie. Pra, me rritjen e teknologjive të komunikimit me anë të celularëve dhe të



rrjeteve sociale, është bërë shumë herë më i madh edhe rreziku i rënies pre ndaj strategjive e sulmeve joshëse dhe i pranimit të ftesave të rrezikshme.

**Bullizmi:** Bullizmi ka qenë gjithmonë pjesë e jetës së njerëzve. Interneti e ka bërë më të thjeshtë bullizmin për shkak të anonimitetit që siguron kjo lloj medie. Fëmijët dhe të rinjtë në rrezik të veçantë janë njëherazi viktimat dhe dhunues. Bullizmi lidhet sa me sjelljen e njerit, po aq edhe me sjelljen e të tjerëve. Megjithatë publikimi i përmbajtjeve si fotot fyese përbën veprim bullizmi, kjo dukuri kryesisht lidhet me kontaktet online.

**Publikimi i informacioneve personale:** Kur ndërtojnë profilin në një platformë sociale të komunitetit, përdoruesit ftohen të zbulojnë informacionin e tyre personal tek komuniteti. Edhe në dhomat e bisedave (chat rooms) dhe në forume përdoruesit mund të zbulojnë të dhënat e tyre personale tek të tjerët, si adresën e banimit ose numrin e telefonit. Të rinjtë, në mënyrë të veçantë, nuk janë në gjendje të parashikojnë pasojat e publikimeve të të dhënave të tyre private. Ata nuk e dinë që edhe një “dhomë bisedimi” (chat room) është një mjedis publik.

**Ndërtimi i profilit:** Me rritjen e numrit të profileve që një person mund të vendosë në platforma të ndryshme rritet dhe rreziku që të dhënat e tyre personale të publikuara në një platformë të shkrihen me të dhënat e publikuara në platformat e tjera ose t’u jepen dikujt tjetër. Në këtë mënyrë, krijohen profile që të bëjnë të mundur t’i drejtohesh një personi me një përmbajtje, shërbim ose reklamë të padëshiruar. Profilet mund të nxirren nga faqja kur janë publikuar të dhënat personale, por praktika më e rrezikshme është kur profilet e përdoruesve (ose një pjesë e tij) merren nga baza e të dhënave të faqes dhe u shiten ofruesit të platformave në palë të treta.

- ◆ Është e rëndësishme të dimë çfarë kuptohet me përmbajtje online të dëmshme. Ligjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut përcaktojnë një numër të pranueshëm kufizimesh të lirisë së shprehjes, veçanërisht kur liria e fjalës hyn në konflikt me të drejtat e tjera. Në shembujt e çështjeve që mund të kufizohen përfshihen ato që lidhen me nxitjen e dhunës, të urrejtjes raciale, të fotove të fëmijëve për qëllime

seksi dhe të shpifjeve. Në çdo rast, ligjet ndërkombëtare sqarojnë që kufizimet duhet të jenë të formuluar me kujdes dhe të mbikëqyrura nga gjykatat.

- Kërkojuni mësuesve të ndajnë me njëri-tjetrin përvoja të tyre ose të miqve të tyre në lidhje me sfidat e përmendura më sipër. Si u përballën me to? Cili ishte rezultati përfundimtar? Cilat qenë mësimet që mësuan?

- ◆ Shqyrtoni vjedhjen e identitetit, vjedhjet monetare ose të të dhënave bankare, shkeljen e të drejtave të njeriut, shpifjen ose ndonjë abuzim tjetër në internet. Përdorni kërkimin ose burimet që ofrohen në kurrikulën e EMI për mësuesit për të identifikuar dhe për të renditur hapat që duhet të ndërmerren dhe karakteristikat e sakta për të cilat duhet të kërkojnë mësuesit për të dalluar kërkesat mashtruese në informacionin online, faktet mashtruese dhe përmbajtjet që shkelin të drejtat e njeriut, cilat janë disa prej përfitimeve nga veprimet bankare dhe tregtare elektronike. Burimet e përdorura për këtë veprimtari duhet të jenë praktike dhe të paraqesin raste reale. Mësuesit duhet të kryejnë këtë veprimtari për të gjitha rreziqet e renditura më sipër.
- ◆ Bëni një kërkim online për bollëkun e informacionit mjekësor (ose të kategorive të tjera) që gjenden në internet. A mund që faqet mjekësore t'ju ndihmojnë të diagnostikoni problemet shëndetësore që keni? A është e sigurt të ndërmerrni veprime për shëndetin tuaj, duke u bazuar në këshillën e internetit? Rendisni dhe diskutoni për rrugët kryesore për të përcaktuar vërtetësinë dhe autoritetin e faqeje mjekësore.
- ◆ Nëse jeni pjesë e një rrjeti social, bëni një kërkim në Google për emrin tuaj. Sa informacion për ju mund të gjendet në fushën publike? A mund të gjeni informacion për veten të cilin e keni fshirë nga rrjeti social? Cili prej rreziqeve të përmendura më sipër lidhet me këtë?
- ◆ Shkëpusni një pjesë nga Deklarata e Facebook për të Drejtat dhe Përgjegjësitë, neni 27: Ndarja e përmbajtjes dhe informacionit tuaj (ose nga rrjete të tjera sociale,

madje edhe nga programet që vijnë së bashku me kompjuterin tuaj). Në grupe të vogla, analizoni nëse pjesa e shkëputur mund të ketë ndikim në privatësinë ose sigurinë e mundshme të dikujt. Si mund të kontrollojnë përdoruesit përmbajtjen e publikuar për ta online? Analizoni dhe diskutoni bartësit e të drejtës së autorit për disa lloje përmbajtjesh (foto, video etj.) të publikuar në rrjete sociale ose në ueb.

- ◆ Shqyrtoni Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Ajo përcakton të drejtat bazë të njeriut të cilat fëmijët duhet t'i kenë kudo: e drejta e mbijetesës; e drejta për t'u zhvilluar plotësisht; e drejta për t'u mbrojtur nga ndikimet e dëmshme, abuzimet dhe shfrytëzimi; e drejta për të marrë pjesë tërësisht në jetën familjare, kulturore dhe sociale. A ekzistojnë nene të Konventës që kërkojnë zhvillimin e udhëzimeve të përshtatshme për mbrojtjen e fëmijës nga informacione dhe materiale që mund të dëmtojnë mirëqenien e tij?
- ◆ Sipas Raportit 10 të vëzhgimit teknologjik të Bashkimit të Telekomunikacionit Ndërkombëtar, veprimet për të trajtuar shqetësimet që lidhen me privatësinë dhe sigurinë përbëjnë përparësinë absolute për të përmirësuar jetën në botën digjitale dhe në internet. Mungesa e një sigurie të fortë, në mënyrë të pashmangshme paraqet rrezik për të gjitha sistemet dhe proceset që mbështeten në komunikimin elektronik, duke përfshirë edhe median. Siguria e munguar ose e dobët çon në rritjen e rasteve të krimit kibernetik. Ky rrezik është aq serioz sa që ka nxitur krijimin e Partneritetit Shumëpalësh Kundër Rreziqeve Kibernetike, për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar për rritjen e sigurisë së hapësirës kibernetike. Dr. Hamadoun Toure thotë “Përdorimi i komunikimit nuk ka vlerë nëse nuk garantohej paqja dhe siguria online” dhe shton që ne duhet të shohim botën digjitale si një rezidencë komunitare të kontrolluar, ku përdoruesit *mund të sakrifikojnë disa liri dhe privatësi për më shumë siguri*”.

Megjithatë, shumë aktivistë për lirinë në internet, janë të shqetësuar për ndërhyrjen dhe kontrollin e qeverisë. Po

rritet shqetësimi që interneti, në vend të një hapësirë e hapur e interesit publik, po bëhet një hapësirë e mbyllur e kontrolluar që po sundohet gjithnjë e më shumë nga qeveritë dhe korporatat. Mund të ndodhë që, për disa qeveri dhe biznes, siguria të jenë shqetësimi më i madh, ndërkohë që ky nuk përbën shqetësim për shumë qytetarë.

- Diskutoni pohimin e mësipërm të bërë nga Dr. Toure. A mendoni se qeveritë duhet të marrin masa për ta bërë më të sigurt botën virtuale. Përse po, përse jo?

◆ A mendoni që privatësia mund të sakrifikohet deri në një farë mase? Cilat janë disa nga pasojat? Përse mendoni që nuk është e mundur ose e pëlqyeshme? Kërkoni të rregullohet edhe interneti si TV dhe radio? Çfarë mund të ndodhë nëse interneti do të kontrollohet nga një vend i vetëm ose rajon?

- Bëni një kërkim të shkurtër për disa tipa mjete që përdoren për sigurinë në internet, duke bllokuar, filtruar, kontrolluar ligjërisht etj. Diskutoni për përfitimet dhe kufizimet e tyre

◆ Zgjidhni një faqe të një rrjeti social ose programi që përdorni. Eksperimentoni me një mjedis privatësie. Kërkoni termat privatësi dhe siguri në “kushtet e përdorimit”. A mendoni që ruajtja e privatësisë është e mjaftueshme për të ndihmuar në shmangien e rreziqeve të përshkruar më sipër (Shiko rreziqet që lidhen me përmbajtjen e internetit dhe kontaktet)? Cilat janë disa nga pasojat kur vendosni privatësinë si përparësinë tuaj më të lartë?



# MODULI 8

Edukimi për informimin  
dhe aftësimi për bibliotekat

## Hyrje

Mësuesit janë njohur me bazat e EMI në modulën 1 dhe në njësitë në vijim. Qëllimi i këtij moduli është të tregojë që edhe aftësitë e tjera të informimit janë elemente thelbësore të EMI.

Moduli thekson ndërtimin e blloqeve që kontribuojnë në EMI. Shumë prej kurseve përqendrohen më shumë në përhapjen e njohurive sesa në të mësuarit për të mësuar.

Megjithatë, rritja e vëmendjes në vlerën e EMI në arsim dhe më gjerë në shoqëri hedh dritë në rëndësinë e edukimit të përdoruesve. Kjo nënkupton:

- të dallosh nevojat për informim
- të gjesh dhe të marrësh informacion në mënyrë të efektshme
- të analizosh, të organizosh dhe të vlerësosh këtë informacion për vendimmarrje të veçanta dhe për zgjidhjen e problemeve.

Mësuesit, fillimisht vetë dhe më pas për nxënësit, duhet të fitojnë një grupim kompetencash (njohuri, aftësi dhe qëndrime) për të marrë, për të kuptuar, për të përshtatur, për të krijuar, për të ruajtur dhe për të paraqitur informacion për të analizuar problemet dhe për të marrë vendimet. Këto janë kompetenca që zbatohen në çdo kontekst të të mësuarit dhe të mësimdhënies, qofshin këto në mjedise arsimore, mjedise të përgjithshme pune ose profesioni ose për zhvillim personal. Një mësues i EMI është i aftë të kuptojë mesazhet e informacionit dhe të medias nga burime të ndryshme informimi dhe është i aftë të vlerësojë dhe të përdorë të kuptuarit e tij në mënyrë të përshtatshme për të zgjidhur probleme. Ai ka fituar aftësitë e kërkuara për të punuar me bibliotekën dhe është i aftë të rritë përdorimin e burimeve

dokumentare për të mësuar dhe për të shkëmbyer informacion. Mësuesi i arsimuar në fushën e medias dhe të informimit është në gjendje të vlerësojë funksionet e medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit në shoqëri.

Ofruesit e informacionit kryejnë shërbim të rëndësishëm që njerëzit të kenë mundësi të marrin dhe të përdorin informacion dhe në disa raste të ruajnë informacionin e tyre. Njerëzit, përveç medias, përdorin edhe burime të tjera informacioni (lajmërimet shëndetësore, raporte të qeverisë dhe të tjera informacione të ofruara gojarisht, si ato përmes debateve publike ose informale). Këto informacione mund jepen në mënyrë elektronike (debate në TV) ose në seanca të ndryshme ku njerëzit takohen ballë për ballë. Të gjitha këto mund të ndërmjetësohen nga media ose nga njerëzit. Në thelb, EMI përfshin aftësi për të përdorur bibliotekën, për të studiuar, për të kërkuar dhe aftësi teknologjike.

Ky modul përqendrohet në zhvillimin e të kuptuarit dhe aftësimin për EMI-n, bibliotekat dhe shërbimet digjitale për të zgjidhur problemet dhe për të marrë vendime në kontekstin arsimor. Ai synon të aftësojë mësuesit të kuptojnë konceptin e informimit, të edukimit për informim dhe teknologjinë digjitale si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre me qëllim përmirësimin e aftësive për të përdorur burimet e ndryshme të informacionit që ekzistojnë në botën e sotme. Fitimi i këtyre aftësive do t'u krijojë mësuesve shanse për të mësuarit gjatë gjithë jetës, përmes përdorimit të informacionit që u siguron atyre pjesëmarrje të vazhdueshme në një jetë aktive intelektuale.



# Tema 1:

## Koncepti i edukimit për informim dhe zbatimi i tij



Kohëzgjatja **2 orë**

### Çështjet kryesore

- Njohja me informimin dhe edukimin për informim
- Konceptet kryesore të edukimit për informim
- Ndikimi i informacionit në shoqëritë e sotme dhe aftësitë e reja
- Standardet dhe zbatimi i tyre në edukimin për informim
- Fazat e edukimit për informim

### Objektivat e të mësuarit

Në përfundim të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë rolin dhe rëndësinë e informimit dhe nevojën për edukimin për informim, aftësitë në fushën e shoqërive të dijes dhe të informimit.
- Të demonstrojnë të kuptuarit e fazave / të elementeve kryesorë të edukimit për informim që zbatohen në të gjitha fushat.
- Të identifikojnë dhe të eksplorojnë burimet e përgjithshme të informimit (të shtypura dhe elektronike).
- Të analizojnë standardet e edukimit për informim.

- Të identifikojnë dhe të diskutojnë përdorimet etike dhe të përgjegjshme të mjeteve dhe burimeve të informimit.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Termi *“informim”, “informacion” “edukim për informim”, TIK dhe “aftësi kyç”* për shekullin XXI, po përdoren gjerësisht në diskutimet e sotme në lidhje me shoqërinë e informacionit dhe të dijes. Qytetarët kërkojnë kompetenca të reja (njohuri, aftësi, qëndrime) për të marrë pjesë dhe të kontribuojnë në shoqëri. Të kuptuarit dhe qartësimi i këtyre termave është i nevojshëm përpara përfshirjes në trajnim.

## Ç’është informacioni?

Diskutoni përkufizimet e mëposhtme:

- ◆ “Informacioni është e dhëna që është marrë, është përpunuar, është interpretuar dhe është paraqitur në një formë të përdorshme”.
- ◆ “Informacioni është “ai që na ndryshon ne” (Stafford Beer, 1979).
- ◆ “Informacioni është ai që arrin të hyjë në vetëdijen e njeriut dhe të kontribuojë në njohuritë e tij” (Blokdijk & Blokdijk, 1987).
- ◆ Informacioni nënkupton të dhëna që janë përpunuar në një formë të caktuar, kuptimplotë për marrësin dhe është një vlerë e vërtetë ose e perceptuar si e tillë në kuadrin e një veprimi ose vendimi (Davis & Olsen 1984).

## Reflektoni

- Cila është e përbashkëta në përcaktimet e mësipërme?
- A mendoni se ato janë të rëndësishme në shekullin kur jetojmë?

Kërkoni përkufizime të tjera.

A mund të gjeni përcaktime që ofrojnë një përshkrim më të gjerë të informacionit?

## Përcaktimi i Edukimit për Informim

### Përcaktoni termin “edukim për informim”:

- Edukimi për informim është një e drejtë themelore e njeriut në botën digjitale (Deklarata e Aleksandrisë 2005).
- Edukimi për informim nënkupton një grupim kompetencash që janë të nevojshme për të identifikuar, për të vlerësuar dhe për të përdorur informacionin në mënyrën më cilësore, më të efektshme e më etike në të gjitha fushat, profesionet dhe punët.
- Edukimi për informim i aftëson njerëzit për të përdorur cilësisht teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit.

### Përcaktoni “të menduarit kritik”.

Diskutoni për rolin e analizës, të sintezës dhe të vlerësimit të informacionit në të menduarit kritik. Paraqisni një studim rasti kuptimplotë dhe të vlefshëm në kontekstin e jetës së përditshme të nxënësve tuaj.

Fazat/elementet e edukimit për informim përfshijnë:

- Identifikimi/njohja e nevojave për informim.
- Përcaktimi i burimeve të informimit.

- Vendndodhja ose kërkimi për informacion.
- Analiza dhe vlerësimi i cilësisë së informacionit.
- Organizimi, ruajtja ose arkivimi i informacionit.
- Përdorimi i informacionit në mënyrë cilësore, të efektshme dhe etike.
- Krijimi dhe komunikim i njohurive të reja.

Diskutoni, në përgjithësi, fazat/elementet e edukimit për informim. Mësuesit duhet të përgatisin një listë verifikimi të aftësive kyçe të nevojshme për secilën fazë/element të procesit të edukimit për informim;

- Si do të zbatohet kjo në kontekste të ndryshme të zgjidhjes së problemeve?
- Si do të identifikoni dhe të përcaktoni me saktësi nevojat për informacion për të zgjidhur një problem ose për të marrë një vendim (p.sh. një këshillë financiare për të trajtuar një problem financiar)?

Burimet e informacionit mund të kategorizohen në tre grupime të mëdha: burime të para, të dyta dhe të treta. Përshkruani këto burime të informacionit tek mësuesit dhe udhëzoni ata të japin shembuj të burimeve të tilla.

## Shoqëria e informacionit dhe e dijes

Mënyra si funksionon bota e sotme ka ndryshuar pa masë. E shtyrë nga rritja e shpejtë teknologjike, informacioni dhe dija janë bërë motori i jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore dhe, për këtë arsye, flasim sot për të ashtuquajturën *shoqëri të informacionit dhe të dijes*.

- Kryeni një kërkim në bibliotekë ose në internet në lidhje me termin “shoqëri e informacionit”. Përshkruani konceptin që qëndron në themel të shoqërisë së informacionit. Diskutoni rëndësinë e këtij konceptimi për jetën dhe të mësuarit në kohën e sotme. Kryeni një detyrë të ngjashme

për termin “Shoqëri i dijes”. Cilat janë ngjashmëritë që vini re në përmbajtjen e këtyre termave (nëse arrini t’i dalloni)?

- Kërkoni nga mësuesit, që duke u bazuar në njohuritë e tyre, të shkruajnë çfarë ata mendojnë se përfshihet në edukimin për informimin, duke përfshirë këtu edhe aftësitë për bibliotekat. Ata duhet të rendisin pesë arsye përse këto aftësi i vlerësojnë të rëndësishme për mbijetesën e tyre shoqërinë e informacionit.
- Kërkoni nga mësuesit të ndërtojnë një diagram me shpjegimet përkatëse që përshkruajnë marrëdhënien ndërmjet informacionit, shoqërisë së informacionit, TIK, mbingarkesës informative dhe edukimit për median dhe informimin.
- Diskutoni me mësuesit si ndryshon/rritet niveli i edukimit për informim gjatë jetës sonë, veçanërisht si rrjedhje e arsimimit dhe e niveleve profesionale (në kuadrin e të mësuarit gjatë gjithë jetës). Diskutoni ciklin prodhues të informacionit dhe të dijes. Analizoni rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e ofruesve të informacionit në shoqëri. Diskutoni si zhvillohen aftësitë e edukimit për informim përmes TIK.
- Përshkruani çfarë e bën një nxënës, të arsimuar në fushën e informimit.
- Tregoni ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën e krijimit të llojeve të ndryshme të informacionit, karakteristikat e tyre të përbashkëta dhe përdorimet e vlerën e tyre për shëndetin, mirëqenien në shoqërinë civile, në sektorin e arsimit, për punë dhe për veprimtarinë ekonomike.
- Bëni një kërkim dhe debatoni në lidhje me çështjet e mëposhtme:
  - Informacioni është një ndihmesë për një veprim ose vendimmarrje dhe jo thjesht për të transferuar një ide.
  - Sigurimi dhe përdorimi i një informacioni është një burim i fuqishëm pushteti dhe kontrolli në shoqëri.

- A ka nevojë edukimi për informimin aftësi të veçanta nga ato të TIK? Për shembull, a mund të arsimohet një person në fushën e edukimit për informim në mungesë të TIK?
- Diskutoni qëndrimet e ndryshme kulturore ndaj informacionit.
  - Si shihet dhe vlerësohet informacioni në shoqërinë tuaj?
  - Si krahasohen pikëpamjet në informacionet e shtypura (në gazetatat kryesore) me ato të krijuara nga media elektronike?
  - Cila është marrëdhënia ndërmjet informacionit dhe pushtetit, si dhe ndërmjet medias së shtypur dhe asaj digjitale.
  - Cili është identiteti i personit ose i personave që qëndrojnë pas informacionit.
  - A është e rëndësishme të dihet ky informacion dhe përse?

Ftojini mësuesit të ndjekin veprimtaritë e mëposhtme:

- Vlerësoni vlerën e informacionit nga media e shtypur (gazeta, revista) dhe koston që shoqëron ruajtjen, tërheqjen dhe përdorimin e tij. Trajtimi duhet të përfshijë edhe çështjet në vijim: vlerën e informacionit të bazuar në përfitimet që ai krijon, vlerën e vërtetë të informacionit që bazohet në gatishmërinë e gjetjes ose jo të tij dhe pasojat për përdoruesit në rastet kur ky informacionit mungon.
- Si lidhen aftësitë e edukimit për informim me luftën kundër sëmundjeve, rritjes së mundësive të punësimit ose me përmirësimin e praktikave pedagogjike të mësuesve në klasë?
- Duke përdorur internetin ose bibliotekën e shkollës identifikoni një problem ose një çështje për të shqyrtuar në një nga fushat: edukimi qytetar, shkenca natyrore,

shkenca sociale, histori ose gjeografi. Paraqisni rezultatet e kërkimit tuaj në PPP. Pas prezantimit, reflektoni për çështjet e mëposhtme:

- Si e përzgjedhët atë që dëshironit të paraqisnit nga larmia e madhe e informacionit që ekziston në lidhje me këtë çështje?
- Cili është informacioni që do të dëshironit të kishit për këtë qëllim por nuk mundët ta siguronit?
- Si ndikoi kjo në paraqitjen tuaj?
- A e shndërruat informacionin që morët për ta përdorur në kontekstin tuaj të veçantë?
- Si dhe përse?

## Tema 2:

# Mjedisi i të mësuarit dhe EMI



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Udhëzim me 6 hapa për zgjidhjen e problemit
- Përdorimi i bibliotekave
- Mjedisi i të mësuarit dhe ofruesit e informacionit

### Objektivat e të mësuarit

Në përfundim të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë ndryshimet ndërmjet transmetimit të informacionit dhe informimit për të mësuar.
- Të përshkruajnë dhe të tregojnë aspektet kyçe të organizimit të informacionit, p.sh., duke përdorur skemat e klasifikimit për vendndodhjen e informacionit dhe të njohurive (p.sh. klasifikime përmbledhëse në biblioteka, treguesit, abstraktet, bibliografitë, bazat e të dhënave etj.).
- Të përdorin bibliotekën në mënyrë të efektshme për të mësuar, për të vlerësuar mundësitë që paraqet një bibliotekë për të kërkuar për një çështje të caktuar.
- Të zbatojnë metodën prej 6 hapash për zgjidhje problemesh me informacionin.



## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

- ◆ Kërkoni nga mësuesit të shqyrtojnë kuadrin prej 6 hapash për edukimin për informim dhe për zgjidhjen e mirinformuar të problemeve:
  1. **Përcaktimi i detyrës:** përcaktoni problemin e informimit dhe nevojat për informim.
  2. **Strategjitë për kërkimin e informacionit:** përcaktoni të gjitha burimet e mundshme dhe përzgjidhni burimet më të mira.
  3. **Gjeni vendndodhjen dhe pikën e kontaktit/hyrjes:** përcaktoni burimin dhe gjeni informacionin në këto burime.
  4. **Përdorimi i informacionit:** kushtohuni (lexoni, dëgjoni, shikoni, prekni) dhe nxirrni informacionin që ju intereson.
  5. **Sinteza:** organizoni informacionin nga burime të ndryshme dhe paraqiteni atë.
  6. **Vlerësimi:** gjykoni produktin (cilësinë) dhe procesin (efektshmërinë).
    - Krahasoni këtë me ciklet e taksonomive të tjera të informacionit, të tilla si taksonomia e rishikuar e Blumit për edukimin për informim. A jeni dakord me 6 hapat që formojnë elementet kryesorë të edukimit për informim? Nëse jo, çfarë do të shtoni dhe përse? Në realitet, a mendoni që këto ndjekin një radhë të pastër të njëpasnjëshme, ashtu si paraqitet në skemë?
    - Udhëzoni mësuesit në secilën fazë të procesit të zgjidhjes së problemit të informimit, në tabelën më poshtë dhe siguroni që ata të shpenzojnë kohë të mjaftueshme për të trajtuar të gjitha temat/çështjet që përfshihen në tabelë.

- ◆ Zgjidhni një gazetë në formatin e shkruar ose elektronik në bibliotekën e shkollës ose të qytetit që të trajtojë probleme të arsimit (edukimi i mësuesve, arsimit special, arsimit krahasues etj.). Identifikoni një çështje për të cilën dëshironi të mësoni më shumë në këtë gazetë. Përmblihdhni gjetjet tuaja në një artikull. Sa i dobishëm ishte informacioni për praktikën tuaj profesionale si mësues? A mund të zbatohet ky informacion në kontekstin tuaj? Nëse po, si do ta përdornit këtë informacion?
- ◆ Takohuni me kolegë, bibliotekarë të shkollës suaj etj. dhe diskutoni aftësitë për informimin që duhet të kenë mësuesit për të rritur përdorimin e bibliotekës. Vendosni disa detyra për të përfshirë nxënësit në përdorimin e plotë të burimeve që gjenden në bibliotekë dhe kërkoni atyre të krahasojnë informacionin që morën në të me ato që morën nga burime të tjera (p.sh. internet) dhe të vlerësojnë dobinë e tyre në këndvështrimin e detyrës së dhënë.
- ◆ Vlerësoni mjedisin e shkollës në lidhje me nevojat për edukimin për informim dhe shkruani rekomandime të veçanta që do të rrisnin nivelin e arsimit në fushën e informimit.
- ◆ 6 hapat dhe zgjidhja e problemit të informimit: përdorni burime informacioni në një bibliotekë për të eksploruar një çështje aktuale (p.sh. e drejta e votës, demokracia etj.) zbatoni procesin 6 hapash.
- ◆ Përdorni teknologjinë për të marrë një informacion për një çështje ose temë në interesin tuaj dhe paraqiteni informacionin në një tabelë ose në formën e një grafiku. Krahasonisasinë, cilësinë dhe dobishmërinë e informacionit nga burimet e bibliotekës me ato të marra nga interneti.
- ◆ Shkruani një ese për mënyrën si përdorimi i radios ose i teknologjisë së telefonisë së lëvizshme po ndryshon pamjen e krijimit të informacionit dhe përdoren në vendin tuaj. Përmblihdhni gjetjet tuaj në një prezantim PPP.

HAPAT	TEMAT / ÇËSH TJET
<p><b>Hapi I</b>  <b>Përcaktimi i nevojave ose i problemeve për informim</b></p>	<p>Çfarë dëshiroj të gjej?  Cili është problemi që dëshiroj të zgjidh?  A e kuptoj natyrën e problemit ose të çështjes në kërkim?  A mund të përcaktoj qartë nevojat e mia për informacion ose problemet?  Sa njohuri paraprake zotëroj për çështjen në fjalë?  Sa informacion tjetër më duhet për çështjen që më intereson?</p>
<p><b>Hapi II</b>  <b>Strategjitë e kërkimit të informacionit</b></p>	<p>Sa kohë kam për të gjetur informacionin?  Ku duhet të kërkoj për këtë informacion?  Mësuesit duhet të udhëzohen për burimet më të mira të informacionit për disa lloje të veçanta informacioni. Në varësi të kontekstit, këtu mund të përfshihen:</p> <p><b>Burimet e para</b>, të cilat janë burime origjinale, ku informacioni nuk interpretohet, të tilla si raporte kërkimesh, fatura shitjesh, fjalime, emaile, vepra origjinale, dorëshkrim, foto, ditarë, letra personale, histori/intervista të treguara, protokolle diplomatike,</p> <p><b>Burimet e dyta</b> të cilat ofrohen nga ofruesit e informacionit ku informacioni është interpretuar, analizuar ose përmbledhur paraprakisht (librat shkollorë, revista interpretime etj.)</p> <p><b>Burimet e treta</b>, të cilat përfshijnë hartime, tregues ose burime të tjera të organizuara (abstrakte, bibliografi, manual, enciklopedi, kronologji, bazë të dhënash etj.)</p> <p>A kërkoj unë në bibliotekën fizike, internet (duke përfshirë libraritë digjitale, muze, arkiva).  Ku të kërkoj për ndihmë?</p>
<p><b>Hapi III</b>  <b>Gjeni vendndodhjen dhe pikën e kontaktit/hyrjes</b></p>	<p>Mësuesit duhet të udhëzohen si të kërkojnë në mënyrë të efektshme informacionin në burimet e përmendura në Hapin II.  Këtu përfshihen:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Këshilla për kërkim në internet, duke përfshirë edhe kërkimin e përgjithshëm dhe kërkimin e specializuar në një fushë të përcaktuar (nxënësit, vendin); të kuptuarit</li> </ol>

	<p>emrat e fushave (qeveria, edukimi, organizata etj.) dhe kërkimin në faqet akademike.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>2. Përdorimi i treguesve dhe tabelave të përmbajtjes në një libër dhe kërkimi në fushën e dokumenteve pdf.</li> <li>3. Përdorimi i bibliotekave (kërkimi në katalogët e bibliotekave, periodikëve, treguesve, abstrakteve, referencave etj.)</li> <li>4. Kërkimi në baza të dhënash; këshilla për kërkim në baza të dhënash (fjalë kyçe, identifikimi i sinonimeve ose variacioneve të tyre, kërkimi përmes në subjekti, emri, autori, kombinimi fjalësh kyçe, shkurtime fjalësh, botime etj.</li> </ol>
<b>Hapi IV Vlerësimi kritik</b>	Vlerësimi i kriterëve të nevojshme për të vlerësuar/vlefshmëria dhe besueshmëria, vërtetësia ose cilësia e informacionit nga librat, uebsajtet, burime të tjera online etj.
<b>Hapi V Sinteza</b>	<p>Cila është teza?</p> <p>Cila është teza ime? Si lidhet kjo me problemin që dëshiroj të zgjidh?</p> <p>Si të organizoj në mënyrë të efektshme informacionin që më intereson nga burime të ndryshme?</p> <p>Si ta paraqes informacionin? Cilat janë mjetet që kam në dispozicion? Për çfarë mjetesh kam nevojë?</p>
<b>Hapi VI Përdorimi, shkëmbimi dhe e përhapja e informacionit</b>	<p>Zbatimi i informacionit që kam gjetur për të zgjidhur problemin tim</p> <p>Gjurmimi i burimeve, duke përdorur bibliografitë, referimet etj.</p> <p>Mjetet për shkëmbimin, përhapjen dhe bashkëpunimin me të tjerët që kanë nevoja ose probleme të ngjashme me informimin (dokumentet Google, wikis, etj.)</p> <p>Të kuptuarit e të drejtës së autorit dhe plagjarizmi.</p>

## Tema 3:

# Edukimi për informimin digjital



Kohëzgjatja **3 orë**

### Çështjet kryesore

- Natyra e informacionit online
- Ndërtimi dhe programet e kompjuterit
- Ligjet për të drejtën e autorit. Mbrojtja e programeve kompjuterike dhe e të dhënave elektronike
- Shërbimet digjitale, duke përfshirë përkthimin e makinës, transkriptimi tekst audio
- Të mësuarit përmes internetit
- Ruajtja digjitale dhe formatet digjitale

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë ndryshimin ndërmjet analogut dhe digjitalit, duke përfshirë krijimin, transportimin, shpërndarjen dhe fazat e ruajtjes së informacionit digjital.
- Të përdorin zotësitë bazë të mjeteve produktive për përpunimin në Word, ruajtjen e dokumenteve, hyrjen nga burime të largëta dhe komunikimin ndërpersonal.
- Të përdorin teknologjinë e informacionit për të ripërcaktuar shumë aspekte të përvojës së tyre akademike dhe personale.

- Të zbatojnë ligjet e të drejtës së autorit, duke përfshirë edhe krijimin e licencave të përgjithshme ose të të drejtës së autorit.
- Të kërkojnë online duke përdorur teknikat e përshtatshme (motorët e kërkimit etj.)
- Të përshkruajnë rolin e ofruesve të informacionit (biblioteka, muze, arkiva) në ruajtjen e informacionit digjital.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Ruajtja e informacionit në formate digjitale e bën të mundur arritjen e tij përmes përdorimit të mjeteve të ndryshme nga ato të informacionit analog. Kjo hyrje fleksibël e rrit rëndësinë e digjitalizimit, sikurse nënvizon nevojën për aftësi digjitale që duhet të mësohen krahas aftësive për informim. Në thelb, edukimi digjital përfshin analizën, vendndodhjen, organizimin, vlerësimin, krijimin dhe përdorimin e informacionit duke përdorur teknologjinë digjitale. Diskutoni përparësitë e pasjes së informacionit në formatin digjital (transmetimin, ruajtjen, kërkimin, përpunimin efektiv etj.).

Nëse mësuesit kanë njohuri të kufizuara ose aspak njohuri për kompjuterët dhe programet e tyre, planifikoni disa seanca laboratorike fizike ose virtuale. Mësuesit duhet të njihen me bazat e kompjuterit, të programeve, rrjeteve dhe serverëve. Kjo duhet të përfshijë edhe aftësitë për të përdorur tastierën, mausin, të shtypurit etj. Mësuesit duhet të njihen me bazat e programeve të hapura dhe me kosto të ulët. Mësuesit duhet të pajisen me një listë programesh dhe pajisje kompjuterike. Kërkoni nga mësuesit që në internet të kërkojnë dy shembuj të programeve që janë burime të hapura dhe kompjuter me kosto të ulët që kanë funksione të ngjashme me mjetet e përzgjedhura. Vlerësoni në mënyrë kritike përparësitë dhe mangësitë e secilit.

## Veprimtari

- ◆ Kërkoni në internet dhe në burime të tjera online, të tilla si bazat e të dhënave dhe bibliotekave elektronike për të mbledhur informacion për një çështje të caktuar për kërkim. Reduktoni burimet e informacionit në përputhje me qëllimin tuaj të kërkimit. Kërkoni për fjalë kyçe ose lidhëza vepruese (dhe, ose, edhe) dhe përcaktoni cila funksionon më mirë.
- ◆ Prodhoni një plan veprimi ose një numër veprimtarish për të përfshirë nxënësit në përdorimin e burimeve të larmishme të medias digjitale, për të përgatitur një projekt, vlerësim ose detyrë shtëpie. Diskutoni për tiparet e ofruara nga teknologjitë e reja që njerëzit me aftësi të kufizuara të mund të përdorin informacionin digjital (hyrja në faqe dhe krijimi i dokumenteve digjitale në formate të përdorshme).
- ◆ Studioni në internet një faqe të përdorur për të ofruar kurse për trajnimin e mësuesve ose për programe të tjera arsimore. Shikoni si është organizuar dhe si mundësohet ky informacion. Cilat janë burimet e informacionet digjitale që përdoren online? Si integrohen burimet digjitale me materialet e kursit? Ushtroni me përdorimin e kësaj faqeje dhe diskutoni sa e dobishme mund të jetë ajo për të mësuarit dhe cilat janë kufizimet. Diskutoni përparësitë dhe mangësitë.
- ◆ Vizitoni një faqe wiki arsimore dhe analizoni mënyrën si ajo e ofron kurrikulën. Ndërtoni një faqe të tillë për një çështje arsimore (përmirësimi i aftësive bazë të leximit dhe numërimit në moshën e vogël shkollore). Diskutoni për një detyrë për trajnimin e mësuesve në këtë faqe dhe vlerësoni përfitimet dhe kufizimet e ndarjes së informacionit duke përdorur këtë platformë.
- ◆ Eksperimentoni shkrimin e një blogu për një temë të caktuar që lidhet me arsimin në vendin tuaj. Kjo duhet të jetë një çështje e interesit dhe ndjeshmërisë së përbashkët (përmirësimi i hyrjes në arsimin bazë e të mesëm të shtresave më të varfra të shoqërisë, rritja e larmisë së

rrugëve për të përfituar informacion për nxënësit e shkollave të mesme me qëllim që të përmirësohet cilësia e të mësuarit e tyre; përse të varfrit po bëhen më të varfër në një kohë kur rritet informacioni dhe dija etj.)

- ◆ Diskutoni me nxënësit për informacionet digjitale që ata mendojnë se duhet të ruhen. Cilat janë kriteret për përzgjedhjen dhe zgjidhjet teknike në dispozicion dhe si mund të sigurohet qëndrueshmëria? Cilat janë disa aspekteve të tjera që lidhen me çështjen e ruajtjes?
- ◆ Identifikoni instrumentet ndërkombëtare që shërbejnë për ruajtjen e informacionit (Karta e UNESCO për Ruajtjen e Trashëgimisë Digjitale, arkivimi digjital dhe udhëzimet e ruajtjes).
  - Vizitoni këtë faqe
  - Diskutoni rëndësinë e ruajtjes dhe promovimit të trashëgimisë dokumentare në kuadrin e një tragjedie/ fatkeqësie natyrore, tërmeti etj.
  - Pyesni nxënësit për rëndësinë e arkivimit dhe të mënyrës së realizimit të tij.





# MODULI 9

Gjuha e urrejtjes dhe edukimi  
për qytetari demokratike

## Hyrje

Gjuha e urrejtjes është një koncept i gjerë dhe shumë i diskutuar. Shumë traktate ndërkombëtare janë përpjekur ta përcaktojnë atë e megjithatë, në jetën e përditshme ai vazhdon të përdoret si një term i përgjithshëm që ndërthur kërcënime konkrete për individët dhe sigurinë e grupeve me rastet në të cilat njerëzit thjesht shpalosin inatin e tyre kundër autoriteteve. Platformat e mëdha sociale si Facebook, Google etj. janë përpjekur të ofrojnë përkufizimin e tyre për gjuhën e urrejtjes që detyrojnë përdoruesit dhe kompanitë të respektojnë rregulla e të vendosin kufizime për shprehjet e tyre. Shumë vende përpiqen ta përkufizojnë atë në kuadrin e veçorive kulturore dhe të traditave të tyre. Duket se ajo që mbetet në këto përpjekje është interesi i tyre përbashkët për të shmangur dhunën dhe për të mbrojtur dinjitetin njerëzor.

Gjuha e urrejtjes online ndeshet në pikëprerjen e tensioneve të shumta. Ajo është shprehje e konflikteve ndërmjet grupeve të ndryshme brenda dhe ndërmjet shoqërive. Ajo është shprehje e gjallë e mënyrës se si teknologjitë, me mundësitë e tyre transformuese si interneti, sjellin njëherazi shanse dhe sfida. Ajo përfshin baraspeshën komplekse ndërmjet të drejtave dhe parimeve themelore si liria e shprehjes dhe mbrojtja e dinjitetit njerëzor.

Lindja dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes online është një dukuri në zhvillim që kërkon veprim kolektiv për të kuptuar thelbin dhe pasojat e saj, si dhe për të zhvilluar përgjigjet e duhura. Shfaqjet e indinjatës së publikut janë një përgjigje e zakonshme, e shoqëruar edhe me kërkesat e disa individëve publikë për të rritur ndëshkimet për ata që përhapin mesazhe urrejtjeje dhe për të vendosur kontroll të reptë ndaj internetit.

Megjithatë, të përqendrohesh vetëm në masa shtypëse e kufizuese, do të thotë të shmangësh të kuptuarit e kësaj dukurie komplekse ende të panjohur si duhet, e cila kërkon edhe përgjigje të koordinuara dhe të veçanta nga aktorë të

ndryshëm të shoqërisë. Hapësirat online, me mundësitë e tyre të jashtëzakonshme për ndërveprime dhe me sasinë e madhe të të dhënave që mundësojnë e që mund të analizohen me anë të teknikave të reja, ofrojnë edhe lente të veçanta për të eksploruar sjelljen njerëzore. Zgjidhjet e efektshme duhet të bazohen në të kuptuarit më të mirë se si lindin, si ndërveprojnë dhe, mundësisht, si zhduken në këtë mjedis. Për këtë arsye, edukimi mbetet një ndër zgjidhjet më të efektshme për të kuptuar dhe për të parandaluar gjuhën e urrejtjes.

Edukimi për qytetari synon përgatitjen e individëve të informuar dhe të përgjegjshëm përmes studimit të të drejtave të njeriut, të lirive dhe të përgjegjësisë dhe është zbatuar në forma të ndryshme në shoqëritë që kanë dalë nga konflikte të dhunshme. Një ndër objektivat e tij kryesor është rritja e vetëdijes për të drejtat politike, sociale dhe kulturore të individëve dhe të grupeve, duke përfshirë këtu lirinë e fjalës dhe përgjegjësitë dhe ndikimet sociale që burojnë prej saj. Në shumë raste, argumentimi dhe aftësitë e nevojshme për të shprehur bindjet dhe opinionet personale në programet e edukimit për qytetari janë përfshirë në rezultatet e pritshme të të mësuarit të programeve të edukimit për qytetari.

*Shqetësimi i edukimit për qytetari demokratike në lidhje me gjuhën e urrejtjes ka dy aspekte: së pari ai përfshin njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të identifikuar gjuhën e urrejtjes dhe aftësimin e individëve për t'iu përgjigjur gjuhës dhe mesazheve që bartin urrejtje. Një ndër sfidat e tij aktuale është përshtatja e qëllimeve dhe e strategjive të tij për botën digjitale, duke siguruar jo vetëm njohuritë dhe aftësitë argumentuese, por edhe ato teknologjike që i nevojiten qytetarëve për të luftuar dhe për t'iu kundërpërgjigjur gjuhës së urrejtjes online. Për këtë arsye, sot propozohet një koncept i ri i cili përfshin objektivat themelore të edukimit për median dhe informimin, të cilat synojnë të zhvillojnë aftësitë teknike dhe ato kritike të konsumatorëve dhe të prodhuesve të medias dhe t'i lidhin ato me çështjet më të gjëra etike dhe qytetare.*

Në këtë këndvështrim të gjerë, **UNESCO** nxit dhe mbështet edukimin për median dhe informimin, i cili përfshin një paketë

të gjerë të llojeve të ndryshme të edukimit online dhe offline. Ajo synon zhvillimin e aftësive dhe zotësive të nevojshme për përdorimin e teknologjive digjitale si dhe njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të identifikuar, për të vlerësuar dhe për të interpretuar tekstet e veçanta të medias, për të krijuar mesazhe mediatike dhe për të njohur ndikimin e tyre social dhe politik. Kohët e fundit, mbështetësit e edukimit për median, kanë filluar të trajtojnë rëndësinë shoqërore të përdorimit të teknologjive, ndikimin e tyre etik dhe të drejtat dhe përgjegjësitë civile që burojnë prej tyre. Edukimi për informimin nuk mund të shmangë çështje të tilla si liria e shprehjes dhe e privatësisë, qytetaria kritike dhe edukimi për fuqizimin e individit për pjesëmarrjen politike.

Dalja e teknologjive të reja dhe e medias sociale ka luajtur rol të madh në këtë zhvendosje. Individët janë zhvilluar, nga të qenit konsumatorë të thjeshtë të mesazheve të medias, në prodhues, krijues dhe rregullues të informacionit, duke krijuar modele të reja të pjesëmarrjes që ndërthuret me atë tradicionale si votimi ose anëtarësimi në një parti politike. Bashkë me këto ndryshime kanë ndryshuar edhe strategjitë e mësimdhënies, nga ato që synojnë në edukimin e aftësisë së marrjes kritike të informacionit e të mesazheve të medias në ato që synojnë fuqizimin e krijimit të përmbajtjes mediatike.

Disa prej këtyre aftësive marrin rëndësi të veçantë për identifikimin dhe kundërpërgjigjen ndaj gjuhës së urrejtjes online dhe për këtë arsye synohet që të kthehen në instrumente praktike për përdoruesit e internetit si qytetarë aktivë digjitalë.

**UNESCO** thekson rëndësinë e edukimit për median dhe informimin dhe të strategjive arsimore si mjete të efektshme kundër gjuhës së urrejtjes. Paketa e kompetencave që synohen nga edukimi për median dhe informimin do t'i fuqizojë individët duke i pajisur ata me njohuri dhe aftësi të nevojshme për t'iu përgjigjur gjuhës së urrejtjes në mënyrë të menjëhershme. Këto aftësi marrin rëndësi të veçantë në kuadrin e theksit që platformat e rrjeteve sociale vënë tek raportimet individuale për rastet e abuzimeve, të nxitjes së urrejtjes etj.

Përveç kësaj, në kuadrin e lëvizjes kundër gjuhës së urrejtjes, nga pohohet jo vetëm rëndësia e arsimit si thelbësor për të parandaluar gjuhën e urrejtjes online, për të rritur vetëdijen dhe për të fuqizuar njerëzit që të hyjnë online në mënyrë të përgjegjshme, por edhe rëndësia e një kuadri ligjor dhe e instrumenteve përkatëse për të ndëshkuar krimet e urrejtjes, duke përfshirë këtu edhe gjuhën e urrejtjes. Ky përbën edhe një aspekt të rëndësishëm të edukimit kundër gjuhës së urrejtjes, që ndërthur aspektin edukativ me atë ligjor.

### ***Cilat janë disa nga synimet e edukimit për median dhe informimin për t'iu përgjigjur gjuhës së urrejtjes?***

Pavarësisht nga larmia e nismave dhe e grupeve të njerëzve të shënjestruar, synimet e këtij edukimi të veçantë përfshijnë **informimin, analizën** dhe **veprimin** (përballjen me gjuhën e urrejtjes), të cilat duhet të shihen në një linjë vazhdimësie të synimeve dhe objektivave specifike, të cilët përqendrohen në aspekte të ndryshme të problemit dhe ofrojnë alternativa të ndryshme të përgjigjes ndaj gjuhës së urrejtjes.

INFORMIMI	ANALIZA	VEPRIMI
<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Rritja e vetëdijes për gjuhën e urrejtjes dhe të pasojave të saj.</li> <li>▪ Përçimi dhe përhapja e mesazheve.</li> <li>▪ Komunikimi i kuadrit përkatës ligjor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Identifikimi dhe vlerësimi i gjuhës së urrejtjes.</li> <li>▪ Analiza e shkaqeve të përgjithshme dhe perceptimet e paragjykimet që qëndrojnë në themel të tyre.</li> <li>▪ Njohja e sjelljeve të njëanshme.</li> <li>▪ Raportimi dhe bërja të njohur e gjuhës së urrejtjes.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Përgjigja ndaj gjuhës së urrejtjes.</li> <li>▪ Shkrimet kundër gjuhës së urrejtjes.</li> <li>▪ Ndryshimi i trajtimit të gjuhës së urrejtjes.</li> <li>▪ Mbikëqyrja e medias.</li> </ul>

1. **Synimi i parë** përqendrohet në përçimin e informacionit për gjuhën e urrejtjes. Ai përfshin rritjen e vetëdijes për gjuhën e urrejtjes online, për format e saj të ndryshme dhe për pasojat e mundshme. Po kështu, ai synon njohjen e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për gjuhën e urrejtjes.
2. **Synimi i dytë** është më i ndërlikuar dhe përqendrohet në analizën e gjuhës së urrejtjes online. Kjo analizë përfshin edhe matjen dhe vlerësimin e llojeve të ndryshme të gjuhës së urrejtjes online, si racizmin, seksizmin dhe homofobinë dhe format e shumëfishta në të cilat ato paraqiten. Aspekt i rëndësishëm i analizës është shqyrtimi kritik i gjuhës së urrejtjes për të identifikuar shkaqet e saj kryesore dhe për të kuptuar perceptimet e paragjykimet që qëndrojnë në themel të tyre. Ky proces analitik do t'u japë individëve mundësinë të raportojnë dhe të shpallin hapur përmbajtjet që bartin urrejtje.

E drejta për të shprehur veten është një e drejtë themelore që buron nga e drejta e fjalës. Megjithatë, duket se vija që ndan fjalët për të nisur një diskutim dhe atyre që përdoren për të nxitur urrejtje po bëhet e padukshme. Dukuria e mobilizimit të turmave për veprime të dhunshme përmes shprehjes hapur të egërsisë ndaj grupeve të caktuara është shfrytëzuar gjerësisht nga njerëz që kanë mundësi të dëgjohen.

3. **Synimi i tretë** arsimor përqendrohet në veprimet që mund të ndërmerren për të luftuar dhe për t'iu kundërvënë gjuhës së urrejtjes. Veprimet varen nga faktorë të ndryshëm, por synimi i tyre kryesor është fuqizimi i individëve për t'iu përgjigjur me vendosmëri përmbajtjeve që bartin urrejtje.

# Tema 1:

## Të kuptojmë gjuhën e urrejtjes



Kohëzgjatja **60 minuta**

### Çështjet kryesore

- Përcaktimi i gjuhës së urrejtjes
- Eksplorimi i formave të ndryshme të gjuhës së urrejtjes
- Eksplorimi i përgjigjeve të ndryshme ndaj gjuhës së urrejtjes

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të përshkruajnë forma të ndryshme të shprehjes së gjuhës së urrejtjes online dhe pasojat e tyre për viktimat dhe shoqërinë.
- Të eksplorojnë përgjigje të mundshme ndaj gjuhës së urrejtjes online.

### Qasja pedagogjike dhe veprimtari

Moduli bazohet dhe përdor të njëjtat qasje që përdoren në edukimin për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut dhe në edukimin për median dhe informimin në mënyrë të veçantë, që përfshin *edukimin, trajnimin, rritjen e vetëdijes, informimin, praktikat dhe veprimtaritë që synojnë të pajisin nxënësit me njohuri, aftësi dhe qëndrime që i fuqizojnë ata për të kontribuar në ndërtimin*



*dhe në mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri, për të zhvilluar dhe për të mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.*

Moduli ka si pikënisje idenë se hapësira online është një hapësirë publike dhe, për këtë arsye, në të zbatohen dhe duhet të zbatohen të gjitha parimet e shoqërisë demokratike. Në këtë kontekst, roli i të rinjve për të luftuar gjuhën e urrejtjes në këtë hapësirë, mbetet i ai i një rëndësie të veçantë.

Të rinjtë janë qytetarët online. Kjo do të thotë që ata mund të shprehin dëshirat dhe shqetësimet e tyre online, të ndërmarrin veprime dhe t'i vënë para përgjegjësisë ata që i shkelin këto parime. Në këtë këndvështrim, ata janë mbrojtësit online të të drejtave të njeriut.

Moduli synon të aftësojë mësuesit në arsimin formal dhe jo formal që të trajtojnë dukurinë e gjuhës së urrejtjes duke përfshirë nxënësit, të rinjtë dhe të gjithë komunitetin shkollor në luftën kundër kësaj gjuhe.

Ai synon të motivojë mësuesit dhe të rinjtë dhe t'i pajisë ata me aftësitë e duhura për të identifikuar gjuhën e urrejtjes online, duke i përfshirë në mënyrë aktive në veprimtari që kanë në themel luftën kundër saj; të rrisë tek të rinjtë vetëdijen e parimeve të të drejtave të njeriut dhe t'i ndihmojë ata në krijimin e një vizioni për internetit që të reflektojë këto parime.

Moduli synon të pajisë mësuesit me qasjet e duhura për trajtimin e gjuhës së urrejtjes në procesin e të mësuarit dhe të mësimdhënies, që të ndihmojnë të rinjtë në zhvillimin e shpirtit kritik ndaj kësaj dukurie.

Po kështu, një ndër synime e modulit është të fuqizojë viktimat e gjuhës së urrejtjes dhe viktimat e mundshme të saj, të nxisë empatinë ndërmjet grupeve dhe individëve që mund të jenë shënjestra të gjuhës së urrejtjes online, si dhe të thyejë mitet dhe paragjykimet në lidhje me të shënjestruarit e zakonshëm të kësaj gjuhe

## Veprimtari

- ❖ Shprehni konceptin tuaj për gjuhën e urrejtjes dhe përmendni disa nga format e shprehjes së kësaj gjuhe dhe të grupimeve të shënjestruara prej kësaj gjuhe (p.sh. gej, të zinj, mysliman, gra etj.).

Kujtoni që, në kuptimin e saj të gjerë, termi gjuhë urrejtje:

Së pari, përfshin

- shumë më tepër se ç'nënkupton fjala gjuhë në përdorimin e përditshëm të saj dhe mund të përdoret përmes shumë formave të komunikimit si video, pamje, muzikë etj.
  - Së dyti, mund të përdoret për të përshkruar sjellje shumë abuzive dhe madje kërcënuese si dhe komente fyese.
- ❖ Analizoni shembuj realë të gjuhës së urrejtjes online, duke u përqendruar kryesisht në ndikimin e saj te viktimat dhe te shoqëria në përgjithësi. Përpiquni që, në grupe të diskutoni rastet e mëposhtme dhe përgatisni përgjigjet tuaja me shkrim për t'i ndarë me të tjerët.

Ju mund të zgjidhni shembuj të tjerë në varësi të kontekstit/ mjedisit ku jetoni ose në varësi të përparësive të edukimit.

### RASTI I PARË (GRUPI I PARË)

Një i ri shfaq një flamur të madh të një partie nacionaliste në median e tij sociale, duke e shoqëruar me komente të tilla si: "Islami jashtë vendit tim"! "Mbroni njerëzit tanë"! Ai poston fotografi me simbolin e gjysmë hënës dhe yllit në shenjën e ndalimit. Përveç kësaj, ai përhap informacion përmes medias sociale dhe faqes së tij personale.

Detyra e këtij grupi është t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë viktimat e gjuhës së urrejtjes në këtë shembull? Cilat janë pasojat që këto viktime mund të kenë si rrjedhojë e kësaj gjuhe?
- Cilat janë pasojat që mund të sjellë ky shembull i gjuhës së urrejtjes në njerëzit që e identifikojnë veten me këto komunitete si dhe për shoqërinë në përgjithësi?

**RASTI I DYTË (GRUPI I DYTË)**

Një person boton një shkrim në të cilin, jo vetëm pohon që “Holokausti nuk ka ndodhur kurrë” , por edhe shpreh qëndrime abuzive dhe raciste për hebrenjtë. Ky person e publikon shkrimin e tij në blogun e tij personal dhe në disa faqe aktive kundër hebrenjve. Përveç kësaj, ai e përfshin shkrimin e tij në përmbajtjen e WIKIS online, të cilën e paraqet si një informacion shkencor për Holokaustin.

Detyra e këtij grupi është të trajtojë dhe t’u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë viktimat u gjuhës së urrejtjes në këtë shembull?
- Cilat janë pasojat që kjo gjuhë mund të sjellë për ta?
- Cilat janë pasojat që mund të sjellë ky shembull i gjuhës së urrejtjes në njerëzit që e identifikojnë veten me këto komunitete si dhe për shoqërinë në përgjithësi?

**RASTI I TRETË (GRUPI I TRETË)**

Online janë botuar video që i paraqesin njerëzit LGBT si “deviantë” dhe “të sëmurë” dhe që, për këtë arsye, duhet të mbahen larg shoqërisë sepse ata shkatërrojnë traditat dhe vazhdimësinë e kombit. Këto video pretendojnë t’i referohen kërkimeve shkencore, por në fakt referimet që ata përdorin janë të cituara gabim dhe janë përzgjedhur qëllimisht në mënyrë të njëanshme. Disa prej tyre tregojnë foto të familjeve LGBT me fëmijët e tyre.

Detyra e këtij grupi është të trajtojë dhe t’u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë viktimat e gjuhës së urrejtjes në këtë shembull?
- Cilat janë pasojat që kjo gjuhë mund të sjellë për ta?
- Cilat janë pasojat që mund të sjellë ky shembull i gjuhës së urrejtjes në njerëzit që e identifikojnë veten me këto komunitete, si dhe për shoqërinë në përgjithësi?

### RASTI KATËRT (GRUPI I KATËRT)

Një politikan, me anë të një shkrimi, akuzon myslimanët si shkaktarët kryesorë të krimeve kundër vajzave. Ai u referohet “njohurive të përgjithshme”, por ofron shumë pak shembuj që e provojnë këtë ide. Një video që lidhet me shkrimin tërheq shumë njerëz me komente dhe disa prej të cilave kishin natyrë raciste dhe të dhunshme. Këto ide u mbështetën edhe nga njerëz të tjerë, të cilët e paraqitën shkrimin si një opinion të respektueshëm dhe informues.

Detyra e këtij grupi është të trajtojë dhe t’u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë viktimat u gjuhës së urrejtjes në këtë shembull?
- Cilat janë pasojat që kjo gjuhë mund të sjellë për ta?
- Cilat janë pasojat që mund të sjellë ky shembull i gjuhës së urrejtjes në njerëzit që e identifikojnë veten me këto komunitete si dhe për shoqërinë në përgjithësi?

### RASTI I PESTË (GRUPI I PESTË)

Online janë publikuar disa video që shfaqin konfliktet e ashpra që dy vende kanë pasur në të kaluarën. Këto video qëndrojnë gjatë në një kanal online dhe për rrjedhojë, rreth tyre u shoqëruan edhe me shumë komente. Gjuha e përdorur në këto komente për njerëzit e vendit tjetër është raciste. Racizmi dhe abuzimi ndërmjet përfaqësuesve të dy vendeve vazhdojnë prej shumë kohësh.

Detyra e këtij grupi është të trajtojë dhe t’u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë viktimat u gjuhës së urrejtjes në këtë shembull?
- Cilat janë pasojat që kjo gjuhë mund të sjellë për ta?
- Cilat janë pasojat që mund të sjellë ky shembull i gjuhës së urrejtjes në njerëzit që e identifikojnë veten me këto komunitete si dhe për shoqërinë në përgjithësi?

## RASTI I GJASHTË (GRUPI I GJASHTË)

Një reklamë për bluxhinset e publikuar në internet për një kohë të gjatë, përmban një skenë në të cilën një vajzë me bluxhins është e rrethuar nga meshkuj. Skena ka përmbajtje seksuale, por përshtypja e përgjithshme që krijohet prej saj është ajo e dhunës seksuale dhe përdhunimit. Kjo bëri që disa prej organizatave të një vendi të ankohen për të. Ky lajm në internet ngjalli komente të ndryshme dhe shumë prej tyre përforconin idenë që gratë janë objekte me të cilat meshkujt mund të luajnë, madje edhe në mënyrë të dhunshme.

Detyra e këtij grupi është të trajtojë dhe t'u përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:

- Cilat janë viktimat u gjuhës së urrejtjes në këtë shembull?
- Cilat janë pasojat që kjo gjuhë mund të sjellë për ta?
- Cilat janë pasojat që mund të sjellë ky shembull i gjuhës së urrejtjes në njerëzit që e identifikojnë veten me këto komunitete si dhe për shoqërinë në përgjithësi?

- ❖ Duke u bazuar në përgjigjet e dhëna nga secili grup, shënioni në tabelë pyetjet me të cilat u përballën grupet dhe, krahas tyre, shënioni numrin e përgjigjeve të ngjashme, për të evidentuar qëndrimet e njëjta ose të ndryshme të grupeve ndaj të njëjtave pyetje.
- ❖ Pasi të jenë dhënë e dëgjuar të gjitha përgjigjet e grupeve, filloni një diskutim përmbledhës duke pasur parasysh pyetjet e mëposhtme:
  - Cili është mendimi juaj për këtë veprimtari?
  - Çfarë mendoni për shembujt e analizuar?
  - Cilat ishin disa prej pasojave të përbashkëta/të zakonshme të gjuhës së urrejtjes të renditura nga grupet?
  - A kanë grupet e shënjestruara në shembujt e analizuar gjëra të përbashkëta? Cilat janë ato?
  - A ka pasoja të ngjashme për grupet, pavarësisht nga ndryshimet ndërmjet tyre?

- Cilat do të ishin disa prej pasojave të kësaj gjuhe urrejtjeje të shpërndarë online, në rast se askush nuk do të merrej me trajtimin e këtij problemi?
- Cilat janë, sipas mendimit tuaj, disa nga instrumentet dhe metodat që do të shërbenin për të trajtuar gjuhën e urrejtjes online?
- Çfarë mund dhe duhet të bëjmë ne në rastet kur ndeshemi me këtë gjuhë online?

## Ide për veprime të mëtejshme

Zbuloni diçka më shumë për lëvizjen “Jo gjuhë urrejtjeje online”. Bashkohuni kësaj lëvizjeje për të treguar se edhe ju jeni kundër kësaj gjuhe. Ju mund të përdorni faqen për të ndarë ide në lidhje me pasojat e gjuhës së urrejtjes dhe me rëndësinë e luftës kundër saj në shenjë solidariteti me viktimat.

Po kështu, ju mund të zhvilloni edhe një kartë kundër gjuhës së urrejtjes online dhe të përdorni ditët e të drejtave të njeriut për të rritur vetëdijen për këtë problem.

## Tema 2:

# Përplasja e lirive ose liritë në konflikt



Kohëzgjatja **90 minuta**

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të identifikojnë dhe të eksplorojnë çështjet që lidhen me diversitetin, pluralizmin dhe gjuhën e urrejtjes.
- Të shqyrtojnë dhe të shpjegojnë si liria e shprehjes ndihmon në funksionimin e demokracisë.
- Të diskutojnë për përparësitë dhe mangësitë e mungesës së kufizimeve për lirinë e shprehjes.
- Të ushtrojnë aftësitë e negociimit.

### Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Kjo veprimtari përdor simulimin dhe ndarjen në grupe, që përfaqësojnë dy komunitete. Njëri prej komuniteteve (komuniteti i ishullit X) përbën 2/3 e të gjithë pjesëmarrësve. Pjesa tjetër, 1/3 përfaqëson komunitetin tjetër Y (Ishulli plastik). Pjesa e parë e veprimtarisë simuloese përfshin punën me dy grupet e mëdha të komuniteteve, ndërsa në pjesën e dytë, grupet punojnë së bashku.

Përshkrimet e jetës në dy ishujt janë relativisht të gjata, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të përfshihen intelektualisht në këto komunitete. Ato duhet të lexohen jo si "informacion", por si një ngjarje!

Grupet të cilat zgjedhin problemin e fushatës së internetit, duhet të përqendrohen në aspektin online të problemit. Ata duhet të udhëzohen ta mbajnë parasysh këtë aspekt gjatë gjithë diskutimeve dhe propozimeve të tyre offline.

Përpiquni që të ndërhyni me sa më pak udhëzime gjatë simulimit dhe siguroni respektimin e kohës së veprimtarisë si dhe të kuptuarit si duhet të detyrës. Mos harroni, ju duhet t'i lejonit pjesëmarrësit të trajtojnë detyrën në mënyrën më të përshtatshme për ta. Ndërhyuni vetëm nëse vini re që ata kanë keqkuptuar detyrën ose gjatë procesit lindin konflikte ose tensione që e pengojnë atë.

Pjesëmarrësit duhet të përfitojnë nga informacioni për lirinë e shprehjes dhe u siguroni atyre këtë informacion nëse e lejon koha.

## Veprimtari

- ❖ Ndahuni në dy grupe komunitare dhe vendosuni në dy mjedise të ndryshme. Lexoni informacionin që lidhet me secilin grup, pra me komunitetin të cilin përfaqësoni, i cili ndodhet i shkruar në fletët e punës për këtë qëllim.
- ❖ Pasi të keni lexuar informacionin përkatës, shprehni mendimet tuaja për jetën në ishull dhe nëse do t'u pëlqente të jetonit në të. Reflektoni për disa minuta për çështjet e mëposhtme:

Pyetjet për **Grupin X**

- Cilat janë shqetësimet tuaja në lidhje me zhvendosjen në ishullin e ri?

Pyetje për **Grupin Y (plastik)**

- Cilat janë shqetësimet tuaja në lidhje me pranimin e numrit të emigrantëve të cilët nuk njohin kulturën ose traditat tuaja?

- ❖ Bashkoni grupet dhe, duke përdorur fjali të shkurtra, prezantoni veten si përfaqësues të komuniteteve të ndryshme.



Pastaj lexoni informacionin e mëposhtëm:

Ka kaluar një vit dhe numri i problemeve është rritur. Tensionet ndërmjet dy komuniteteve po bëhen gjithnjë e më të mprehta dhe shumë njerëz shqetësohen për paqëndrueshmërinë e ashpër sociale. Presidenti ju ka ftuar të formoni një grup pune dhe të përpiqeni të gjeni një zgjidhje për këto probleme.

- ❖ Ndahuni përsëri në grupe të vogla të përziera në të cilët do të marrin pjesë 4 anëtarë të Grupit X dhe 2 anëtarë të Grupit Y. Shikoni për këtë qëllim fletën e punës Nr. 3. Në grupet e përziera duhet të merrni vendime për zgjidhjen e problemit. Anëtarët e grupeve duhet të votojnë për çdo propozim dhe miratimi i tyre (në çdo grup) do të bëhet me shumicë votash. Ju, si anëtarë të një komuniteti, duhet të mbani parasysh që nëse dështoni në përpjekjet e tuaja për të miratuar një vendim të ri me shumicë votash, atëherë edhe gjendja në secilin komunitet do të vazhdojë të jetë e njëjtë.
- ❖ Prezantoni vendimet tuaja. Përpiquni të ndërtoni dhe të respektoni një proces pyetje-përgjigje në të cilin do të merrni pjesë si individë, jashtë rolit tuaj si anëtarë të një komuniteti.
- ❖ Bëni një përmbledhje të veprimtarisë duke u bazuar në pyetjet e mëposhtme:
  - Cili është mendimi juaj për këtë veprimtari? Çfarë ju pëlqeu dhe çfarë nuk ju pëlqeu?
  - A ishte e thjeshtë për ju të luanit rolin tuaj dhe të qëndronit në këtë rol edhe kur ishullorët u bashkuan në një vend të përbashkët?
  - Çfarë mendoni për procesin e negociimit dhe për procesin e vendimmarrjes në fund? Cilat ishin, për ju,

gjërat më të rëndësishme të procesit të gjetjes së një zgjidhje për problemin?

- A ju duket e drejtë, që komuniteti X, faktikisht gëzonte të drejtën e vetos për çdo propozim, për arsye se përbënin shumicën? A jemi të sigurt që të drejtat dhe opinionet e pakicës përfaqësohen në mënyrë të drejtë në jetën reale?
- A ndikoi veprimtaria në ndryshimin e ndonjë ideje ose pikëpamjeje tuajën? Nëse po, cila ishte kjo ide dhe përse e ndryshuat atë?
- A mendoni se kjo veprimtari i afrohet disi realitetit: a ju kujton ajo ndonjë problem të shoqërisë së sotme?
- Si duhet të trajtojmë problemet me njerëzit që thonë gjëra intolerante, që lëndojnë njerëzit dhe ndonjëherë janë edhe të rrezikshme?

# FLETË PUNE

## FLETË PUNE 1

### Ishulli Y ( Plastik)

Ju jetoni në një ishull të vogël, kufijtë e të cilit janë të mbyllur. Për këtë arsye, në të nuk ka shkelur këmba e asnjë emigranti, me përjashtim të një numri shumë të vogël turistësh. Shoqëria juaj është e qetë dhe në paqe, me të cilën kuptohet mungesa e konflikteve si një traditë tashmë e gjatë, e cila vlerësohet edhe si “përparësi kombëtare”

Madje në kushtetutën e këtij ishulli ekziston një nen që thotë:

**“Askush nuk ka të drejtë të thotë ose të bëjë diçka që mund të shkaktojë dhimbje ose shqetësim tek të tjerët”**

Ky nen mbikëqyret me kujdes dhe shkeljet ndëshkohen me ashpërsi. Në fakt, ky nen shkelet shumë rrallë; është shumë më e lehtë të biesh dakord me të tjerët. Mosmarrëveshjet janë bërë të dhimbshme për anëtarët e këtij ishulli, pasi ato shqetësojnë mendjet.

Ju e quani veten demokraci. Zgjedhjet mbahen çdo vit dhe pothuajse të gjithë votojnë. Megjithatë, vihet re që në këto zgjedhje priren të zgjidhen të njëjtin njerëz, pasi edhe diskutimet për politika alternative janë shumë të pakta.

Në përgjithësi, bisedat, shprehjet në publik dhe madje edhe media nuk shkojnë përtej opinioneve sunduese e përgjithësisht të pranuar nga shoqëria. Njerëzit nuk e shohin këtë si problem, sikur të kenë harruar ose të jenë të paaftë të përfytyrojnë një rrugë të ndryshme të të bërit të gjërave. Informacioni për vende të tjera të botës është i kufizuar, sikurse edhe literatura nga kulturat e tjera.

Ndryshimet janë të pakta, sepse ndryshimi shihet si shqetësim.

Gjatë viteve, njerëzit kanë vënë re që vija e bregut ka ndryshuar: niveli i detit është ngritur dhe shumë pjesë të vendit që më parë ka qenë e banueshme, tani është nën ujë. Por as kjo nuk shërbeu si një sinjal për t'u shqetësuar, pasi toka ishte e mjaftueshme për të gjithë dhe komunitetet që jetonin në bregdet filluan të zhvendoseshin në brendësi të ishullit. Megjithatë, në vitet e fundit gjendja u bë me e mprehtë. Pati disa njerëz që filluan të diskutonin për të në rrethe të mbyllura, por edhe kjo shkaktonte shqetësim për qeverinë e cila vendosi t'i ndalonte ato.

Jeta vazhonte, kryesisht e qetë, e parashikueshme dhe e lirë nga konfliktet dhe mosmarrëveshjet, deri në ditën kur një stuhi e fuqishme goditi ishullin. U shkatërruan godina, shumë njerëz humbën jetën dhe pjesa më e madhe e tokës u përmyt nga uji. Shumë pak drithëra shpëtuan nga valët dhe ato pak që shpëtuan filluan të shkatërroheshin nga uji i kripur. Pothuajse e gjithë infrastruktura u shkatërrua. Ushqimi u rrallua. Infeksionet dhe sëmundjet filluan të përhapeshin me shpejtësi dhe medikamentet mjekësore ishin të pamjaftueshme për të këtë situatë. Ishulli hyri në kaos. Njerëzit filluan të mos mendonin njëlloj për atë që ishte më e mira që duhej të bëhej

Pikërisht në kohën kur po humbisnin të gjitha shpresat, në ishull vjen një mesazh nga ishulli fqinj. Mesazhi shprehte shqetësimin për ishullin dhe i ftohte banorët e tij të zhvendoseshin në ishullin e tyre.

Ju bëni pjesë në njerëzit që vendosin të zhvendoseni.

## FLETË PUNE 2

### Ishulli X

Ju jetoni në ishullin X i cili ndodhet në Oqeanin Paqësor dhe në një nga rrugët detare të tregtisë së lashtë përmes këtij oqeani. Ishulli juaj, tradicionalisht, është mbështetur tek tregtia dhe komunikimi me vendet e tjera dhe për këtë arsye, ju zbatoni prej shekujsh politikën e kufijve të hapur. Kjo do të thotë që udhëtarët dhe imigrantët nga vende e kultura të ndryshme janë bërë një nga tiparet dalluese të jetës së këtij ishulli. Rrjedhojë e këtij realiteti është edhe larmia e popullsisë dhe e opinioneve, besimeve dhe praktikave kulturore.

Kultura juaj kombëtare e mbështet këtë larmi: njerëzit interesohen për mënyrat e ndryshme të të bërit të gjërave, për besimet dhe ideologjitë e ndryshme. Është e natyrshme që jo të gjitha idetë dhe ideologjitë pranohen ose përqafohen nga të gjithë njerëzit. Mosmarrëveshjet dhe konfliktet janë pjesë e mënyrës së jetesës në këtë ishull. Pothuajse çdo takim i dy mendjeve njerëzore përmban edhe një përplasje mendimesh, idesh dhe besimesh. Më tej, pothuajse çdo takim kalon ose përfundon në mosmarrëveshje. Duket që mosmarrëveshjet janë kthyer në një "pasion" kombëtar.

Për këtë arsye, nuk ka ligje që kufizojnë atë që një person mund të thotë për dikë tjetër ose të kufizojë atë që një grup thotë ose mund të thotë për një grup tjetër. Madje, ka njerëz që thonë gjëra të tmerrshme. Ka raste kur kjo i shtyn njerëzit që edhe të bëjnë gjëra të tmerrshme. Sigurisht, veprat janë të ndëshkueshme nga ligji, fjalët jo.

Jeta në ishullin X është interesante, sfiduese dhe në ndryshim të pandërprerë. Ju vlerësoni pasurinë e kulturës suaj dhe faktin që mund të thoni çdo gjë që dëshironi. Ju e dini që argumentimet dhe mosmarrëveshjet e pafund nuk të çojnë në lumturi. Në fakt, shpesh herë ju ndiheni të lodhur nga mosmarrëveshjet: nuk është gjithmonë e lehtë të dëgjosh njerëz të thonë gjëra që ju i mendoni të gabuara. Më e vështirë është të dëgjoni gjëra për të cilat ju mendoni që janë të tmerrshme. Ju keni parë edhe se si disa grupe të shoqërisë priren të jenë viktimë më të shpeshta të mizorisë dhe të gjuhës së intolercës sesa të disa të tjerë.

Nga ana tjetër, për ju është e rëndësishme që askush nuk duhet të ndalohej të shprehë besimet e bindjet e tij.

Në një ditë me erë, ishulli juaj merr lajmin që një ishull në Paqësor u bë viktimë e një tufani. Ju nuk dini shumë për këtë ishull, pasi edhe ata janë kujdesur që të mbajnë gjithçka për vete. Ju keni dëgjuar "përralla" që thonë që njerëzit e këtij ishulli janë shumë budallenj dhe të prapambetur, por nuk keni pasur mundësinë të takoni asnjë prej tyre, pasi ka qenë e pamundur t'i vizitonit ata.

Qeveria shpalli lajmin që ishulli i Plastikës u dëmtuar shumë nga tufani dhe shumica e të mbijetuarve do të zhvendosen në ishullin tuaj. Atyre u duhet të shtrëngohen ca, por edhe banorët e ishullit tuaj do të duhet të bëjnë shumë ndryshime. Punët duhet të ndahen me të ardhurit dhe ndoshta nuk do të ketë strehim për të gjithë.

**FLETË PUNE 3****Probleme për grupet e punës****Problemi 1**

Ka filluar një fushatë me titull “Gjej një gjuhë plastike” e cila ka përfshirë internetin. Faqja e fushatës përmban parulla të tilla si:

- Shpo me gisht një budalla plastik: shiko nëse do të nxjerrë ndonjë tingull!
- Pa gjuhë, s’ka tru!
- Gjej një gjuhë, fito një telefon!

Pjesëmarrësit ftohen të dorëzojnë foto të gjuhëve plastike. Krijohet një galeri me foto dhe video të njerëzve që detyrojnë anëtarët e grupit Y (plastik) të hapin gojën, duke u ndriçuar gjuhën e tyre me elektrikët e dorës. Fushata po arrin kulmin, por ajo është shoqëruar edhe me shumë sulme ndaj anëtarëve të grupit Y (plastik). Këta të fundit janë përgjigjur duke thënë që nuk pranojnë të tërhiqen e të marrin pjesë në një bisedë fyese me njerëzit që ata nuk i respektojnë.

**Problemi 2**

Një vajzë e re nga Grupi Y (Plastik) ngacmohet në rrugë nga britmat e një grupi djemsh nga Grupi X të cilët përdorin shprehje të tilla si: “bufe pisanjose”, plehrë pisanjose” etj. Ata shtojnë që “ajo nuk ka gjuhë në kokën e saj, për rrjedhojë nuk ka as tru të vetin”. Vajza u ndje shumë keq dhe për një periudhë dyjavore qëndroi e mbyllur në shtëpi, pa folur me askënd. Madje, qëndroi tri ditë pa futur gjë në gojë. Prindërit e saj janë shumë të shqetësuar.

**Problemi 3**

Në një raport të kohëve të fundit tregohet që shkalla e papunësisë në popullsinë e Grupit Y (plastik) është shumë më e lartë se ajo e të gjithë popullsisë. Raporti informon që nuk ka asnjë përfaqësues të këtij Grupi në parlament dhe ka shumë pak në pozita pushteti në çdo organizatë të vendit. Raporti informon edhe për faktorët e tjerë socialë, si për shembull, nivelin e stresit dhe të sëmundjeve mendore, kualifikimeve arsimore dhe nivelin e krimit. Shifrat që lidheshin me Grupin Y në këto fusha ishin më keq se në çdo sektor të tjetër. Po kështu, edhe qëndrimet ndaj anëtarëve të këtij grupi, në raport me të tjerët ishin dukshëm më negative.

# Tema 3:

## Liria – e pakufizuar?



Kohëzgjatja **45 minuta**

### Çështjet kryesore

- Liria e shprehjes- përmbajtja e konceptit
- Rëndësia e lirisë së shprehjes për individët dhe shoqërinë në demokraci
- Kufizimi i lirisë së shprehjes. Raporti i saj me të drejtat e njeriut

### Objektivat e të mësuarit

Në fund të kësaj njësie mësimore, mësuesit duhet të jenë të aftë:

- Të shpjegojnë konceptin liria e shprehjes.
- Të shpjegojnë përse liria e shprehjes është e rëndësishme për individët dhe për shoqërinë.
- Të shpjegojnë përse kufizimi i lirisë së shprehjes mund të jetë i nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në mënyrë të veçantë, në rastet e gjuhës së urrejtjes.

## Qasje pedagogjike dhe veprimtari

Në këtë veprimtari, përmes qasjes së studimit të rastit, pjesëmarrësit do të eksplorojnë idenë e lirisë së shprehjes. Ata duhet të vendosin se çfarë do të bëjnë me komentet ose komunikimet që janë kundërshtuese, abuzive ose mundësisht të rrezikshme

Gjatë diskutimit të rasteve, pjesëmarrësit, do të marrin parasysh materialet që vendosin të marrin offline, nëse dëshirojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Për shembull, ata mund të vendosin të heqin faqen ose profilin ose të një post ose video të vetme, të pengojnë personin që e postoi etj.

Pjesëmarrësit do të përfshihen në një proces diskutimi dhe do të ftohen të eksplorojnë shkallën në të cilën vetë diskutimet ndikuan në formimin e opinioneve të tyre dhe si duhet të kuptohet kjo në kuadrin e lirisë së shprehjes.

Po kështu, pjesëmarrësit do të sfidohen me detyrën të eksplorojnë mënyrat e tjera të reagimit ndaj rasteve në studim dhe me idenë që heqja e materialeve fyese ose e një faqeje të tërë nuk është e vetmja zgjidhje. Madje, kjo mund të jetë e vështirë në kushtet e sasisë së jashtëzakonshme të materialeve që janë publikuar online.

Po kështu, pjesëmarrësit do të ndihmohen me informacione nga qëndrimi i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në lidhje me kufizimin e lirisë së shprehjes, si hap i rëndësishëm që duhet të ndërmerret nëse ekziston justifikimi i duhur dhe i nevojshëm ligjor. Ata duhet të sqarohen që ligji për të drejtat e njeriut dhe për lirinë e shprehjes ka të bëjë me sjelljen e qeverisë. Kufizimi i lirisë së shprehjes në internet shpesh herë ndërlikohet sepse shumë nga interneti është në pronësi të kompanive private. Këto kanë të bëjnë me faktin se nëse ose në çfarë shkalle qeveritë mund të rregullojnë të folurën në internet.

Në këtë mënyrë, pjesëmarrësit ndihmohen të marrin vendime të mirinformuara.

## Veprimtari

- ❖ Shkruani në një tabelë konceptin “Liri e shprehjes” dhe shprehni kuptimin tuaj për të.

Shënoni mendimet tuaja në një vend të dukshëm dhe duke i mbajtur ato parasysh filloni një diskutim për çështjet e mëposhtme:

- A nënkupton liria e shprehjes që ne mund të themi çfarë dëshirojmë?
  - Nëse mendoni që disa shprehje nuk duhet të lejohen, si duhet të vendosim për ata që është e nevojshme të ndaloher? Kush duhet ta marrë këtë vendim?
  - Përveç përmes të folurit dhe të shkruarit, cilat janë disa nga mënyrat me të cilat njerëzit shprehin veten (muzika, drama, pamjet, gjuha e trupit etj.)?
- ❖ Nga diskutimi do të dalë në pah fakti që këto çështje janë çështje kundërshtuese, që prodhojnë përgjigje dhe kundërpërgjigje edhe me ngarkesa emocionale dhe, për këtë arsye, meritojnë të eksploroher më tej.

Kujtoni rastet kur, në shtëpi, në shkollë ose në publik, mendoni se jeni penguar të shprehni çfarë dëshironit.

- Si jeni ndjerë në ato raste?
  - Përse mendoni se është e rëndësishme mundësia për të shprehur pikëpamjen tuaj?
- ❖ Lexoni informacionin e mëposhtëm në lidhje me lirinë e shprehjes!

### Liria e shprehjes

E drejta për të qenë i lirë të shprehësh mendimet dhe opinionet është një ndër të drejtat më të rëndësishme të njeriut dhe është pjesë e të Ligjit Ndërkombëtar të të Drejtave të Njeriut. E drejta vlerësohet sepse mendimet



dhe opinionet tona dhe aftësia jonë për të komunikuar janë pjesë qendrore e të qenit qenie njerëzore dhe sepse komunikimi dhe diskutimi janë thelbësorë për ndërtimin e shoqërisë demokratike. Të kuptuarit dhe të jetuarit së bashku me të tjerë varet nga komunikimi i hapur dhe i lirë, edhe pse ndonjëherë ne duhet të dëgjojmë opinione me të cilat nuk jemi dakord. Megjithatë, liria e shprehjes nuk është një e drejtë absolute që zbatohet gjithmonë dhe pa kufizime. Ajo është një e drejtë, që duhet të harmonizohet me të drejtat e të tjerëve dhe me të mirën e përgjithshme të shoqërisë si një e tërë. Kur shprehja është tejet e dëmshme për disa individë ose mund të dëmtojë shoqërinë, ajo mund të kufizohet.

Ndahuni në grupe të vogla 4-5 vetash. Lexoni rastet në fletët e punës. Detyra e çdo grupi është të vendosë nëse materiali konkret i rastit duhet të hiqet, me fjalë të tjera, nëse liria e shprehjes në këtë rast duhet të kufizohet.

Mbani parasysh pyetjet e mëposhtme:

- Nëse mendojnë se duhet të hiqet, çfarë duhet të hiqet dhe përse?
- Nëse mendojnë se nuk duhet të hiqet, përse jo?
- Çfarë mund të bëhet tjetër dhe nga kush?

Mos harroni! Çdo rast duhet të diskutohet dhe vendimet duhet të jenë të argumentuara!

Ndani vendimet tuaja me njëri-tjetrin në një seancë plenare. Filloni një diskutim duke u bazuar në pyetjet e mëposhtme:

- A kishte raste për të cilat nuk mund të arrinit në një marrëveshje si grup? Cilat ishin pikëpamjet që u ndeshën në këto raste?
- A ishte i rëndësishëm për ju autori i postit? A ndikoi kjo në numrin e njerëzve që reagueshan ndaj tij? Cilët ishin këto reagime?

- A arritet në ndonjë parim të përgjithshëm për të vendosur kur liria e shprehjes mund (ose duhet) të kufizohet? Cilat janë rreziqet që shoqërojnë kufizime ekstreme? Cilat janë rreziqet e tolerancës ekstreme ndaj tyre?
- A mendoni që mbyllja e faqeve, heqja e deklaratave ose e publikimeve të dëmshme është një rrugë e efektshme për të luftuar gjuhën e urrejtjes online?
- A ka në vendin tonë kufizime për çfarë u lejohej njerëzve të thonë online ose offline? A ndryshojnë rregullat për shprehjet online?

## FLETË PUNE

### Raste për diskutim

1. Një grup që quhet “Rikërkojmë vendin tonë” ka ndërtuar një faqe që pretendon se shpall “vlerat tradicionale”. Shumë prej publikimeve në këtë faqe janë raciste. Faqja tërheq një numër të madh komentesh dhe diskutimesh të nxehta. Disa prej diskutimeve përmbajnë një gjuhë shumë abuzive, ndërkohë që është edhe një komunitet i madh njerëzish që kundërshtojnë ideologjinë raciste të faqes.
  - A duhet të hiqet ndonjë gjë nga faqja? Nëse po, sa dhe pse?
  - Nëse jo, çfarë mund të bëhet tjetër për këtë qëllim?
2. Agroni është një politikan që përdor faqen e tij personale për të kërkuar përjashtimin e një komuniteti Rom nga zona e zgjedhësve të tij, duke i fajësuar ata për shkallën e lartë të krimit. Si rrjedhojë e ndikimit të tij, në vend u kryen shumë sulme ndaj njerëzve Rom. Shumë nga mediat filluan të botojnë ngjarje për krime të kryera nga Romët, por asnjë krim të kryer ndaj tyre.
  - A duhet të hiqet ndonjë gjë nga faqja? Nëse po, sa dhe pse?
  - Nëse jo, çfarë mund të bëhet tjetër për këtë qëllim?
3. Në një blog personal, dikush poston një skicë në të cilën paraqitet një politikan i njohur me pika gjaku që pikojnë nga gishtat e tij. Shumë prej njerëzve e mbështesin idenë e skicës.
  - A duhet të hiqet ndonjë gjë nga faqja? Nëse po, sa dhe pse?
  - Nëse jo, çfarë mund të bëhet tjetër për këtë qëllim?

4. Ela publikon një video në profilin e saj publik në të cilën tallet me njerëzit me aftësi të kufizuara, të cilët i paraqet si të paaftë dhe qenie jashtëtokësore. Statistikat e faqes tregojnë që pothuajse asnjë nuk e ka parë videon dhe nuk ka komente për të.
  - A duhet të hiqet ndonjë gjë nga faqja? Nëse po, sa dhe pse?
  - Nëse jo, çfarë mund të bëhet tjetër për këtë qëllim?
  
5. Një gazetar shikon videon në shembullin 4 dhe fillon një fushatë për të hequr profilin e Elës nga faqet e mediave sociale. Si rrjedhojë, video u pa nga mijëra njerëz. Nga njerëzit pati komente që e quanin atë si videon më të mirë, duke shtuar edhe që “Ne duhet të fillojmë të jemi realistë për njerëzit me aftësi të kufizuara” etj.
  - A duhet të hiqet ndonjë gjë nga faqja? Nëse po, sa dhe pse?
  - Nëse jo, çfarë mund të bëhet tjetër për këtë qëllim?
  
6. Teuta, një person shumë i njohur, publikon një artikull në një nga faqet online, duke pretenduar që gratë transgjinore janë “një abuzim kundër njerëzimit”. Si pasojë e kësaj, krijohet një faqe “Për të ulur Teutën”, me hollësi nga jeta e saj personale. Ajo fillon të marrë qindra emaile dhe mesazhe personale abuzive. Disa prej tyre përmbajnë kërcënime.
  - A duhet të hiqet ndonjë gjë nga faqja? Nëse po, sa dhe pse?
  - Nëse jo, çfarë mund të bëhet tjetër për këtë qëllim?

## Bibliografia bazë

1. Countering online hate speech Written by Iginio Gagliardone, Danit Gal, Thiago Alves, Gabriela Martinez, © UNESCO 2015 ISBN 978-92-3-100105-5  
<https://en.unesco.org/news/unesco-launches-countering-online-hate-speech-publication>
2. Council of Europe “Bookmarks – A manual for combating hate speech online through human rights education” Ellie Keen, Mara Georgescu, Revised edition (2016)with the inclusion of the guide to Human Rights for Internet Users, <https://rm.coe.int/bookmarksen2020-web2/16809e5789>

### **Sitografi/ Uebsites**

- <https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000233231>
- [https://www.reportingdiversity.org/resource\\_types/guides-and-manuals/](https://www.reportingdiversity.org/resource_types/guides-and-manuals/)
- <https://rm.coe.int/hate-speech-albanian/1680a1f6f5>
- <https://rm.coe.int/albanian-bookmarks-translation-2019-final/1680a1c7f5>
- <https://www.coe.int/en/web/cyberviolence/online-hate-speech>
- [http://www.unesco.org/new/en/media-services/single-view/news/unesco\\_addresses\\_youth\\_radicalization\\_and\\_online\\_hate\\_speech/](http://www.unesco.org/new/en/media-services/single-view/news/unesco_addresses_youth_radicalization_and_online_hate_speech/)
- <https://www.reportingdiversity.org/about-the-project/>
- IG: <https://www.instagram.com/reporting.diversity2.0/>
- Twitter: [https://twitter.com/RDN\\_Diversity](https://twitter.com/RDN_Diversity)
- FB: <https://www.facebook.com/reporting.diversity2.0/>
- <https://start2think.info/category/online-library/>
- <https://www.reportingdiversity.org/report-hateful-media-content/>



Financuar nga  
Bashkimi Evropian



Organizata e Kombeve  
të Bashkuara për Arsim,  
Shkencë dhe Kulturë

